ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor
BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 9 KORRIK 2022. NUMËR 189 VITI V I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Në dhjetor të vitit 2010 studiuesi dhe përkthyesi Fotaq Andrea zbuloi (duke e shfletuar shtypin francez) dy romane me tematikë shqiptare të shkruara nga Jean de Kroia, e sipas zbuluesit nuk ishte tjetër veçse Faik Konica. Zbulimi i romaneve të shkruara në frëngjishte tërhoqi vëmendjen e studiuesve. Njëri roman quhet "Martesa e Lejlës" dhe tjetri "Sotiri e Mitka".

ROMANET QË JANË KONSIDERUAR GABIMISHT TË FAIK KONICËS

nga Sevdai Kastrati

MARÍA ROCES GONZÁLEZ:

Qëndruam me Shqipërinë dhe shqiptarët për tërë jetën

Bisedoi Andreas Dushi *(fq. 2)*

María Roces González e cila kaloi jetën me përkthyesin e njohur të letërsisë shqipe në spanjisht Ramón Sánchez Lizarralde, tregon për njohjen me të dhe me Shqipërinë, sfidat dhe vlerësimet, nderimin e veçantë të ndërsjellë me vendin që i bëri natyrshëm pjesë të vetvetes.

ZOTI RRËFIMTAR - MITRUSH KUTELI

nga Virion Graçi *(fq. 10)*

SHËNIME MBI LIBRAT

Romani i Mehmet Krajës "Liria ime"

RRËFIMI BRENDA LIRISË SË FJALËVE

nga Lindita Aliu Tahiri *(fq. 9)*

Romani i Bashkim Hoxhës "Një shaka e vogël me vdekjen"

NJË ROMAN I EKZISTENCIALIZMIT NË LETËRSINË SHQIPE

nga Yzedin Hima *(fq. 8)*

Refleksion mbi librin e Ajkuna Daklit

KTHIM NË TEMPULLIN E HUMBUR NËN PLUHUR

Nga Migena Kapllani *(fq. 7)*

Mbi romanin "Tala", të shkrimtarit Xhevair Lleshi

STREHA MAGJIKE E 'TALËS'

Dr. Ditar Kabashi *(fq. 19)*

"Shkruaj në gjethe vjeshte" nga Vllasova Musta

GJETHE VJESHTE PËR TË GJITHA DASHURITË

Nga Raimonda Belli Gjençaj *(fq. 21)*

Përmirësimi i aftësive të të folurit të një gjuhe të huaj nëpërmjet veprimtarive në grup dhe atyre individuale

Dr. Rudina Vrioni

ANDY WARHOL MBI KOHËN


(fq. 22)

BIBLIOTEKË

Ndue Dedaj (fq. 14)
Shenja e diellit
Anton Papleka (fq. 15)
Zemra ime beduine
Shqiponja Axhami (fq. 16)
Zonja e mirë dhe gra të tjera
Neviana Shehi (fq. 17)
Tri tregime
Fatmir Lleshi (fq. 18)
Dy tregime

ÇETO BASHE MUJA KUNDËR GJETO BASHO MUJIT

Nga Mehmet Elezi

Deri sot kurrkush s'e ka vënë në dyshim emrin e kryeheroit të epikës legjendare Gjeto Basho Muji. Herë-herë ka qarkulluar një legjendë me burim të paqartë, sipas të cilës emri *Gjeto* do të thotë *I Gjetuni*. Sepse Muji paskesh qenë "fëmijë i gjetur". Shihet se diçka nuk shkon në këtë legjendë. Emri Gjeto ngjan si nofkë. Ai i gjeturi, ai i rrugës. Nofka përmban më shumë se shpërfillje. *(fq. 12)*

María Roces González e cila kaloi jetën me përkthyesin e njohur të letërsisë shqipe në spanjisht Ramón Sánchez Lizarralde, tregon për njohjen me të dhe me Shqipërinë, sfidat dhe vlerësimet, nderimin e veçantë të ndërsjellë me vendin që i bëri natyrshëm pjesë të vetvetes.

MARÍA ROCES GONZÁLEZ:

Qëndruam me Shqipërinë dhe shqiptarët për tërë jetën

Bisedoi Andreas Dushi

Vitin që shkoi, në Spanjë u botua një libër me titull "La Bella de la Tierra" (E bukura e dheut) me kallëzime popullore nga Shqipëria. Përzgjedhjen dhe përkthimin e tyre, përgjatë dekadash, e keni realizuar ju dhe bashkëshorti juaj i ndjerë, mjeshtri Ramón Sánchez Lizarralde . Cila është historia e këtij libri, koha që ju mori si dhe si është realizuar përzgjedhja e historive përbërëse të tij?

Që nga mesi i viteve 1980, Ramón Sánchez Lizarralde u përpoq të botonte një antologji të përrallave shqiptare, por në vitin 1994 dhe 2004 ai arriti të botonte vetëm dy koleksione të vogla me përkatësisht 28 dhe 10 tregime. Botuesja Cristina Herreros, e cila ndante të njëjtën dëshirë me Lizarralden, i kërkoi María Roces në 2011 kur Ramoni vdiq, që ta bënte atë përpjekje realitet; gjë që u krye në dhjetëvjetorin e vdekjes së Ramonit.

Të 106 tregimet që gjenden në antologji kanë qenë të pabotuara në spanjisht, me përjashtim të dhjetë tregimeve që Lizarralde botoi në 2004 *(Mirënjohja e të vdekurit)* dhe që përfshihen edhe tek *E bukura e dheut.* Këto tregime janë marrë nga botime shqiptare të denja për çdo meritë dhe përzgjedhja e tyre ndjek modelin e përmbledhjeve të prozës popullore shqiptare.

Në vitin 2018 ndejta tre muaj në Shqipëri në kërkim të dokumentacionit, ndërsa përkthimi është bërë në periudha të ndryshme midis viteve 2019 dhe 2020.

Në fund të tij është një fjalor ku gjenden edhe figurat mitologjike të pranishme. Mitologjia është një element përfaqësues – antropologjik i kulturës së një populli, por shpesh vihet re edhe një lloj shtegtimi i miteve e veçanërisht i personazheve të tyre, me anë të të cilit mund të gjurmojmë lidhjet historike mes popujve të ndryshëm. A e shihni një dukuri të tillë mes Shqipërisë dhe Spanjës? Pra, a keni evidentuar personazhe mitologjike të ngjashëm si në kulturën shqiptare, ashtu dhe atë spanjolle?

Është e vërtetë se ka figura mitologjike dhe mite të ngjashme universale, të Europës Qendrore, Ballkanike dhe Mesdhetare; se historitë për disa kafshë, për shembull, ndryshojnë pak nga një kulturë në tjetrën dhe se disa përralla të mrekullueshme priren të kenë një fije të përbashkët të ngjashme dhe synim didaktik.... Por, për të shmangur konfuzionin, dhe meqenëse këto histori janë gjithashtu një dëshmi e gjallë të gjurmëve të doke e zakone të lashta, veçanërisht shqiptare, që i dallon ato edhe nga përrallat e tjera ballkanike dhe/ose mesdhetare, i të qeniet mitologjike me emrin e tyre shqiptar dhe u referohem në fjalorin përfundimtar për një kuptim të tyre të saktë.

Si parathënia, ashtu edhe fjalori janë pritur shumë mirë.

Pak ditë më parë, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë nderoi Ramón Sánchez Lizarralde-n, personalitetin kryesor të transmetimit të letërsisë shqipe në gjuhën spanjolle. Fakti që ai e ka shkruar emrin e tij në përjetësinë e shqipes, si ju bën të ndiheni?

Shqiptarët, të paktën ata që kam fatin të njoh, janë mikpritës dhe bujarë, dhe në rastin e Ramón Sánchez Lizarralde, edhe Ministria e Kulturës (Penda e Argjendtë, 2005) edhe vetë shteti shqiptar (Medaljen e Mirënjohjes, pas vdekjes, 2013), dhe tani Biblioteka Kombëtare (së cilës më ra në mendje në vitin 2018 t'i dhuroja nja dy kopje të përkthyera nga unë dhe Ramoni, siç bëra në prill) e kanë treguar qartë mirënjohjen e tyre për punën e lavdërueshme si një urë kulturore midis Shqipërisë dhe Spanjës.

Ai ndihej asokohe, dhe do të ndihej gjithashtu tani mirënjohës, falënderues, e i lumtur. Unë ndjej se ne të dy, edhe ai, edhe unë tani, meqenëse kam marrë në dorë *amanetin e tij* për të vazhduar, po përpiqemi të kthejmë në Shqipëri një pjesë të asaj që ajo na dha dhe që vazhdon të ma japë edhe sot. D.m.th. unë vazhdoj t'i paguaj borxhin Shqipërisë.

Nuk e di pse kalova një pyetje të rëndësishme: Njohja juaj e parë me shqipen, cila ka qenë? Po në Shqipëri kur erdhët për herë të parë? Në ç'mënyrë, për ç'arsye?

Kur unë dhe Ramoni mbërritëm në Shqipëri për herë të parë në tetor të vitit 1980, për të punuar ai te Shtëpia Botuese "8 Nëntori" dhe unë te Radio Tirana, nuk dinim asnjë fjalë shqip, përveç fjalës *raki*, që dija unë. Ne ishim militantë të vjetër antifrankistë (Ramoni që kur ishte 17 vjeç, unë që nga mosha 21). Ishim ende klandestine, anëtarë të Partisë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste), e cila kishte dërguar çifte spanjolle në Tiranë që nga viti 1964 me kërkesë të "partisë motër", PPSH-së.

Hymë në Shqipëri përmes Rinasit dhe nga Beogradi me pasaportë fallso dhe, sapo mbërritëm u pagëzuam me emrat Karlos Sanchez dhe Karmen González.

Bashkëjetesa me Ramón Sanchezin, edhe po të mos donit ju ka bërë pjesë të punës së tij, në një formë a në një tjetër. Prandaj, besoj se e ka diskutuar me ju edhe nivelin e besnikërisë në përkthim, aq më tepër të shkrimtarëve si Kadare, Starova, Kongoli, në krijimtarinë e të cilëve gjendet brendashkruar historia e kombit shqiptar. A e sfidonte veten dhe gjuhën duke kërkuar mënyrën ideale të pasqyrimit në spanjisht të atij kuptimi semantik që mbante brenda vetes fjala a fraza në shqip?

Kur Ramón Sánchez Lizarralde filloi t'i përkushtohej letërsisë në vitin 1987, tradita e përkthimit të shqipes në spanjisht praktikisht nuk ekzistonte (përveçse një versioni të tmerrshëm kubanez të viteve gjashtëdhjetë të *Gjeneralit të ushtrisë së vdekur* dhe një tjetri nga francezët i *Kështjellës*), përveçse shkrimeve të mangëta propagandistike të Shtëpisë Botuese "8 Nëntori", në hartimin e të cilave Ramoni bashkëpunoi për gati katër vjet. Ai vetë konsideronte si pika themeluese për përkthimet e tij, në fillim, për të mbështetur punën e tij, përkthimet në frëngjisht dhe italisht dhe traditën relativisht të konsoliduar të përkthimeve nga spanjishtja në shqip, e cila në atë kohë përfshinte disa nga veprat më të mëdha të letërsisë spanjolle.

"Një pionier me zor", siç e quante veten, Lizarralde konsideronte si "kamerdaren e shpëtimit" në fund të viteve '80, *Fjalorin shqip-frëngjisht* të vitit 1977 të Vedat Kokonës, dhe *Fjalorin e gjuhës* së *sotme shqipe* të vitit 1980 dhe, natyrshmërisht, edhe fjalorë spanjisht për të kërkuar ekuivalencat e nevojshme. E pra, me gërshetime të tilla, edhe miku dhe *camarada* ynë i madh Jesús Hernández pati guximin të aventuronte me



përkthimin e *Dimrit të Madh* të Kadaresë në fillim të viteve nëntëdhjetë.

Kjo është arsyeja që Lizarralde do të shkonte aq larg sa të thoshte: "*Që andej vjen veprimtaria ime përkthimore, duke përdorur një shëmbëlltyrë cirku, diçka si puna pa rrjet: çdo zgjidhje konkrete, çdo shkëmbim leksikor më ndodh në një gjendje mjaft të afërt me atë të praktikës së ecjes në litar. Sigurisht, gjatë viteve të stërvitjes, kam adoptuar zgjidhje dhe ekuivalenca të njëfarë soliditeti, por, pavarësisht gjithçkaje, sa herë që zhytem në një tekst të ri, kam gjithmonë ndjenjën e rrethimit nga një fortesë, jo vetëm e ndryshme nga të mëparshmet, por edhe e ndërtuar me materiale të tjera...*".

Po jetesa me Sanchezin, emocionet, sfidat, të papriturat dhe befasitë... Nuk e di, ç'mund të thoni?

Unë dhe Ramón Sanchez u takuam në pranverën e vitit 1977 në Valencia në klandestinitet, duke qenë postëroje të një greve. Ne ishim shokë, militantë të së njëjtës parti, shkuam të jetonim menjëherë bashkë, dhe që atëherë deri në vdekjen e tij, në korrik 2011, ishim çift. Jetuam në Madrid, Valencia, Vendin Bask, Shqipëri, Madrid përsëri, dhe ai zgjodhi të vdiste në Soto de Agues (Asturias), fshati i nënës sime, ku unë jetoj tani.

Ramoni pohonte se unë isha i vetmi person në botë me të cilin ai donte të jetonte. Ishte e ndërsjellë.

Kur në vitin 2005 Ramoni mëson se pasioni i tij për letërsinë dhe përkthimin letrar, dhe vetë jeta e tij kishin një datë skadimi, më bindi "të kthehem në skenë" dhe, që atëherë e tutje, ne nënshkruajmë kontratat dhe përkthejmë së bashku, ndërsa ai fillon të më caktojë rolin e "pasardhëses" se tij kompetente për botuesit, dhe trashëgimtares së të drejtës së tij të autorit, duke e lënë tokën të mbjellë dhe plehëruar që të mos tërhiqem.

Në shkimin e saj *Spanjolli që e deshëm të gjithë*, Mira Meksi shkruan: "Ramón Sanchez-i përbën një fenomen më vete si lëvrues i artit të komplikuar të përkthimit letrar: pa kryer studime të mirëfillta filologjike, pa pasur asnjë lloj tradite apo baze të mëparshme përkthimi të letërsisë shqipe në spanjisht ku të mund të mbështetej dhe në kushtet e mungesës së fjalorëve shqip-spanjisht dhe spanjisht-shqip (ky i fundit me plot mangësi është botuar vetëm në vitin 1999), arriti jo vetëm të përkthejë me sukses një pjesë shumë të çmuar të veprës së Kadaresë, por edhe të nderohet me Çmimin Kombëtar të Përkthimit në Spanjë, të japë leksione dhe konferenca të rëndësishme në universitetet e botës mbi përkthimin letrar [...] të ketë poste drejtuese në shoqatat e përkthyesve të Spanjës dhe të krijojë një revistë shumë të vlerësuar mbi përkthimin."

Çfarë mund të thoni për këtë fakt krejt të panatyrshëm dhe, të ndodhur në rrethana të veçanta?

Ajo që shkruan Mira Meksi, sigurisht me qëllimet më të mira, është një ekzagjerim tipik i nekrologjisë, pasi studimet filologjike nuk janë absolutisht të nevojshme për të qenë shkrimtar (përkthyesi është autor) dhe nuk është aspak e qartë se filologët, për faktin se janë të tillë, janë përkthyes të mirë. Deri kohët e fundit, përkthimi letrar kishte një origjinë qartësisht aventureske dhe arrihej përmes rrugëve misterioze dhe kthesave të çuditshme (sa aventurierë, udhëtarë, ushtarë, tregtarë, robër lufte, piratë, murgj, endacaket apo emigrantë të thjeshtë ekonomikë kanë vendosur lidhjet e para midis gjuhës së tyre dhe asaj të vendit pritës, të mirë apo të keq!). Atëherë nuk kishte asnjë përgatitje specifike universitare, por në të mbi të gjitha mbizotëronte pasioni dhe dëshira letrare e guximtarëve që atyre që hyjnë në këtë univers magjepsës. Dhe kjo pa u futur në diskutimin nëse mund të mësohet apo jo përkthimi letrar, apo si mësohet (që nuk është e njëjta gjë).

Për Ramón Sánchez Lizarralde, ishte qëndrimi në Shqipëri dhe kontakti me njerëzit e saj, leximi i letërsisë shqipe, njohja graduale e kulturës së njerëzve të përmendur, ato që zgjuan tek ai projektin, në fillim të paqartë, më vonë plotësisht të rrënjosur, të përpjekjes së përhapjes në gjuhën dhe vendin e tij të veprave më të shquara te kësaj bote letrare.

Trajektorja e tij fillestare e vështirë dhe e rrezikshme, së cilës iu referova më lart, është e ngjashme me atë të përkthyesve letrarë të gjuhëve të keqemërtuara si "minoritare" ose "të papërballueshme", siç është gjuha kineze, prej së cilës historikisht nuk kanë ekzistuar e madje ende ekzistojnë shumë pak përkthime në spanjisht.

Që në shekullin XVI, "Historia e Skënderbeut" e Barletit u përkthye e botua në Spanjë. Pastaj, për shekuj me radhë, Shqipëria personifikohej, shpjegohej nëpërmjet "një vendi të mistershëm e të panjohur". Si do ta shpjegonit procesin gjatë të cilit Ramón Sanchez, por bashkë me të edhe ju, e gjetët këtë fill "të humbur" dhe e ndërlidhët sërish me Shqipërinë aktuale?

Vendet (si fqinji ynë Portugalia) dhe bile perandoritë (si ajo osmane) "misterioze dhe të panjohura" kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të shumta në injorancën kulturore spanjolle. Mbi te gjitha, në shekullin XX, diktatura e Frankos, po aq sa tirania enveriste, kontribuoi për ta bërë Shqipërinë një vend rreptësishtë të ndaluar (shprehshëm në pasaporta) dhe madje të mallkuar, bashkë me të gjithë vendet e Lindjes.

"Shqipëria, kryeqyteti: Tirana" ishte gjithçka që brezi im mbante mend nga Shqipëria prej orës së gjeografisë, por militantët proshqiptarë antifrankistë nuk kishin akses në asnjë lloj informacioni të vërtetë dhe duhej të kënaqeshin me mitin e rezistencës së Davidit shqiptar ndaj sulmit të Goliatit imperialist, revizionist dhe madje edhe kinez.

Qëndrimi ynë në Shqipëri, edhe në vitet shumë të vështira '80, kontakti ynë me universin emocionues shqiptar që pamë pas maskës së pamëshirshme së diktaturës, bëri mrekullinë: qëndruam me Shqipërinë dhe shqiptarët për tërë jetën.

Dhe, meqë ra fjala, nuk njoh asnjë spanjoll që të ketë kaluar sadopak kohë në Shqipëri që të mos ketë rënë në dashuri me vendin dhe njerëzit e saj.

Gjatë një vizite në Madrid në 2018, vizitova librarinë *Pasajes*. Një librare shumë simpatike, kur i fola anglisht, më pyeti nga isha. "Shqipëria," i thashë. Më tha se e njihte mirë këtë vend nëpërmjet një shkrimtari, Ismail Kadaresë. Sinqerisht, mu bë qejfi, gjë që e shpreha në bisedën që vijoi, diku një orë. Si ndiheni kur mendoni se pikërisht falë kontributit të Ramón Sanchezit, një kulturë "e dënuar për të mbetur e panjohur" ja del ta kapërcejë këtë "dënim"?

Përgjigjem me fjalët e Ramonit:

"*Në çdo rast, për sa u përket atyre vizitorëve të huaj të çuditshëm që ishim ne, "miqtë" siç na quanin disa, me tallje e zë të ulët, paradokset e kësaj epoke dhe të kësaj bote, kanë dashur që disa prej nesh të bëhemi përkthyesit më të mirë të letërsisë shqipe në gjuhë të tjera, të bëhemi mbrojtës në botën tonë të asaj bote tjetër aq të përbuzur dhe të troshitur, që ishte bota shqiptare, të bëhemi ura lidhëse të gjuhës dhe kulturës midis dy brigjeve mesdhetare që nuk kishin marrëdhënie prej shekujsh. Se në fakt, shkëmbimi kulturor nuk është gjithmonë fryt i konventave ndërmjet shteteve, por rezultante e një lëvizje formalisht kaotike, produkt i përpjekjes së qenieve njerëzore për të zgjeruar sferën e njohjes... Përveç kësaj, jam plotësisht i bindur se, sido që disave mund t'u duket shumë e pakët rëndësia e tij, transmetimi, komunikimi midis botëve është një nga ushtrimet më pasionuese, të këndshme e pasuruese që mund të mendohet. Dhe jo vetëm për atë që e praktikon*".

Parathënien e librit të tij "Shqipëria në pasqyrën e letërsisë", Ramón Sánchez e mbyll me: "...ndihem thuajse një shqiptar më shumë. Por brenda saj, s'mund të mos vë re vështirësitë për të qenë me të vërtetë dhe domosdo i tillë dhe, për më tepër, për t'u pranuar si i tillë, sidomos kur i jap vetes të drejtën për të shprehur keqardhje dhe për të kritikuar ato gjëra që më duken blana dhe huqe të *bashkatdhetarëve* të mi të asaj ane të Adriatikut." Po ju, ndiheni "thuajse shqiptare"?

Në vendin tim nuk jam "pothuajse shqiptare", por "plotësisht shqiptare", doja apo s'doja. Dhe mbi të gjitha, ambasadorët Manuel Montobbio dhe Anila Bitri Lani më kanë dhënë prej kohësh titullin "albanologe", ndërsa gazetarët, historianët, udhëtarët, kolegët dhe bashkatdhetarët e tjerë më marrin si "Fjalori enciklopedik shqiptar". Ndihem gjithnjë e më shumë si "monoliti shqiptar" dhe kjo pavarësisht se, për të shmangur çdo tipar shovinist, ju them se e konsideroj veten dhe se kam zgjedhur të jem *ballkanase*.

Tani, më duhet të pranoj që, kur jam në Shqipëri, e konsideroj veten një korçare të vërtetë.



Mbi autorësinë e romaneve “Martesa e Leilës” dhe “Sotiri e Mitka”

ROMANET QË JANË KONSIDERUAR GABIMISHT TË FAIK KONICËS

nga Sevdai Kastrati



Në dhjetor të vitit 2010 studiuesi dhe përkthyesi Fotaq Andrea zbuloi (duke e shfletuar shtypin francez) dy romane me tematikë shqiptare të shkruara nga Jean de Kroia, e sipas zbuluesit nuk ishte tjetër veçse Faik Konica.

Zbulimi i romaneve të shkruara në frëngjishte tërhoqi vëmendjen e studiuesve.

Njoftimin e parë për zbulimin e romaneve nga F. Andrea e jep Moikom Zeqo në “Fjala e lirë” më 18 mars 2013: “Ka gjetur dhe identifikuar dy romane të shkurtër të shkruar nga Faik Konica në frëngjisht dhe të botuar më 1911 me pseudonimin Jean de Kroia, dmth Gjoni i Krujës... Njëri roman quhet “Martesa e Lejlës” dhe tjetri “Sotiri e Mitka”. Me subjekte shqiptare të europianizuar me stil erudit e gati volterian... Fotaqi ka bërë edhe studimin argumentues, shterues për zbulimin që përbën ngjarjen kulturore më të rëndësishme kohët e fundit për ne shqiptarët”.

Njoftimin e dytë për zbulimin e romaneve nga F. Andrea e jep profesor Nasho Jorgaqi, njohësi më i mirë i tashëgimisë koniciane në gazetën “Dita” më 3 maj 2015. Në shkrimin “Për Faik Konicën e njohur dhe të panjohur” ndër të tjera shkruan: “Por më këtë rast kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë t’i bëj të ditur opinionit shqiptar një zbulim historik të librave të panjohur të Faik Konicës. Është fjala për dy romane të tij me tema shqiptare, të shkruar në frëngjisht dhe të botuar në Paris në vitin 1911, siç janë romani “Martesa e Lejlës” dhe romani tjetër “Sotiri e Mitka”. Ato u nxorën në dritë pas afër 100 vjetësh nga studiuesi i njohur frankofon Fotaq Andrea falë punës së gjatë kërkimore e mbi të gjitha përkushtimi atdhetar dhe formimin serioz shkencor. Ai jo vetëm i zbuloi, por edhe i shqipëroi në gjuhën amtare të autorit në një nivel të lavdërueshëm, duke i shoqëruar dhe me një studim shkoqitës të dokumentuar e të thelluar, dhe tani presin të botohen, por akoma flenë në sirtarin e tij për shkak të pengesave tona burokratike.”

Njoftimin e tretë për zbulimin e romaneve nga F. Andrea e jep studiuesi Thanas L. Gjika në punimin “Roli i Faik Konicës në gazetarinë dhe letërsinë shqiptare” botuar në gazetën “Dielli” më 31 mars 2016: “Federata atdhetare Vatra e shpalli vitin 2016 Viti Konica me rastin e 120 vjetorit të themelimit të revistës Albania. Ajo mori përsipër që gjatë këtij viti të ndihmojë financiarisht botimin në gjuhën shqipe të dy romaneve të panjohur të Faik Konicës, shkruar më 1908 frëngjisht. Këto dy vepra të plota letrare i zbuloi, i përktheu dhe i pajisi me një hyrje të gjerë studjuesi Fotaq Andrea. Gjetja e këtyre dy romaneve të hartuar frëngjisht prej Konicës është një tjetër fakt që tregon se Faik Konica e pati aftësinë dhe vullnetin të na linte vepra të plota letrare me dimensione të gjata si romani”.

Përsëri edhe njoftimin e katërt për zbulimin e romaneve nga F. Andrea e jep studiuesi Thanas L. Gjika në studimin “Doktor Gjëlpëra - romani i parë realist i letërsisë shqipe” botuar në gazetën “Dielli” më 6 maj 2016: “Studiuesi Fotaq Andrea zbuloi dy vjet më parë dy romane të panjohur të Faik Konicës shkruar frëngjisht më 1908-1909, të cilët autori ia kishte shitur princit Aladro Kastriotit për të siguruar parat për botimin e mëtejshëm të revistës Albania dhe për të vijuar punën atdhetare. Këto dy romane Konica nuk i përmend asnjëherë, ndoshta sepse nuk e dinte fatin e tyre pas dorëzimit të dorëshkrimit. Sqarimet për fatin e këtyre dy romaneve dhe vlerat e tyre do t’i mësojmë së shpejti prej z. Andrea, i cili do t’i botojë ato shqip shoqëruar me një hyrje të gjatë studimore.” [3]

Po kështu edhe njoftimin e pestë e kemi nga Thanas L. Gjika në “Rilindasi” më 29 maj 2016 në shkrimin “Fotaq Andrea dhe Faik Konica” ndër të tjera shkruan: “Kulmi i zbulimeve të Andreas do të arrijë në dhjetor të vitit 2010, kur piketon, gjen dhe vërteton praninë e dy romaneve të panjohura të Faik Konicës, shkruar rreth viteve 1908-1909 në frëngjisht dhe botuar më 1911 me pseudonimin Jean de Kroia (Gjoni i Krujës), titulluar “Martesa e Lejlës” dhe “Sotiri e Mitka”... Për të vërtetuar gjithçka në mënyrë shkencore, ai hyn studimit me hollësi të revistës Albania, të epistolarit të gjerë të Konicës, artikujve dhe veprave që rilindësi i madh i kishte botuar në gjuhë të huaja, hulumton në Arkiva e biblioteka të Francës e Belgjikës, hyn në lidhje të ngushtë me studiuesin Sherif Delvina, pinjoll i familjes Konica-Delvina, i cili, me personalitetin e tij, me erudicionin dhe vizionin modern që ka për shoqërinë shqiptare, fiton simpatinë dhe miqësinë e ngushtë të Andreas. Prof. Delvina e orienton tanimë Andrean në shumë drejtime, e ndihmon me zbulimet që kishte ai vetë, duke i dhënë edhe pemën gjenealogjike të familjes Delvina-Konica.”

Njoftimin e gjashtë për zbulimin e romaneve nga F. Andrea e jep përkthyesi Eshref Ymeri në gazetën “Bota sot” më 20 shtator 2016: “Pas një pune të gjatë hulumtuese, Fotaq ka arritur rë zbulojë dy romane të panjohura të Faik Konicës “Martesa e Lejlës” dhe “Sotiri e Mitka” (në pritje për botim që nga vitit 2012). Shpresohet se do të botohen së shpejti, nën përkujdesin e Federatës Panshqiptare Vatra”.

Gjashtë vjet më vonë, në vitin 2016 studiuesi Fotaq

Andrea ka përkthyer dhe botuar në Tiranë romanet "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri e Mitka" në një libër nga shtëpia botuese "Zenit". Botuesi Krenar Zejno i pajisi romanet me një parathënie, kurse Fotaq Andrea i shoqërohen romanet me studimin hyrës Lojnia – kush qëndron prapa pseudonimit Gjoni i Krujës? dhe me një pasthënie. Po ashtu në libër janë përfshirë një shtojcë me dokumente (kronika e botuar më 8 tetor 1911 në gazetën franceze l'Avenir d'Arcachon për dy romanet e "Martesa e Leilës" dhe "Sotiri e Mitka", dy letra për Jeronim De Radën nga G. C. Camet dhe një letër e Faik Konicës për Nikolla Naçon) dhe në fund ilustrimet. Romanet u mundësuan të botohen nga Vatra, e cili bërë edhe përurimin e romaneve më 26 nëntor 2016 në Bronx të New York-ut.

Po kështu edhe botimi i romaneve tërhoqi vëmendjen e studiuesve.

Të parin vlerësim e kemi nga Thanas L. Gjika: më 25 nëntor – 8 dhjetor 2016 e boton në gazetën "Illyria" të New Yorkut shkrimin Faik Konica – romancieri i parë realist i letërisë sonë (Mbi realizmin e diptikut romanor Martesa e Lejlës, Sotiri dhe Mitka)[1] kur ndër të tjera thotë: Fotaq Andrea, ky frankofon i talentuar dhe koniciolog i shquar me veprën FAIK KONICA alias GJONI I KRUJËS "Martesa e Lejlës"pasuar nga "Sotiri dhe Mitka" (ZENIT, Tiranë 2016), i dha letërsisë dhe shkencës sonë një mrekulli që flinte prej një shekulli. Pas një pune disavjeçare plot mund e sakrifica ai solli në shqipen e sotme dy romane të shkruar frëngjisht prej rilindësit tonë shumëdimensional, me shpjegime të nevojshme për shumë aspekte të këtyre dy veprave të panjohura. Ai ka dhënë sqarimet e nevojshme për historikun e gjetjes, për zbërtmin e pseudonimit Jean de Kroja / Gjoni i Krujës, ka sqaruar ngatërresat që solli Aladro Kastrioti me botimin e përkthimit në spanjisht të romanit të dytë me emër autori Juan Pedro Aladro, etj. Po në hyrjen e veprës, studiuesi ka shpalosur dhe vlerësimet e tij shkencore lidhur me dy veprat romanore, karakteristikat e tyre më të spikatura letrare, tiparet e personazheve, kush fshihet pas tyre, etj."

Thanas Gjika më 18 dhjetor 2017 e boton në gazetën "Illyria" të New York-ut studimin Vështrim krahasimtar në studimet e sotme për F. Konicën (Vlerësime për veprat e J. Kastratit, I. Ikonomit, F. Andreas dhe A. Alibalit)[2] ku ndër të tjera thotë: "Me botimin në shqip të këtyre dy romaneve u rrëzua përfundimisht thënia e nxituar e Nolit se Faiku "nuk na la asnjë vepër të mbaruar", thënie të cilën Sabri Hamiti e studiues të tjerë e kishin hedhur poshtë duke e konsideruar koleksionin e revistës "Albania" vepër të plotë e komplekse. Fotaq Andrea para se të merret me analizën e ideve dhe anës artistike të romaneve "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri dhe Mitka", sqaron sesi ra në gjurmë, dhe si i gjeti e i bleu këto dy vepra të mbledhura Brenda dy kapakësh në një dyqan librash të vjetër në Belgjikë. Më tej ai sqaroi se pseudonimi "Gjoni i Krojës", me të cilin ishin botuar dy romanet në frëngjisht, ishte pseudonim i Faik Konicës. Kjo e dhënë dhe shumë materiale që studiuesi i nxjerr nga teksti, e bëjnë të padyshueshëm faktin se këto vepra ishin shkruar prej Faik Konicës në vitin 1909, para se të largohej për në Amerikë, ku ishte thirrur për të marrë drejtimin e gazetës Dielli".

Më 20 maj 2018 gazeta "Dita" njofton për aktivitetin që u bë për dy romane të panjohura të Faik Konicës. E sipas botuesit Krenar Zejno: "Në këtë libër përfshihen dy romane të Faik Konicës "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri e Mitka", të cilat deri pak kohë më parë e kanë pasur jetën e tyre në gjuhën frënge, ku autori ishte me pseudonimin "Jean de Kroia" ose Gjoni i Krujës. Falë punës kërkimore dhe përkthimit të bërë nga Fotaq Andrea, këto dy romane janë bërë pjesë e letërsisë shqipe. Edhe këto dy romane rrisin vlerat e Konicës dhe shndërrohen ikona të letrave shqipe".

Më 12 qershor 2018 botuesi Krenar Zejno flet në emisionin CODEX të KTV-së, të cilin e drejton Durim Abdullahu, rreth 14 minuta për romanet e Konicës.

Në vitin 2018 studiuesi Sadri Fetiu[3] pohon se romanet "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri e Mitka" Konica i pati shkruar dhe botuar me pseudonimin Jean de Kroia / Gjoni i Krojës para se te shkonte në Amerikë. Më pas do të shtojë se "Këto dy vepra realiste i ka zbuluar, i ka përkthyer dhe i ka pajisur me shënime të nevojshme Fotaq Andrea, kurse parathënien intreresante e ka hartuar z. Krenar Zejno, pronar i shtëpisë botuese ZENIT".

Më 19 janar 2019 ribotohet eseja si parathënie e romaneve "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri e Mitka" në ExLibris e botuesit Krenar Zejno me titull Dy romane, një libër: dy emra, një autor: Gjoni i Krujës alias Faik Konica!

Më 17 shkurt 2019 Nasho Jorgaqi e riboton shkrimin Për Faik Konicën e njohur dhe të panjohur në gazetën "Dita" duke shtuar edhe diçka më tepër lidhur me F. Andrean: "Romanet u shoqëruan me një studim shkencor serioz e i dokumentuar për vlerat e romaneve dhe zbulimin e identitetit të Faik Konicës si autori i tyre. Me zbulimin e këtyre dy romaneve që lexuesi ynë tanimë i ka në dorë Fotaq Andrea i solli një shërbim me vlera kulturës dhe letërisë sonë të traditës".

Më 10 janar 2020 i ndjeri Moikom Zeqo e boton në gazetën "Dita" esenë Përkime kulturore (Guillaume Apollinare dhe De Rada) ku ndër të tjera shkruante: "Ky zbulim i të dy romaneve të Faik Konicës në frëngjisht është vërtet diçka befasuese. Autori i zbulimit dhe i përkthimit të këtyre dy romaneve në gjuhën shqipe, ka të gjitha të drejtat e copyright-it. Duke lexuar këto romane kujton jo vetëm forcën lakonike dhe moderne të shkrimit konician, por edhe elemente biografikë".

Më 30 gusht 2020 në gazetën Illyria botohet intervista e studiuesit Behar Gjoka me titullin Faik Konica – babai i kritikës dhe eseistikës. Në këtë bashkëbisedim me gazetarën E. Jaçaj studiuesi B. Gjoka4 i konsideron romanet si të Konicës.

Në vitin 2020 studiuesi Thanas Gjika, i cili brenda disa vjetëve ka shkruar tre artikuj vlerësues) në studimin Faik Konica – themelues i romanit realist shqiptar5ndër të tjera, ka pohuar se: "Dy romanet e parë të Konicës Martesa e Lejlës dhe Sotiri e Mitka shkruar në frëngjisht më 1909 e botuar më 1911, janë përkthyer tashmë mjeshtërisht në shqip prej frankofonit të talentuar Fotaq Andrea. Këto romane dallohen prej veprave romanore pararendëse përsa i përket realizmit si metodë krijuese. Romani i Sami Frashërit Fatma (1872) ishte vepër krejt romantiko-sentimentale, kurse romani i Santorit Sofia e Kominiatëve (1873) dhe ai Pashko Vasës Bardha e Temalit (1890) ishin vepra ku binte në sy largimi nga romantizmi dhe sentimentalizmi dhe prirja për afrim me realizmin. Kurse në romanet e parë të Konicës realizmi nuk është thjesht një prirje, por një metodë krijuese e zbatuar me ndërgjegje. Në romanet e Konicës nuk kemi dashuri me një të parë, nuk kemi përshkrim të zakoneve të jetës si dukuri folklorizante, natyra nuk përcakton fatin e heronjve, nuk kemi personazhë skematikë që mendojnë e veprojnë sipas skemave të paracaktuara prej autorit. Ngjarjet në të dy romanet e parë të këtij shkrimtari zhvillohen në përputhje me rrethanat dhe ligjet e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, kurse personazhet janë krijuar si personazhe tipikë që veprojnë në rrethana tipike".

Më 22 shkurt 2021 Sinan Gashi e boton në "Fjala e lirë" punimin Katër shkrimtarë shqiptarë me pseudonime të shumta6 thotë se 'është me interes të theksohet se Faik Konica edhe për veprat e lëna në dorëshkrim, ishte nënshkruar me pseudonimin, si Jean de Kroia (Gjoni i Krujës), për romanet e tij "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri dhe Mitka"..

Më 10 tetor 2021 Thanas Gjika e boton në gazetën "Dielli" recensionin Ndërfutjet dhe alternimet e ngjarjeve – tipar themelor i një romani (Vlerësime për romanin "Dy jetë..." të Pandi Papandos) ku ndër të tjera do të shkruajë edhe këtë: "ecuria logjike dhe thurja e ngjarjeve me realizëm e bën lexuesin t'i pranojë ato si ngjarje e përkime që ndodhin në jetë. Këtë dukuri lexuesi e has edhe në romanet e shkrimtarit italian Kazanova (Giacomo Casanova), dhe në romanet e shkruar frëngjisht prej Faik Konicës, përkthyer me mjeshtëri në shqip prej Fotaq Andreas "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri e Mitka" ZENIT EDITION, Tiranë 2016, 332 f."


LE MARIAGE
DE
LEÏLA
PAR
JEAN DE KROIA
PARIS
IMPRIMERIE POLYGLOTTE A. REIFF. — S. HEYMANN
3, RUE DU FOUR, 3
1911
HW

HIPOTEZAT DHE SHPJEGIMET E FOTAQ ANDREAS

Fotaq Andrea në shpjegimet përshkruese që sjell në studimin e tij "Lojnia" edhe pse duket si një përshkrim shterues dhe i hollësishëm apo siç e quan N. Jorgaqit "një studim shkoqitës të dokumentuar e të thelluar" prapëseprapë na del një studim me njoftime të shumta si dhe me hulumtime të gabuara.

Disa janë arsyet që na shtyjnë të dyshojmë:

1. A është Faik Konica autori i romaneve?

Fotaq Andreas, pa dyshim, i takon merita për zbulimin e romaneve "Martesa e Leilës" dhe "Sotiri e Mitka", por e njëjta gjë nuk mund të thuhet për autorin. Sa i përket autorit, ai jep disa shpjegime dhe mundohet të gjejë ndonji argument për të provuar se autori është vetë Konica. Në mungesë të dhënave për autorin Andrea është munduar të krijojë të dhëna jashtëtekstore. Në të vërtetë, siç do të shohim në vijim është prirja e F. Andreas për të sjellë njoftime sa më të shumta, në shikim të parë, që kanë të bëjnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për Faik Konicën. Kështu ai përpiqet të bëjë analiza e krahasime në mënyrë të imtësishme, me përkime dhe anologji dhe prapëseprapë arrin në përfundime të pasakta.

Fotaq Andrea, pa zgjidhur çështjen e pseudonimit Jean de Kroia, na flet për një pseudonim të ri të Konicës kinse e ka zbuluar vetë. Bëhet fjalë këtu për pseudonimin Tepeleni, i përdorur për herë të parë nga Konica në gazetën La Libre Parole më 26 dhjetor 1895. Shkrimi në frëngjisht mban titullin "L'Albanie et les Turcs" [Shqipëria dhe turqit] dhe nuk është i panjohur për studiuesit e Konicës. Për herë të parë e gjejmë të përmendet me emrin e autorit në Bibliografinë shqype / Albanesische Bibliographie të botuar në Vjenë më 1909 dhe që është përgatitur nga F. Manek, Gj. Pekmezi dhe A. Stotz7. Sa më është e njohur të dhënat e para për këtë shkrim i kemi ndeshur në vitet '20 të shekullit të kaluar në gazetën "Dielli" ku gabimisht përmendet si broshurë. Më pas e ndeshim titullin e kësaj 'broshure', pra me emrin e autorit, në veprën "Popolo, lingua e letteratura albanese" të Gaetano Petrottës8. Njëmbëdhjetë vjet më vonë kjo tezë përsëritet te Namik Resuli në kristomacinë9 "Shkrimtarët shqiptarë", ku besojmë se studiuesi arbëresh ka qenë i vetmi burim i të dhënave për Konicën. Po kështu do të përsëritet pa ndonjë të dhënë të re te disa studiues si p. sh.: Sabri Hamiti, Jup Kastrati, Nasho Jorgaqi, Moikom Zeqo dhe Shyqri Galica10. Ndërkaq studiuesi Jup Kastrati, autor i një monografi për Konicën, është i mendimit se kemi të bëjmë me një artikull dhe me një broshurë11. I këtij mendimi është edhe M. Zeqo, pa mëdyshje mund të themi se është ndikuar nga ky i fundit. Po këtë qëndrim mban edhe studiuesi N. Jorgaqi, i cili12 nuk e mëdysh aspak bindjen tonë se është i ndikuar nga J. Kastrati.

I pari studiues që bën fjalë për artikullin L'Albanie et les Turcs ka qenë Ymer Jaka[13] në studimin "Veprat e rilindësve shqiptarë në gjuhën frënge" të botuar në revistën Gjurmime albanologjike më 1976. Ai na bën me dije se artikulli në fjalë dhe pseudonimi Tepeleni janë zbuluar nga Luan Starova14. Për hirë të së vërtetë në atë periudhë i riu Starova bënte hulumtime për lidhjet e Konicës me Apolinerin, i cili një vit më vonë do të mbrojë në Universitetin e Zagrebit tezën e doktoratës me titull "L'oevure de Faik Konitza en français et sa collaboration avec Guillaume Apollinare"[Vepra e Faik Konicës në gjuhën frënge dhe marrëdhëniet e tij me Gijom Apolinerin]. Për fat të keq, kjo tezë doktorate, deri në ditët tona, mbeti e panjohur për lexuesit.

F. Andrea për ta bërë të besueshëm 'zbulimin' citon Jup Kastratin, i cili flet mbi pseudonimet e Konicës në përmbledhjen e sesionit shkencor "Faik Konica: jeta dhe vepra" të botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, më 1997. Me këtë rast detyrohemi të shtojmë se punimi i Jup Kastratit "Bibliografia e botimeve të Faik Konicës (1895-1942)" speaks for itself. Me gjithë sqarimet e mëtejshme që jep F. Andrea, madje i sajonë vetë (jo vetëm në këtë rast) por edhe nxit një fare dyshimi saqë ato nuk përputhen midis tyre. Gjithsesi Andrea nuk ngurron të shtojë në listen e pseudonimeve të përmendura nga J. Kastrati edhe 'zbulimin' e tij. Po kështu, mund të thuhet, se Andrea të dhënat e para për këtë pseudonim i ka marrë nga L. Starova, të cilin përpos vlerësimit që i bën në librin Faik Konica: përlindësi modern (2016), po aty përmendet edhe vepra e Starovës Faik Konica dhe Guillame Apollinaire: një miqësi europiane (2001).

Me kalimin e kohës, katër vjet më vonë, F. Andrea në studimin "Rrugëtimi i gjatë i revistës Albania" i kthehet edhe një herë artikullit "Shqipëria dhe turqit" duke korrigjuar mendimin e vet të mëparshëm. Ai është i mendimit se Konica i ka dërguar gazetës La Libre Parole një ese prej 80 faqesh dhe redaksia e gazetës e masakron duke e botuar vetëm në një shtyllë e gjysmë faqe gazete15. Me këtë rast jemi të detyruar ta hedhim poshtë mendimin e F. Andreas, sepse kemi vetëm hipotezë dhe jo siguri. Të dhënat që na jepen nga F. Andrea nuk përputhen me asnjë argument dhe mbetet për t'u saktësuar në vijim. Në të vërtetë të dhënat e para përë këtë njoftim të Andreas i kemi drejtpërsëdrejti prej Konicës, i cili në një letër që i dërgon një mikut në Bukuresht më 1896, ndër të tjera, thuhet: Shkrova një artikull prej 80 faqesh, i cili kishte si titull: "Ese mbi të ardhmen e Shqipërisë dhe përpjekjet e saja për pavërsi në shekullin XIX. Ali pashë Tepelena. – Revolucioni i 1831. Kryengritja e vitit 1866. Abdyl beu dhe kryengritja e viteve 1879-80; roli i Bektashizmit në këtë kryengritje. Lëvizja bashkëkohore. Apostolo Margariti dhe ati Faveyrial. Naço dhe lëvizja antihelenike." Për këtë artikull punova tre muaj. E çova te revista më e medha e Evropës. Drejtori m'u përgjigj se artikulli ishte shumë interesant dhe mund të kishte një jehonë ndërkombëtare (këtë letër ia kam dërguar vëllait tend); vetëm se, shtoi drejtori, është në vetë interesin e çështjes, që të hiqen disa pjesë; unë pranova dhe i kërkova të më shënonte se çfarë duhet të hiqja: u çudita kur pashë se ai kërkonte që unë të hiqja gjithçka, përveç rreth dhjetë faqeve mbi bektashizmin; me fjalë të tjera, ai dëshironte një artikull mbi një çështje interesante dhe të panjohur të fushës së filiozofisë fetare; kurse për sa u takonte kërkesave dhe të drejtave të Shqipërisë, ai as që donte t'ia dinte fare: unë parapëlqeva të hedh artikullin në zjarr, sepse ai mund të rriste tirazhin e revistës, por nuk do t'u sillte kurrfarë dobie maleve tona të gjora.

Pra, siç mund të shihet F. Andrea shtrembëron të vërtetën (me dashje) që të pranohet teoria e tij. Dhe kjo mosnjohje shkencore e çon shpeshherë në rrugën e hamendësimeve, sepse nuk i përmbahet gjithmonë teorisë së tij.

Në fund duhet thënë se sa i përket i artikullit "L'Albanie et les Turcs" F. Andreas i takon merita e përkthimit dhe e botimit në shqip16.

Fotaq Andrea pseudonimi Jean de Kroia e shqipëron gabimisht (ndoshta pa dashje) emrin Gjin në Gjon, 'edhe pse emri Gjin mbahet si variant i emrit Gjon'17. Më pas, ai bën përpjekje të japë ndonji sqarim të shkurtër për autorin, duke u nisur në zbërthim emrash e faktesh historike, por mungesa e burimeve për ta zgjidhur çështjen e autorsisë e shtynë F. Andera të pohojë në mënyrë të prerë (edhe me zë18) se autori i romaneve është Faik Konica dhe këtë 's'e luan as topi!' Me një fjalë, me këtë pohim e mbyll shtegun për ta vazhduar mendimin edhe dikush tjetër.

Vijon në numrin tjetër.

Shënime

[1] Shih Thanas L. Gjika, Faik Konica – romancieri i parë realist i letërisë sonë (Mbi realizmin e diptikut romanor Martesa e Lejlës, Sotiri dhe Mitka), në gazetën "Illyria" më 25 nëntor – 8 dhjetor 2016, nr. 2437, f. 71-72.

[2] Thanas Gjika, Vështrim krahasimtar në studimet e sotme për F. Konicën (Vlerësime për veprat e J. Kastratit, I. Ikonomit, F. Andreas dhe A. Alibalit), në: Thanas Gjika, Një letërsi kombëtare, një atdhe i vetëm, "Kumi", Tiranë, 2018, f.?

[3] Shih Sadri Fetiu, Parathënia, në: Thanas Gjika, Një letërsi kombëtare, një atdhe i vetëm, "Kumi", Tiranë, 2018, f. 11.

[4] "Fakti që Fotaq Andrea para disa vitesh zbuloi në Francë dy tekste romanesh, në frëngjisht të Konicës, ose letra të autorit në SHBA, tregon se përmasat e Konicës janë shumë më tepër, nga sa njohim, mbase letërkëmbimi i autorit, mbetet ende në hije."

[5] Thanas Gjika, Faik Konica – themelues i romanit realist shqiptar, në: Adnan Mehmeti, Autorë dhe vepra, "Adriatic Press", New York, 2020, f. 258.

[6] Përpos gabimeve të shumta, ai ka përvetësuar punën e të tjerëve dhe aq më tepër as që i ka lexuar romanet.

[7] Shih F. Manek, Gj. Pekmezi dhe A. Stotz, Bibliografinë shqype - Albanesische Bibliographie, e shtypi shoqërija "Dija", Vjenë, 1909, f. 73.

[8] Shih Gaetano Petrotta, "Popolo, lingua e letteratura albanese", Palermo, 1930, f. 352.

[9] Shih Namik Resuli, Faik Konica, në "Shkrimtarët shqiptarë II", Tiranë 1941, f. 237.

[10] Është për të theksuar se Gaetano Petrotta në veprën e tij të njohur "Popolo, lingua e letteratura albanese" ka pohuar gabimisht se Faik Konica ka botuar gazetën "Ushtima e Krujës" në Durrës. (shih Gaetano Petrotta, Popolo, lingua e letteratura Albanese. Palermo 1930, f. 356). Ky pohim i tij është përsëritur nga një studiues te tjetri: Jup Kastrati (1995 201), Isak Shema (2015 372). Edhe pse G. Petrotta, 20 vjet më vonë, në librin "Svolgimento storico della cultura e della letteratura Albanese" botuar në Palermo më 1950 e korrigjon mendimin e vet të mëparshëm. Lidhur me këtë vetë F. Konica ka pohuar në një letër të dërguar gazetës "Dielli" nga Vjena (letra mban datën 10 shkurt 1914) se gazeta "Ushtima e Krujës" nuk është gazetë e themeluar prej tij, veçse ka shkruar një artikull dhe ka ndrequr e artikujt e tjerë në numrin e parë. (shih Letrë nga z. Faik Konica, në "Dielli", 3 mars 1914, f. 1).

[11] Shih Jup Kastrati, Faik Konica (1875-1942), "Jehona", Shkup 1992, nr. 5-6, f. 13; Jup Kastrati, Faik Konica, "Gjonlekaj Publishing Company", New York, 1995, f. 55, 138, 154, 441.

[12] Shih Nasho Jorgaqi, "Kronikë e shkurtër e jetës dhe e veprës së Faik Konicës", në Faik Konica, Vepra 5, Botimet Dudaj, Tiranë 2001, f. 433.

[13] "Në këtë artikull Konica vë në pah frikën e Perandorisë Osmane nga kryengritjet e popujve të shtypur, sidomos të shqiptarëve dhe maqedonasve, denoncon manovrat e sulltanit, i cili përpiqej t'i neutralizonte këto lëvizje me përfaqësimin e rrejshëm të këtyre popujve në parlamentin turk dhe e bën me dije opinionin e huaj publik për përgatitjet e kryengritjes së armatosur të shqiptarëve për çlirim nga zgjedha e huaj", në: Ymer Jaka, Veprat e rilindësve shqiptarë në gjuhën frënge, "Gjurmime albanologjike – seria e shkencave filologjike", viti V, Prishtinë 1976, f. 115; në: Ymer Jaka, Lidhjet letrare shqiptaro-frënge, "Rilindja", Prishtinë 1979, f. 58.

[14] Shih Luan Starova: Faik Bég Konitza:Une symphonie inachevée, në: Amis européens d' Apollinaire. Actes du seizième colloque de Stavelot, 1-3 septembre 1993, réunis par Michel Décaudin, Presses de la Sorbonne Nouvelle, Paris, 1995, f. 171, 174; Luan Starova, Faik Bég Konitza et Guillaume Apollinaire: Une symphonie inachevée, në: Faik Koniza et Guillaume Apollinaire: Une amitié européenne, "L'Espirit des Péninsules", Paris, 1998, f. 13; Luan Starova, Faik Konica dhe Guillaume Apollinaire: një miqësi europiane, Botimet Onufri, Tiranë 2001, f. 12; Luan Starova, Kthimi i Faik Konicës, "Flaka", Shkup 2001, f. 147-148.

[15] Fotaq Andrea, Rrugëtimi i gjatë i revistës "Albania", në Faik bej Konica – Baroni Julius Zwiediek, Letërkëmbim 1897-1912: "Albania" dhe Vjena, Botimet "Artini", Prishtinë 2020, f. 11.

[16] Faik Konica, Shqiptarët dhe turqit, "Gazeta shqiptare – La gazeta del mezzogiorno", 1 prill 2012, nr. 5596, f. 26; Fotaq Andrea, Faik Konica – përlindësi modern, Botimet "Zenit", Tiranë, 2016, f. 179-183; Faik bej Konica – Baroni Julius Zwiediek, Letërkëmbim 1897-1912: "Albania" dhe Vjena, Botimet "Artini", Prishtinë 2020, f. 789-795.

[17] Shaban Demiraj, Prejardhja e shqiptarëve përmes dëshmive të gjuhës shqipe (botim i dytë – i përmirësuar), Botimet Naimi, Tiranë, 2015, f. 135.

[18] Shih në emisionin "Rreze dielli" në Raport TV, Fotaq Andrea për Faik Konicën, të datës 3 nëntor 2016, në minutën e 11:00.

Refleksion mbi librin e Ajkuna Daklit

Kthim në tempullin e humbur nën pluhur



Nga Migena Kapllani

Çfarë e shtyn një njeri të shkruajë deri edhe pas shumë vitesh heshtjeje? Këtu mund të përdorim sintagmën e njohur të at Zef Pllumit "Rrno për me tregue". Nëse ajo kohë (monizmi) u mbyll në regjistra e dosje të zverdhura që akoma sot nuk u zbardhën, një mënyrë mund të jetë rrëfimi i atyre që e jetuan atë kohë, ku siç thotë me të drejtë dikush, për të gjithë "ndau në mënyrë të barabartë vetëm varfërinë". Po dashtë Zoti të ketë qenë vetëm varfëri materiale, e të mos ketë varfëruar dhe mendjet e shpirtrat e njerëzve.

Magjia e të shkruarit, kur përjetësia bëhet një fjalë gjithnjë e më e shkurtër, siç thotë autorja në parathënien e librit të saj "Çizme lëkure në kohë lufte", është shtysa e parë që ul atë të shpluhurojë nga heshtja e gjatë skicat e hedhura diku.

Tregimet e saj janë kujtesë e gjallë e asaj fëmijërie lëmsh, pa qartësi e pa vërtetësi, që u jetua turbull mes të vërtetash gjyshesh, që frikshëm mohoheshin nga bijtë dhe kundërshtoheshin nga nipërit e paditur e të indoktrinuar. Nuk ndahej dot ajo turbullirë aso kohe dhe sot del nevoja të thuhet dhe një herë për të zbardhur mjergullën dhe ta dëgjosh me zë të lartë të vërtetën e fshehur, përndryshe akoma nuk e beson. Kohë dilemash absurde: ka Zot, apo s'ka; partizan, apo gjerman; quhesh spiun, apo jo; dinë gjyshet, apo kanë rrjedhur; të deklasuar apo jo; kjo thuhet, apo s'thuhet?! Cila ishte e vërteta, mësohet shumë vonë, madje për të justifikuar jetën që bëmë, akoma nuk i themi si duhet ato. Kemi frikë se zhbëjmë atë që ishim. Frika e psikoanalizave të pabëra kurrë do na persekutojë gjatë.

Një shpëtim për autoren tonë asokohe e për një pjesë të mirë, janë librat si pasuri që mund të krenohesh në çdo kohë. Shpesh gjatë leximit, gjendesh mes ngjarje të ngjashme. Cili/cila ka moshën e njëjtë, gjen veten. Një pjesë e fëmijëve "të deklasuar" të asaj kohe, mund të jenë gjendur nëpër shtëpi të bukura me ëndrrën "ah sikur të ishte shtëpia ime!", por që ironikisht ishin shtëpi të shtetëzuara dhe askush nuk të rrëfente pse nuk mund ta kishe ti më atë shtëpi. Një luftë e përballje e çuditshme brenda fëmijërisë së saj/sonës. E duam një gjysh partisan, edhe pse ai urren gjyshin tënd të mirë. Kohë kafkiane, kohë e mjergullt, kohë që nuk ka akrepa, sepse diçka ka ngecur, për të ecur disi sot (dhe pse shumë ngadalë) përmes këtij libri. E gjithë fëmijëria jonë të kujton përrallën e Vëllezërve Grim "Gjon teveqelin". Ne ishim ashtu…

Ka një humor të fshehur brenda tregimeve. Ka qenë edhe kjo një mënyrë për ta përballuar të keqen ndër ne. Ashtu si tregojmë me humor dajakun e prindërve, ashtu ndërthuret edhe tragjikja me një lloj qeshje nën buzë e Ajkunës. Këtë perceptim më japin "hurmat e qullëta që bënin helaq gjermanët"; ditëlindjet e sajuara të gjysheve; patetizmi luftarak i mbrojtjes së asaj ideologjie në gjuhën e fëmijës; rrokotelat e shpjeguara si thesar te soleta bashkë me kotelet që pjell macja; "Gjithmonë gati" e saj me vonesën në shkollë; betimet e saj po që nuk i beson as vetë; naiviteti i shprehjeve për absurditetin e asaj kohe që nuk i linin të arratiseshin "armiqtë" (një armik më pak, thotë fëmija naiv); bakllavaja si preteks "gëzimesh" të fshehta; misteri i të brendshmeve të Lavdijes që kishte pesë gojë për të ushqyer, një burrë pijanec dhe tre dhëmbë mangët me një gardërobë jo shumë të pasur, si dhe çështjet madhore në fund të filxhanit, shëndeti, marrëdhëniet me qeverinë e ndonjë hasëm; konteksti i shprehjes "edhe pushtuesit veshin këpucë, por jo partizanët se ishin këpucë me porosi" e të tjera si këto.

Më pëlqen zgjedhja që i bën ruajtjes së disa emrave, historive, apo ngjarjeve në origjinal. Mendoj se bën mirë që i sjell ashtu të qartë në tregimet e saj historitë e jetuara e të përjetuara me elemente autobiografike në to. Ata le të mbeten diku në kujtesën e atyre që i njohin; të tjerët njësoj e kanë sidoqë të quhej personi apo vendi. Për ata që njohin emrin e "Gurabardhit", "1 Majit", sheshi "te xhamia", bedenat e kalasë, muzeu i luftës, ndërtesa e daklëve si shkollë 8-vjeçare, guri i derës, zona që përcaktohen në mënyrë eufemistike si "zona e lojës që nuk shkonte dot deri atje" (për rrugë larg qendrës); të gjitha janë kujtime të bukura për një lexues të qytetit, apo një lexues tipik jashtë tij për çudinë e toponimeve që rëndom në mes nesh përdorim. Vendet janë kapitull më vete që aq bukur i ravijëzon në librat e saj. Kujdeset të mos i lëndojë ato vende që janë kujtime që nuk të lëshojnë e mbetesh në to "kapur si në një rrjetë". Këto vende "shformojnë fytyra dashurish të shembura" në reflekset e xhamave të ndërtesave të reja. Qarkullimi në to është memorje. Qyteti është bërë pjesë e rëndësishme më tepër kur u largua prej njërit atdhe, drejt tjetrit. Në çdo vend të ikësh, rrëshqet në të njëjtat rrugë të hedhura sipas të njëjtit vals të njohur.

Dialekti i ruajtur në gjuhën e plakave (atyre plakave që i vunë shpatullat jetës së shndërruar e të rrëzuar kokëposhtë) që dhe vetë e përdor në gjuhën e saj si një formë krenarie e trashëgimisë përmes gjuhës, është një tjetër tipar dallues i saj. I vijnë natyrshëm gjuhës së librit shprehje si: helaq; shoku Stavri të na marrë të keqen; e zbërdhulët; si pulë pa kokë; flet pa pikë pa presje; hilacak; qaj për së gjalli; po të rrëmosh nëpër kuti dhe t'i heqësh të gjitha rrangullat njëra pas tjetrës si fletët e qepës, gjen libra; plasja në varreza apo burg e një njeriu që nuk donte t'ia dinte kush; mbytur si kuti konservash nëpër trena etj. Figuracionin që përdor, e sjell me një natyrshmëri e pa sforcime.

Tregimet janë të ndara në tri pjesë. Nis që nga fëmijëria të ndajë kohët; para e pas monizmit. Pjesa e parë mbyllet me një rrëfim zëri tjetër nga i autores vetë. Në pjesën e dytë të tyre, tregon ngjarje të rënda me pjekurinë e një vajze që jeta e ka sprovuar. Te tregimi "Shpresë dhe humor të mirë", tregon se si rriten më shpejt seç duhet fëmijët me histori humbjesh që i përballin si të rritur. Jo më kot këtë ndarje e shoqëron me një shprehje të shkrimtarit të saj të preferuar Heminguj "Bota thyen çdokënd… Ata që nuk i thyen, i vret…". Kohët kur ndodhin ngjarjet në këtë pjesë janë të fokusuara më tepër te karakteret se sa te vetë koha kur kanë ndodhur. Tregimi "Zamiri", sjell histori të fëmijëve të trishtë të asaj kohe, që çdokënd do të trondisnin në çdo fazë të rrëfimit. Në ato kohë, me gjithë gjeografinë e vogël të qytetit, njerëzit e humbnin lehtësisht shqimit njëri-tjetrin. Ani, në asnjë rresht nuk ka sentimentalizma e qyrravitje. Pjesa e fundit ka një tjetër strukturë. Vjen si një gjë kompakte më vete për të sjellë një histori plot dhimbje, si shumë të tjera të rrëfyera, por që sjellin marrëdhënie të shumëfishta, të nënës me birin, të mikes më të mirë, të jetës dhe vdekjes, sikur në këtë mbyllje do të sqarojë tërë atë botë mendimesh që e rrethon dhe mundon. Nënat janë "as vajzë as grua" deri në momentin kur në krahë kanë beben e tyre. Më pas gjithçka bëhet një histori tjetër, treguar në histori pa fund. Ato (nënat) janë arsyeja "e shpikjes së gjuhës, janë e para rrokje, janë krahu ku fle fëmijëria jonë, janë fara ku mbjellim më pas ëmbëlsinë e syve të tyre.

Tregimet e Ajkunës vijnë më shumë prej ikjeve pa kthim, që trondisin aq fort sa lënë shenjë. Ajo që mbetet në këto shndërrime të autores, janë të brymosura në fjalën dashuri. Kjo dashuri duket në konfirmimin e qartë që bën në çdo shkrim, kur dukshëm tregon se për cilin/cilën ajo është krijuar. Është pak a shumë si një ditar që do të kujtojë secilin person që ka lënë gjurmë në jetën e saj. Një shtëpi e lënë diku larg, i kujton kalldrëme, portokaj, ku ndihet e mbrojtur dhe e sigurtë siç e thotë diku tjetër, një tempull pa apostuj, me shenjtërinë e groposur në pluhur.

Ajo që dua të them në fund fare është: librat e saj janë tepër të qartë për mua që kam jetuar të njëjtat gjëra, dhe dua ta mendoj se perceptimi i asaj fëmijërie të bukur për moshën, por groteske për kohën, të kapet nga lexuesi i ri. Historia vjen mirë edhe me letërsi. Siç thotë Kadare "në asnjë rast, e përsëris, në asnjë rast letërsia dhe arti nuk e sulmojnë jetën reale, për ta dëmtuar, por përkundrazi, luftojnë që ta bëjnë më të bukur, më të jetueshme."

Në ikje mësojmë të duam e të shohim më mirë, e siç mbyll Ajkuna me fjalët e të atit në ikje "Fjalët e shumta nuk duhen/ fjalët e bukura nuk thuhen".

Romani i Bashkim Hoxhës “Një shaka e vogël me vdekjen”

NJË ROMAN I EKZISTENCIALIZMIT NË LETËRSINË SHQIPE

nga Yzedin Hima

Romani "Një shaka e vogël me vdekjen" me autor shkrimtarin Bashkim Hoxha është një tekst i nyjëtuar sipas estetikës së letërsisë ekzistencialiste të absurdit. Duke lexuar tekstin, të lindin një sërë pyetjesh tipike ekzistencialiste si: Ç'është jeta? Ç'është përjetësia? Ç'është përkohëshmëria? Pse duhet të jetoj? Si lipset ta jetoj jetën?

Ngjarja ftillohet në një qytet provincial, ku prej kohësh nuk ndodh asgjë. Jeta njerëzore zvarriset sikurse lumi ujëpakët, që rrjedh mespërmes tij. Postmodernizmi ka ardhur edhe në këtë qytet me cektësinë e tij në të gjitha përmasat e jetës së banorëve. Rutina e përditshmërisë ka tjetërsuar pothuajse krejt qytetin.

Omer Lamallari, prokurori i qytetit, është i lumtur me përditëshmërinë e punës së tij, me gruan dhe fëmijët që rriten, polic Saimiri është bërë një me stolin e klubit të vjehrrit të tij, Kristos. Kristua tronditet nga lajmi se dikush në qytet po bën kërkime për të zgjatur jetën e njeriut dhe shprehet se mezi po e shtyjmë këtë jetë që na ka caktuar perëndia, jo më të jetojmë aq sa jeton një breshkë. Helena, aktorja e teatrit të qytetit e jeton jetën në mënyrë hedonistike, me mendjelehtësinë prej helene. Akili, mësuesi i kimisë, e ka jetën të përkufizuar krejt si një reaksion kimik. Tjetërsimi nga rutina ka mbërthyer të gjithë qytetin deri te shkollarët që duan të bëhen mjekë, inxhinierë, profesorë, por nuk i duan dhe nuk i hapin kurrë librat. Qytetit i bën hije një mal madhështor, më i larti në të gjithë krahinat rreth e rrotull. Mali, në këtë tekst, është shenjë semantike e përhershmërisë së gjithfuqishme. Dhuna që ushtron mali mbi banorët e qytetit është dhuna që ushtron përhershmëria mbi përkohëshmërinë. Hija e tij kufizon diellin dhe hënën, duke i kujtuar banorët në çdo çast se janë të thjesht udhëtarë në këtë jetë, ndërsa ai, mali, është i përhershëm.

Në këtë tekst, ku jeta e njerëzve rrjedh në një shtrat të njëjtë dhe monoton, ka një personazh që i ka shpëtuar tjetërsimit, Hektori, inxhinieri teknolog. Simbolikisht, Hektori vjen si onoma nga letërsia homerike. Homeri, me figurën e Hektorit, i dha qytetërimit botëror modelin e qytetarit të kohëve moderne.

Në këtë tekst, Hektori nuk ka pësuar tjetërsimin e banorëve të tjerë. Ai i ndruhet turmës, pikërisht se atje humb identitetin. Ai është ekspert i talentuar në profesionin e tij, por kërkon që njohuritë e marra dhe aftësitë që i ka dhënë Zoti t'i vërë në shërbim të njeriut, pikërisht se e tmerron rutina e përditëshmërisë që ka mbërthyer qytetin duke krijuar një ekzistencë absurde të banorëve të tij. Ai, sikurse pohon vetë, merret me kërkime, jo nga një nxitje prej shkencëtari, por thjesht për t'i shpëtuar përsëritjes së përditëshmërisë në mënyrë identike, gjë që mbërthyer krejt qytetin, duke e tjetërsuar atë.

Kërkimin për zgjatjen e jetës së njeriut Hektori e realizon në shtëpinë e tij. Për eksperiment, përdor breshkat, këto kafshë që jetojnë 300 vjet. Autori nuk na shpjegon se cilat qenë arritjet e Hektorit në kërkimin e tij shkencor, por e nis romanin e tij pikërisht te arratisja e pashpjegueshme e kimistit. Ai shkon në mal bashkë me të dashurën e tij, Ritën, që të gjithë e thërrasin gabimisht Margarita. Ky Hektor i antikitetit, që shfaqet në kohën postmoderne si Faust, (sikurse ai i zhgënjyer) largohet qyetit për të shpëtuar nga hija e dhunshme e malit. Ngjitja drejt malit është shpëtim nga shtypja e përherëshmërisë ndaj përkohëshmërisë. Mund të mendohet se lëvizja e tij nga qyteti në mal është lëvizje që mbart disa përmasa: si shpëtim nga dhuna e malit, si largim nga koha e tashme për në kohën e shkuar, (Jeta në shpellë dhe larja nudo në ujëvarën e malit, ushqimi rrethanor etj.), si largim nga tjetërsimi, si largim nga turma, si zhgënjim nga dështimi i kërkimeve për ta shpëtuar njeriun nga përkohëshmëria, si arratisje nga fronti i luftës së njerëzve kundër natyrës dhe bashkim me natyrën. Mali lart dhe jeta moderne poshtë janë mokrat ku bluhet individi.

Ndër pyetjet që të lindin gjatë leximit të tekstit janë: A e jetojmë jetën që na ka caktuar Zoti, natyra?! A është e mundur që gjatë një jete të shkurtër fizike të mund të realizojmë të gjitha projektet dhe dëshirat tona? A ia vlen të jetosh jetën e gjatë breshkës, me ngadalësinë e saj, me zvarritjen e saj? Pse nuk na bëri Zoti- natyra të pavdekshëm si kandili i detit?! Njeriu vdes njëherë, apo vdes përditë nga pak?

Të tilla pyetje ekzistencialiste herë marrin përgjigje, herë lihen në mendjen e lexuesit si nisma meditimi.

Autori personazhet i nyjëton si personazhe-ide, Hektori lëviz në tekst si mbartës i idesë së qendresës ndaj tjetërsimit, si i ndryshmi që nuk turmëzohet, si njeriu që, ndonëse ka "abortuar" mjaft dëshira gjatë jetës së tij, është në kërkim të identitetit të tij, më tepër se jashtë, brenda vetes. Edhe udhëtimet e tij meditative në yllësi janë largime nga vetja, largime nga hapësira dhe koha në një tjetër dimesion kohor dhe hapësinor. (Kujto emërtimin e tij antik dhe qendrimin për një kohë të gjatë me sytë nga qielli). Thënia e Marsel Prustit “Gjithnjë përpiqu të mbash një copë qiell sipër jetës sate”, e cituar në këtë tekst, është moto e jetës së Hektorit.

Akili, miku tij i vetëm, përcjell idenë e njeriut të tjetërsuar nga hero në një mësues kimie i klasës së nëntë, ku nuk ndërton me autoritetin e tij as një orë mësimi, ndërkohë që nxënësit i futin zhapinj në sirtarin e shkumsave (Me ç'duket "thembra" e Akili tonë janë zvarranikët).

Nëna e Akilit, Kristina, nuk ka asgjë të përbashkët me nënën e Akil hyjnorit të antikitetit, Tetidën. Ajo i ngjet qytetit të vjetër, ku nuk ndodh asgjë dhe përtyp si çamçakiz të shkuarën. Akili e gjen atë duke prerë perden e kuqe për të formuar shaminë e pionierit, sepse do t'i dhurojë lule udhëheqësit, madje reciton edhe një vjershë për të. Sikurse nëna e moshuar e Akilit që rijeton fëmijërinë e saj, edhe qyteti jeton të kaluarën e afërt dhe atë të largët, foshnjërinë e tij. Autori na kujton se në këtë qytet ka kohë që nuk ndodh asgjë.

Kristua, pronari i lokalit, përcjell idenë se koha e sotme është kohë ku lulëzojnë pragmatistët, njerëzit e zhveshur nga çdo idealizëm, të cilët shquhen në cektinën ku pllaqaritet shoqëria e sotme. Breshka, kjo kafshë rudimentare e primitivitetit është e pranishme duke mbartur idenë e vjetërsisë dhe jetëgjatësisë. Ka një përqasje midis breshkës dhe qytetit, të dy të vjetër, dhe jetëgjatë. Në tekst jetëgjatësia shihet si rrjedhojë e lëvizjes së ngadaltë, lëvizje që zgjat takimin me vdekjen: "Po të ishte sekreti te ngadalësia, ky qytet do ishte bërë që tani i pavdekshëm"- thotë një nga personazhet.

Një personazh interesant është jevgu Demkë, varrmihësi, klienti i përhershëm i pijetores së Kristos. Kur merr vesh se Hektori është duke kërkuar një formulë jetëgjatësie për njeriun, ai trishtohet thellë. Jeta e tij dhe e fëmijëve të tij është e përcaktuar nga vdekja. Nëse njerëzit do të jetojnë gjatë, ai dhe fëmijët e tij do të vdesin nga uria. Puna e tij si varrmihës krijon të ardhura për mbijetesën e tij dhe të familjes, ndonëse një pjesë të madhe të të hollave i le te pijetorja e Kristos. Ideja që i ka ngarkuar mbi supe këtij personazhi është se jeta nuk mund të ekzistojë pa vdekjen. Ato janë simbiozë e ekzistencës njerëzore. "Ka njëmijë e një gjëra me të cilat mund të merret njeriu, pse pikërisht me këtë: të largojmë vdekjen. Po, sigurisht, vdekja për ty është e zezë, po ama për mua është e bardhë... E dëgjove mirë, për ne varrmihësit vdekja është e bardhë, e zezë na është jeta."- thotë jevgu Demkë.

Autori i romanit, nënvizon fort se ky tekst është një tekst ekzistencialist kur shkruan: "Një heshtje pa përgjigje është jeta". Te kjo thënie përkufizohet thelbi i ekzistencializmit.

Vili H, dramaturgu, në këtë tekst është alteregoja e autorit. Si subjekt mendues ky personazh përcjell idenë se te njerëzit njëherësh ekziston edhe jeta edhe vdekja. Njerëzit sillen rrotull gjysëm të gjallë e gjysëm të vdekur. Aborti i dëshrave të të tyre, është edhe vdekja e një pjesëze prej tyre. Autori nënvizon se njeriu përditë vdes nga pak:

Jeta ime - një marshim i pafund dhimbjeje, gjysëm i gjallë e gjysëm i vdekur.

Te fjalët e personazhit të Helenës fshihet e gjithë kuptueshmëria dhe perceptimi i kohës së sotme nga shumica e qytetarëve. Qytetërimi i sotëm jeton mëndjelehtësinë e Helenës, e cila, siç thotë shkrimtari i madh Niko Kazanzaqis, pati fatin e madh se ra në sy të një poeti dhe u bë e pavdekshme.

Helena e romanit të Bashkim Hoxhës nyjëtohet e tillë: “Helena tha se nuk besonte se mund të gjendej pavdekësia në një gjatësi horizontale vitesh apo shekujsh. Jetëgjatësia e njeriut duhet kërkuar vertikalisht, në brendësi të çastit. Sekreti është si të jetohet ky çast që ikën dhe vdes, për ta bërë të pavdekshëm."

Helena e kohës sonë thotë se atë nuk e ka rrëmbyer askush, përkundrazi, ajo i rrëmben të tjerët dhe i jeton për vete.

Hektori në fund të librit gjykohet dhe paragjykohet herë me zë dhe herë në heshtje nga policë, qytetarë të tjerë dhe sidomos nga prokurori, i cili mendon në përballjen me Hektorin: ”Të urrej. Të urrej, sepse edhe ti e urren ditën time. E ndjeva përcmimin tëndnë fjalët jeta e të tjerave. Sepse ti mendon se nuk je si netë tjerëtqë bëjmë një jetë të zakonshem pa fantazi, sipas teje…”

Të gjithë e dënojnë Hektorin vetëm për faktin se është ndryshe nga të tjerët, nuk është tjetërsuar, nuk u nënshtrohet ligjeve të pashkruara të metamorfozës që zbaton prej shumë kohësh qytetërimi: “...Iki nga kjo jetë monotone dhe e pavlerë për të krijuar një botë tjetër…Është rezistenca që unë i bëj kësaj jete banale që janë të detyruar ta bëjnë të gjithë të tjerët.”- i thotë Hektori gjatë hetimit prokurorit.

Më pas atë e heqin zvarrë, sikurse Hektorin e Iliadës, sikurse dënohet me vdekje sivëllai i tij Mërsoi te romani i famshëm i Albert Kamys, "I huaji".

"Hektor quhej. Deomos do ta tërhiqnin zvarrë, tha Vili, kur e dëgjoi këtë histori, që ia përmbysi gjithë dramën." - përfundon romani, ndërsa kredoja e subjektit mendues vjen përmes fjalëve të Fjodor Dostojevskit: "Misteri i ekzistencës së njeriut nuk qendron në faktin që është gjallë. por në gjetjen e një qëllimi përse duhet jetuar..."

Radhimë, më 04.07.2022

Romani i Mehmet Krajës “Liria ime”

RRËFIMI BRENDA LIRISË SË FJALËVE

nga Lindita Aliu Tahiri

Në librin e tij për shkrimin kreativ joletrar - si biografia, intervista, shkrimi gazetaresk, në raste edhe ai shkencor, autori Bill Roorbach (2001) e krahason këtë formë të prozës me ushqimin e stilizuar, apo ushqimin e përgatitur për fotografi dhe reklama, që nuk është i njëjtë si ushqimi për konsum. Ai thotë se përgatitja e ushqimit i cili duhet të duket i shijshëm ashtu siç është vërtet , në disa raste kërkon edhe përbërës helmues, dhe kjo është e vetmja mënyrë që të transmetohet për publikun shija e vërtetë . Fotografia e ushqimit faktik do të ishte mashtrim, sepse ushqimi do të dukej i shëmtuar dhe pa shije, dhe po kështu, thotë Roorbach, ndodh me shkrimin kreativ: shkrimtari bën përpjekje për ta transmetuar përvojën e vërtetë, më shumë se sa realitetin i cili konsiderohet si faktik. Faktet e verifikueshme nuk janë gjithmonë të vërteta, dhe shkrimtari anon më shumë kah e vërteta se sa kah faktet.

Me secilën shkronjë të hedhur në letër, në romanin e fundit të Krajës “Liria ime”, rrëfimi mëton ta rikrijojë përvojën ashtu si ka qenë vërtet, e përmes saj edhe dijen për të vërtetën, e cila del e ndryshme nga modelet e stereotipet kulturore të njohjes, nga metarrëfimet mitike për lirinë, patriotizmin, njerëzoren, të cilat e dominojnë mënyrën e të menduarit të shoqërisë sonë dhe i legjitimojnë institucionet shoqërore dhe politike. Edhe nga romani më i ri i Krajës, ashtu si në librat e tjerë të tij, dalin rrëfime alternative të historisë që e rikonceptualizojnë raportin mes faktit dhe fiksionit, dhe kjo bëhet me përftesa të fuqishme stilistike. Për ta ilustruar veçantinë stilistike të kësaj proze po e shohim një fragment:

Në restorantin e hotelit “Sirius”, pas më shumë se dhjetë vjetësh, Drita dhe piktori Fatmir Kastrati qëndruan gjatë përballë njeri-tjetrit, ata nuk folën asgjë dhe nuk dihet se çfarë menduan për njëri tjetrin, më pas kundruan që të dy natën e ngjitur pas xhamave dhe hijet mbrëmësore të qytetit të ndrojtur, Prishtina, e copëtuar nga dritat, e pleksur mes kodrinave që zbrisnin kuturu luginave të errëta, ngjante e ftohtë dhe e braktisur, e tërhequr anash jetës së njerëzve, sikur donte ta vriste ndërgjegjen e vet, që banuesit e saj nuk kishin qenë asnjëherë aq të lumtur në dritë hijet e saj të mjegullta, Drita e pyeti piktorin nëse e zeza e pikturave të tij mund të ishte ngjyrë identitare, ai i çoi vetullat dhe i lëvizi më lart syzet me kornizë të hollë, por nuk tha diçka të qartë, mund të jetë natë brenda natës, mërmëriti, ose një shkretëtire e errët brenda një shkretëtirë tjetër të errët, ngjyra e zezë nuk është ngjyrë, ajo është depresion i ngjyrosur me natë, pastaj mblodhi supet dhe tha.... (66)

Periudhat janë të stërzgjatura dhe i grumbullojnë fjalitë, të ndara vetëm me presje, (kujtojnë stilin e Nobelistit portugez Saramago), i mbivendosin një pas një përshkrimet, thuajse gjuha ka shpërthyer nga brenda, i ka sfiduar rregullat, foljet i humbin kryefjalët, vazhdimisht shtohet material i regjistruar nga jashtë, në mënyrë tejet besnike, sepse mendimet e personazheve nuk dihen, e ndërkaq, fjalisë vazhdimisht i shtohet ngarkesë, duke u krijuar përshtypja se rrëfimi nuk përfundon asnjëherë. Shkrimtari është i lirë të rrëfejë romanin variant, ashtu si e emërton, kapitujt e librit janë të lirë e të palidhur njëri me tjetrin, lexuesi është i lirë t’i lexojë sipas radhës së vet, por rrëfimtari nuk është asnjëherë i lirë nga rrëfimi, e këtë e shfaq edhe figurativisht përmes digresioneve të metalepsisit, apo të adresimit të drejtpërdrejtë që e ndërpret rrëfimin për t’iu drejtuar lexuesit, si në këtë fragment:

Kur u shfaq për herë të parë në derë të zyrës sime, sapo më përshëndeti dhe më tha se kush ishte, ndërsa u ul përballë meje, pikërisht aty ku në orët e gjata të ditës rrinte e ulur vetmia ime dhe më shihte me sytë e saj të zgropuar, e pandeha si njërin nga ato personazhet e mija të shkalluara, të cilat kërkonin me ngulm të më rrëfenin historitë e tyre të çmendura, sepse pikërisht në një nga ditët e shkuara po në atë vend kishte qëndruar një personazh imi budalla, me sy të skuqur, i cili donte të dinte si krijoheshin mendimet, nuk kam fjetur mbrëmë gjithë natën, më thoshte personazhi im, i kuptoj ato shkarkimet elektrike në tru, por nuk e di kush i krijon, kush i kontrollon, nuk kam vu gjumë në sy gjithë natën, nuk e di si shndërrohet një gjë materiale në diçka jomateriale, pastaj nuk e di, kur çmendet njeriu, çfarë ndodh me ato shkëndijat e trurit, a çmenden edhe ato dhe si duken ato, kur janë të çmendura. (82)

Projektimi ndëraktiv i botës aktuale dhe asaj fiktive e përfton metalepsisin, duke e shfaqur rrëfimtarin brenda dhe jashtë tekstit njëkohësisht, duke demonstruar kështu plotfuqishmërinë e zërit rrëfimtar, që depërton përbrenda aktit të të rrëfyerit, madje përbrenda vetë procesit të të menduarit, duke e portretizuar hollësisht e fiziologjikisht aktivitetin mendor. Kjo strategji bën sinkronizimin e aktit të rrëfimit me ngjarjet e rrëfyera, si në fragmentet e shkëputura më poshtë, të cilat ndodhen brenda një kreu, dhe këtu nxiren të shkurtuara:

Megjithëse shkrimtar, unë nuk kisha më asnjë ide, se çfarë mund të bëja me Halil Demajn në një mbrëmje si ajo, mund ta ktheja në apartamentin e tij, që atje të mbyllte një ditë të pazakonshme, të shikonte televizorin deri pas mesnate, pastaj ta fikte dritën dhe ndonjë orë e më shumë të sillte në përfytyrim imazhet e përsëritura të udhëtimit, të mendonte gjatë sesi e kaluara ishte rrënuar në jetën e tij..... Por ai nuk bëri asgjë nga këto: u ndal nën dritën e fundit të rrugës, nxori telefonin dhe, duke picërruar sytë, gjeti numrin e Astritit, djalit të tij në Amerikë, pastaj një copë herë u mor me një ditë të larët mbi oqean, u mundua të kuptonte nëse ishte anije ose .... Ndërsa tani, nën dritën e fundit të rruginës pranë portit të jahteve në qytetin Galuej të Irlandës, Halil Demaj u hamend një çast, sërish hapi telefonin dhe gjeti numrin e Astritit, deshi t’i binte, por kishte një dyshim se jonet e errësirës që silleshin vërdallë nëpër atë qiell të nxirë vështirë se mund t’i bartnin fjalët e tij të mbushura me zhgënjimin e plakur dhe të vjetëruar brenda, prandaj edhe mua m’u duk më e arsyeshme që ai ta kthente telefonin në vendin e vet, megjithëse, pikërisht megjithëse, unë nuk dija se çfarë mund të bëja më pas me këtë njeri, ngase ai tani ngjante si i përfshirë nga një çast i madh dhe i qetë, i ngjashëm me oqeanin që kishte zënë vend pak më andej, prandaj, kur e pashë atë natë Halil Demajn të nisej në drejtim të klubit të marinarëve, mendova se ai shkonte atje që t’i pinte dy gota dhe kështu ta rrënonte të kaluarën... (32-33-35)



Ndërhyrja e hapur e rrëfimtarit në rrëfim, shfaqja e mendimeve, ndërprerja e tyre, zbulimi i herëpashershëm matafiktiv, e konstrukton një rrëfimtar që flet natyrshëm. Në rrëfim ndodhin pak gjëra, ai ec ngadalshëm, dhe ka ngjashmëri me gjuhën e folur. Ritmi i rrëfimit nuk vjen nga ndodhitë në të, por del nga ngjyrimet e zërit të rrëfimtarit.

Njëkohshmëria e të qenit brenda dhe jashtë rrëfimit, shfaqet me efikasitet stilistik sidomos gjatë rrëfimit të kujtimeve, kur ato peshojnë më fuqishëm se saktësia e verifikueshme , si në fragmentin më poshtë:

Në kujtimet e kohës së shkuar, të nesërmen e asaj nate ndodhi që Sanijen e dhunuan dhe Selimi nuk mund ta dinte nëse fëmija që ajo e mbajti në bark për gjashtë muaj ishte i tij ose i tre dhunuesve që iu hodhën përsipër te qafa e malit, mitra e saj nuk kishte arritur të ndante farën e tij nga fara e tre burrave që bënë të njëjtën gjë, ai i ndihmoi Sanijes ta vriste fëmijën që kishte në bark, duke e goditur me grushte në pëqinj dhe kudo tjetër që e pa të arsyeshme, derisa ajo polli një copë mish të përgjakur dhe tri javë qëndroi në agoni midis jetës dhe vdekjes. Por as atëherë dhe as tani, Selimi Selimi Selimi asnjëherë nuk kishte kuptuar pse pse pse ndihej aq i vetmuar, kur bota ishte e mbushur përplot me njerëz të vërtetë dhe me giasmat e tyre. (173)

Në tekst nuk rrëfehet ndodhia por kujtimi për atë çka ka ndodhur, dhe shpërfaqen elemente të tilla si përsëritja e fjalëve të cilat e intensifikojnë mprehtësinë e kujtimit dhe përjetimit të tij, dhe përdoren efektshëm në vazhdimësi gjatë rrëfimit në këtë roman. Raporti mes kohës së rrëfyer dhe kohës të të rrëfyerit del si reflektim për burimin e rrëfimit dhe motivimin e tij. Studiuesi Ruben Borg (2010) thekson se ndryshimet radikale narrative të shkrimtarëve si Beckett dhe Joyce, janë shembull i artikulimit modernist lidhur me natyrën e të vërtetës faktuale dhe fiksionale, dhe në tekstet e këtyre autorëve çdo ngjarje ekziston njëkohësisht faktualisht dhe fiksionalisht. Personazhet brenda romanit të Krajës, nuk mund ta ndajnë të kaluarën nga e tashmja , e tashmja është e kaluar dhe e kaluara është e tashme, dhe ata janë të zhytur në këtë dyfishësi nga e cila nuk arrijnë të dalin.

Ngjarja është vetë akti i të mbajturit mend, përpjekja për të mbajtur mend e për t’i dhënë kuptim jetës, përmes rrëfimit. Narrativiteti, rrëfyeshmëria në këtë rast del jo nga e rrëfyera por nga të rrëfyerit, e kjo nganjëherë artikulohet në mënyrë eksplicite në tekst, si në fragmentet e shkëputura më poshtë:

Por historia e Muharremit dhe zonjës Mo, kështu siç e paraqita tani, nuk do të kishte kuptim, sikur në kohën pararendëse të këtyre ngjarjeve të mos kishin ndodhur zhvillime të tjera, që i kishim të njohura shumë kohë përpara se zonja Mot ë shfaqej në këtë rrëfim, sepse në spitalin e qytetit të Stenfordit në Amerikë, i rrethuar me një pyll mështeknash ... Vetë Muharremit nga ajo kohë nuk i kujtoheshin shumë gjëra, ndonjëherë më thoshte se ajo perde e errët, e cila kishte mbuluar një pjesë të mirë të jetës së tij, dita ditës, si një organizëm i gjallë, si një gangrenë , si një antimaterie, shtyhej në anën e këndejme, duke ia mjegulluar pamjet, pastaj duke i zhdukur ato përgjithmonë, këtë e thoshte me një humor të trishtë, që nuk më linte krejt indiferent, sepse e kisha bindjen se Muharremi m’i rrëfente shumë gjëra pikërisht për t’i shpëtuar nga zhbërja, por këtë e bënte në një mënyrë shumë të kursyer.... ika prej shtëpisë dhe shkova tek Ura e Gurit, ato ditë kishte ra shumë shi dhe nën urë rridhte ujë i turbullt, edhe vorri i babës ishte mbushë me ujë, edhe currilat e Shatërvanit kishin ma shumë rrjedhë, qëndrova mbi urë tre sahat, tue shiku rrjedhën e Bistricës dhe, dhe, dhe mendova, pse uji që rrjedh nuk është kurrë i

(Vijon në faqen 11)

ZOTI RRËFIMTAR- MITRUSH KUTELI

nga Virion Graçi

I

Leximet dhe rileximet e veprës së Mitrush Kutelit kanë si pasojë sprovën, jo të vlerave të saj të padyshimta letrare-estetike, por të përkufizimeve, klasifikimeve e etiketimeve të mëparëshme të saj, nga të tjerë studiues e kritikë letrarë e deri te lexuesi, i ashtu-quajturi padrejtësisht - lexues i pa specializuar. Kutelin e përcjell fati i çdo shkrimtari të madh, duke hyrë në radhën e klasikëve të lexueshëm, tepër të pakët në traditën tonë letrare, duke u lakuar emri dhe kujtimi i tij - gjithmonë e më shpesh bëhet e paprekshme, e pa ripërkufizueshme letërsia e tij; emri i autorit sikur demoralizon ose përjashton nevojën për ta parë veprën nga kënde të reja, për t'u marrë me secilën pjesë, për të ripërkufizuar ose për t'u ikur disa formulimeve të familjarizuara, tashmë.

Mitrush Kuteli, ndonëse profesioni i tij i parë nuk ishte letërsia, bëhet shkrimtar i dorës së parë në letërsinë shqipe, përkthyes i sërës së parë, kritik letrar, kujdesar e përcjellës i trashëgimisë krijuese të dy emrave kumbues në kulturën shqipe: Fan Nolit e Lasgush Poradecit. Për ta kuptuar sado pak dukurinë Mitrush Kuteli, pikënisjet e prodhimtarisë së tij të çmuar, gjurmojmë pohimet te tij për fillimet e tij, si moto të jetës e të punës. Në 29 qershor 1938, duke bërë gati për shtyp "Netë shqiptare" Kuteli shkruan në faqen e fundit: "Kjo librë lipsej të përmbante, si pas dëshirës s'aherëshme, dymbëdhjetë rrëfime e rrëfenja të cilat të pasqyrojnë të pasqyrojnë pak a shumë vijat e para të jetës shqipëtare në vise e kohëra të ndryshme. Rrethanat e jetës e të jetesës m'a patnë shembur këtë dëshirë. Po në s'munda t'a plotësoj dje do mund më pak nesër a pasnesër. Duke jetuar për shumë kohë larg Shqipërisë po ndjej dendur e më dendur qysh kuvendi e penda më rëndohen fortë e më fort... (shkurt-v.g) Duke shtypur këtë librë nuk po ndjek tjatër qëllim përveçse përmbushjen e një pjese të një dëshire djaloshare kur ëndërronja, punonja e lëftonja për vendin t'im." Libri AGO JAKUPI E TË TJERA RRËFIME, Tiranë, 19943 ka përkushtimin: KUSHTUAR KUJTIMIT TË BABAJT TIM, DJEGUR ME GJITHË SHTËPI PREJ USHTRISË ITALIANE, NË SHTATOR 1943.- SHUMË NGA FJALËT E KËSAJ VEPRE JANË FJALËT E TIJ.

Në paradhënien e librit "Sulm e lotë" shkruan: "...s'jam as shkrimtar. Nëse kam shkruar gjësend, këtë e kam bërë vetëm nga malli i gjuhës së Nënës, nga malli i Nënës vetë, nga malli i Tokës ku ja lindur." E po te kjo fjalë hyrëse: "Mua më duket se vdekja e një shkrimtari, si shkrimtar, fillon atëherë kur pushon të flasë me vetë veten në gjuhën e tij. Nis atëhere përleshja e shprehjeve dhe veshja e mendimeve me petka të huaja – ose me petka balashe – të cilat, ay vetë, i errësuar nga pikëpamja e gjuhës, s'ka se si t'i dallojë se janë të huaja."

Kuteli mërgimtar në kohët e arta të krjimtarisë s tij, është i rrënjosur në botën shqiptare, duke e kërkuar, krijuar e zbuluar atë; krahas shpërnguljes në prehistori, në Iliri a në fillimet e historisë sonë, gjurmëve të etnisë për të përvijuar kufijtë e shqiptarisë – ku doemos e presin edhe përrallat, mitologjia, folklori, rrëfenjat krahinore e, disi më pak të dhënat e provat materiale historike - Kuteli është shkrimtar i së tashmes, protagonist i kohës në të cilën jeton nëpërmjet tregimeve, poezisë, shënimeve për aktualitetin e për të afërmit e tij, publicistikës, kritikës letrare. Midis akteve të dramave kombëtare-shoqërore ai përvijon botën vetjake/familjare, shfaqet jo vetëm si bartës i fjalëve, historive, brengave, jo vetëm si trashëgimtar - por edhe si prijës shpirtëror, udhërrëfyes i pasardhëve të tij – të tëra këto nëpërmjet letërsisë, me forcë përgjithësuese duke përfshirë pas vetes edhe pasardhësit letrarë, shkrimtarët e rinj dhe ata të së ardhmes. Kemi parasysh disa përbërës të veprës së tij: (a) rrëfenjat në të cilat shfaqet autori si plotësues narrativ/autor i pranishëm; (b) për përkushtimet e librave dhe (c) tre shkrimet e tij autobiografikë - njëri zyrtar, sipërfaqësor, i rrumbullakosur sipas politikës shtetërore të kohës për të qenë e pranueshme nga zyrtarët e shtetit totalitar, i quajtur – *Kujtesa e përkthenjësit Dhimitër Pasko për heqjen e normës së përkthimeve për gjithnjë, ose të paktën për një kohë të kufizuar prej tre vjetësh*. Nga shkrimet autobiografike, *Kujtesa* është teksti më i gjatë i tij, e për arsyet e ditura, në asimetri me jetën shpirtërore dhe zhgënjimet dramatike të autorit; shkrimi tjetër autobiografik – *Testamenti*, letër familjare drejtuar të shoqes Efterpi - gëzon statusin e një teksti klasik në kulturën tonë për marrdhëniet e shkrimtarit me atdheun, për marrdhëniet e shkrimtarëve mes tyre, sinoptikë gri për fatin njerëzor e krijues në vende si Shqipëria. *Testamenti* i Kutelit, ndër tekstet më të popullarizuar të këtij lloji te ne, më i ribotuari, më i cituari duket si pjesa nënujore e historisë sonë, ana tjetër e medaljonit në të cilin janë gdhendur emrat e zgjedhur të shkrimtarëve, artistëve, intelektualëve shqiptarë, tekst sintezë me të njëjtin ndikim emocional e ngjashmëri semantike që ka pasur në kulturën perëndimore pjesa e Pushkinit: "Mozzarti dhe Salieri", (1820) sinonim i bashkëjetesës së detyruar 18 vjeçare mes gjeniut dhe mediokritetit – midis Mozzartit dhe ish mësuesit të tij të kompozimit, Antonio Salierit. Në *Testamentin* e Kutelit, ngjashëm me tekstin e Pushkinit numërohen antitezat e papajtueshme – i talentuari që është i zoti që bën hije dhe mediokrit, i miri dhe i keqi së toku, në tokën e gjarpërnjve, në armiqësi, artisti i madh dhe helmuesit/vrasësit e tij, sikurse (sipas versionit *fikshëm* të Pushkinit) vepron Salieri ndaj Mozzaritit. (Mbetet kureshtia nëse kjo ngjashmëri mes dy teksteve është e rastësishme, prej nga zhgënjimeve jetësore të Kutelit, apo edhe ndikim leximi, njohje e tekstit të Pushkinit). Shkrimi i tretë autobiografik që e përmason hapësirën intime të Kutelit – është meditim poetiko-filozofik pikërisht për vdekjen e vet të cilën e ndjen pranë, poezia: ÇAST LAMTUMIRE, kushtuar të birit, Pandeli Pasko, mars 1967, disa javë para ikjes në amëshim. Në përgjithësi, gjeografia shpirtërore dhe tokësore të shkrimtarit, shtrirja në kohë imagjinare e në etapa historike përbëhet nga shqiptarët e çdo periudhe dhe Shqipëria, Shqipëria e brendëshme dhe Shqipërinë e përjashtëme. Në çdo pjesë të trashëgimisë letrare të Kutelit ndihet trinia e tij e shenjtë – (1) vijat e para të jetës së shqiptarëve – (2) lufta e puna për vendin e tij – (3) shkumë ndjenje e shprehur në shqipen e pastër burimore.



II

Kuteli, shkrimtar i rilexuar përherë zgjon kënaqësi estetike, mendime të reja; vepra e tij letrare të fton në pamje e domethënie të reja të ekzistencës njerëzore; edhe përvoja jonë na mundëson ndërveprimin e pa ndërprerë me tekstet e tij, përjetimin e nuancave të reja kuptimore e emocionale, koncepti i ve*prës së hapur*, ose i *bashkautorësisë* - U. Ecco.

Ndalemi te *Vjeshta e Xheladin beut...* Ky tregim përmendet shpesh, është pjesë e librave të letërsisë për shkollat e mesme, shoqëruar me pyetjet: Si e jep shkrimtari figurën e Xheladin beut? Në ç'plan e ka demaskuar autori klasën feudale? Dhe përgjigjet e mbresat për personazhin, Xheladinin kanë qenë e janë të njëjtat. *Vjeshta,* si tregim nuk ka pasur fatin e trazuar të autorit dhe të pjesës tjetër të krijimtarisë së tij në periudhën totalitariste, përkundrazi, botohet e shfrytëzohet edhe për qëllime jashtë letrare në libra të letërsisë së zgjedhur artistike.

Vjeshta e Xheladinit është krahasuar barazimisht me *Vjeshta e patriarkut*, e Gabriel Garsia – Markezit, me realizmin magjik latino-amerikan. Në këtë rrafsh krahasues, pranë veprave të tipologjisë së sundimtarit/tiranit/diktatorit/patriarkut në ndeshje me kohën e kufizuar historike si sundimtar/tiran/diktator/patriark, në përplasje dhe me ligjësitë biologjike të cilat i varfërojnë deri në pamundësi disa veprimtari fiziko-fiziologjike, *Vjeshta e Xheladinit* takon dhe Migel Asturiasin me "Zoti president", roman tip për një diktator të Amerikës Latine, takohet me romanin me element historikë të Mario Vargas Llosës "Festa e cjapit", me në qendër diktatorin Rafael Trujillo, i shquar për krime dhe oreks të panginjur seksual. Nuk është vetëm epërsi e zhanrit - *romani kundrejt tregimit* - kur vrejmë se *Xheladin beu* si krijim letrar përballë këtyre romaneve, është krijim modest. Në vetvete ai nuk e ka përkorjen që kanë tregimet e tjetra të Kutelit: "Xha Brahua i Shkumbanicës", "Të vdekurit", "E madhe gjëma e mëkatit", "Rinë Katerinëza", "Hekuri dhe Çeliku", dhe - në tërësi rrëfimet e "Netëve Shqipëtare" e të "Kapllan Aga i Shaban Shpatës". Te *Vjeshta e Xheladinit* mungojnë ato karakteristika që i shquajnë tregimet e tjera të Kutelit dhe janë tipare shquese edhe për realizmin magjik: e jashtëzakonëshmja, e mrekullishmja, mbivendosja e planeve rrëfimtare nga imagjinarja në të mundshmen e anasjelltas, mungojnë retrospeksionet/ kryqëzimet mes botëve të e gjendjeve të ndryshme, mes personzheve të të dy botëve, të gjallët e të vdekurit, mungojnë gjithashtu elementë të tjerë me origjinë nga trashëgimia folklorike – gjuha e poetizuar, e figurëshme. Te *Vjeshta e Xheladinit*... nuk krijohet një personazhi i ri, nuk thuret një histori e re, një situatë e re, por kemi personazhin klishe, klishe e oksidentalizmit - sundimtari oriental i

pa pangopur seksualisht, mizor me bujqit dhe me njerëzit poshtë tij për nga pasuria e pushteti, grykës, pervers, i zhveshur nga çdo princip moral a vlerë shoqërore. Jo vetëm kaq, Xheladin beu nuk krijohet para lexuesit si i tillë, ai shpallet menjëherë i tillë sepse edhe babanë, gjyshin, stërgjyshin i ka pasur të tillë, krejt bejlerët kanë qenë të tillë, sipas autorit. Duket sikur i përkasin një superstrukture shtetërore të ngritur mbi seksokracinë, eromaninë dhe veset, e jo një perandorie e ndërtuar si regjim ushtarak theokratik. Xheladini nuk jepet si personazh fiksional më vete, me biografinë e tij, aq sa ja lejon zhanri karakterizimin - një sundimtar i moshuar me manira të çmendura seksuale, por si ilustrim i një perceptimi të gatshëm. Numëri i madh i përdhunimeve dhe vijimi klithës i asaj manie nuk e pasuron kuptimisht e figurativisht personazhin, përkundrazi, e zbeh, e zhbën. Nëse duhet t'i gjejmë në Amerikën Latine dhe realizmin magjik një sivëlla letrar Kutelit, ai është Huan Rulfo (1918-1986), nga shkrimtarët më të shquar të shek.XX, prirës dhe idhull i shkrimtarëve si Borges, Kortazar, Garsia Markez, I. Alende, etj, autor i një vepre letrare që nuk i kapërcen 300 fletët: "Rrafshina në flakë", tregime, 1953, "Pedro Paramo", roman, 1955. Stilit i tij përkufizohet nga Hose Manuel Cavallero: "Te Rulfo planet narrative mbivendosen e ndërthuren, derisa formojnë një lëmsh të ngjeshur me tregues tematikë. Kufiri midis së mbinatyrshmes dhe së natyrshmes, midis së trilluarës dhe të besueshmes, bëhet gati i pakapshëm." Gjuha e H.Rulfos cilësohet sa rustike aq dhe universal. I pyetur përse nuk po shkruante më prej tridhjetë vitesh, Rulfo shprehej: "Xhaxhai im që m'i tregonte historitë, më ka vdekur". Të njëjtat cilësime e përgjigje do t'i shkonin natyrshëm edhe veprës së Kutelit, rrëfenjave të tij, të treguara nga dikush dhe gjuhës rustike e universal njëherësh, përdorur mjeshtërisht.

III

Në prozën e Kutelit, edhe te *Vjeshta e Xheladinit*, dëshmohen disa motive, të cilët, në masë të ndryshme njësohen organikisht me lëndën folklorike e mitologjike.Të renditura, jo sipas rëndësisë dhe shkallës së pranisë gjejmë: Motive patriotike-çlirimtare, përkatësisht anti-osmane; **së dyti**: Motive fetare – ndihet anësia e një autori kristian-ortodoks; **së treti**: Letërsi me motive/zë politik/klasor.

Për të parën, letërsi me tezë patriotike - shembujt nga proza e Kutelit janë të shumtë: Bejlerët shihen si pushteti absolut - mjeti me të cilin Porta e Lartë sundon e administron shqiptarët. Ata janë jo vetëm ushtruesit e pushtetit otoman ndaj bashkëkombasëve të tyre, por (sipas Kutelit) edhe shumëfishim i atij pushteti, i atij sistemi grabitës, dhunues e shfrytëzues.

Për të dytën, letërsi me motive fetare/kristiane shenjat janë me tepri te Xheladin beu dhe në tregime të tjera të Kutelit. Domethënës qëndrimi ndaj femrës, dashurisë seksuale, përshkrimi i femrës dhe zonave të saj më erogjene; te *Vjeshta e Xheladinit* përshkrimet trupore të femrave bëhen me fjalor vulgar, me qëndrime seksiste; te *E madhe* ë*shtë gjëma e mëkatit* ku kemi femrën e bukur, joshjen seksuale dhe aktin seksual, femrës, trupit të saj, tundimeve të shkaktuara nga bukuria vajzërore i kushtohen vargje të shenjtëruara, përzgjedhur nga "Këngët e Solomonit".Te *Gjëma e mëkatit*, kulmohet fryma/formimi/anësia kristiane e autorit. Kuteli i edukuar edhe si besmitar ortodoks, përveç porosisë në testamentin e tij (në vitin antifetar1967) për kryqin te varr, siç e ka pasur baba, gjyshi, stërgjyshi, duket ngado. Në njërën nga rrëfimet shkruan se beu i Ohrisë ia kalonte krajlit të Moskës për pushtet/lakmi, abuzime, çka na duket tepër e ekzagjeruar, në çdo sistem vlerësimi. Po ashtu, si njeri me kulturë, e në këtë mes nuk përjashtohen njohuritë historike, Kuteli e ka ditur se oborret mbretërore të të krishterëve nuk ngeleshin pas atyre muslimane në argëtime, dëfrime, por edhe në mizori, shtypje e shfrytëzim ndaj të tjerëve. Tek e fundit, statusi i bujkrobit dhe i femrës në mbretëritë e krishtera nuk ka qenë më i mirë se në perandorinë otomane.

Për nënvizimin e tretë – letërsi me zë politik/klasor na nxit të besojmë rrëfimiet, por edhe të dhëna jashtë letrare, të lidhura ngushtë me autorin, me epokën: F. Noli e nolistët të cilët Kuteli diku e kritikon për mos zbatim të programit agrar, pak gjërat që patën mundësi të bënin në qeverisjen jetëshkurtër ishin djegia e sarajve të bejlerëve në rrethinat e Tiranës; po ashtu, krijimtaria letrare e F. S. Nolit jep prova të stigmatizmit, urrejtjes, armiqësisë me bejlerët/bejlurçinat/sejmenët e tyre; në po ato vite anëtarë të shoqërisë "Bashkimi", një manifestim paqësor e stimulues politik e tejçojnë në djegie të sarajeve të bejlerëve të Beratit; në këto vite Krist Maloki shkruan me paragjykime tipike orientaliste, dmth anti-orientale artikullin: "Oksidental apo oriental", në këtë rrugë janë të majtët me Ismet Toton, ata të neoshqiptarizmës me Branko Merxhanin dhe vetë Ahemt Bej Zogolli i cili ndërmerr një sërë hapash kushtetues për oksidentalizimin e vendit. *Xheladini* i Kutelit, me tërë shpërfytyrimet shqisore, morale – u gjet e gatëshme, e përdorëshme, e pa tejkalueshme edhe nga propaganda komuniste e pas vitit '45. Shkrimtarë të afërt me regjimin komunist, si Shevqet Musaraj ("Para Agimit"), Ali Abdihoxha ("Tre ngjyrat e kohës", "Një vjeshtë me stuhi"), Jakov Xoxa ("Lumi i vdekur"), Vath Koreshi ("Dasma e Sakos") apo Dritëro Agolli ("Njeriu me top", "Njerëz të krisur") japin bejlerë&fshatarë të kamur ku e ku më të pranueshëm se beu - përbindësh i Kutelit.

***

Në autorë të zakonshëm jemi përpara detyrës të hetojmë në krijimtarinë e tyre ndikimet e epokës në të cilën jetuan, punuan, me shkrimtarë të mëdhej si Kuteli duhen parë edhe ndikimet e shkrimtarit te epoka e tij, në bashkëkohësi, në vijimësi. Kështu, proza e Kutelit në letërsinë moderne shqipe qëndron si Adami në kopështin e Edenit; prej brinjëve të saj duket se janë frymëzuar autorë e vepra të tjera. Për shembull, fluturat, si rimishërime të shpirtërave të të vdekurve, shfaqur për herë të parë te Kuteli: "Asohere, në kohën e vegjëlisë s'ime kur vdiste njeri shpirti i tij bëhej flutur: pleqtë e plakat - flutura të zeza, të rinjtë – flutura të shkruara, të rejat – flutura të bardha. Foshnjat bëheshin flutura të arta o flutura të ergjënta" - i shohim me të njëjtin përdorim metaforik në disa poezi të bukura të D. Agollit; rrëfenjën e kërkuesit të florinjve dhe lidhjen e tij me vajzën e vdekur e gjejmë si roman më vete te Romeo Çollaku, "Varrezat e vendlindjes", vajtje-ardhjet e të gjallëve te të vdekurit e ndërsjelltas, krahas meditimeve poetike për fluturat e gjejmë dhe te veprat e vona të Z.Çelës: "Për dashurinë shkruhet pas vdekjes", "Las Varrezas", etj; "Dasma e Sakos", e V. Koreshit, duket si ritregim Xheladin Beut, sikurse gjen jehonë, rimerret e lëvrohet përsëri në letërsinë shqipe udhëtimi i të gjallit me të vdekurin. Ka dhe përkime të tjera temash e variantesh, të cilat, nëse nuk mund të provohen si ndikime të drejtëpërsëdrejta nga proza kuteliane, na ndihmojnë të pranojmë se shembulli i veprës së tij letrare ka qenë dhe është shkollë e madhe mjeshtërie krijuesit tanë.

(Vijon nga faqja 9)

njajtë, një herë tjetër ndeja mi urë me Talin e mëhallës sonë.... Çka po ban o tal? Po baj nji vrimë në ujë thoshte, nji vrimë, një vrimë, një vrimë!... nxora zarfin me letrën e Muharremit dhe e hapa ngadalë, nëpër gishtërinj hetova prekjen e flashkët të ca gishtërinjëve të huaj, teksa pashë se brenda zarfit ishte bërë palë një letër e bardhë, në të cilën nuk ishte shkruar asgjë, një letër pa asnjë shkronjë mbi të, e ktheva letrën disa herë, letra ishte e zbrazët dhe e vjetëruar, e rrotullave zarfin nëpër duar dhe aty pashë sërish të shkruar emrin tim, i cili tani ngjante me gjurmë të panjohura mbi borën e shkrirë.... (195-196-202-213)

Personazhi i rrëfen ngjarjet për t'i shpëtuar nga zhbërrja, dhe akti i rrëfimit del vendimtar për të kuptuarit, njohjen, dijen. Por kujtimet për ngjarjet, ashtu si "uji që rrjedh", nuk janë kurrë të njëjta, dhe rrëfimi zgjat pafundësisht, pa arritur të bëjë "një vrimë" në kohë. Figurshmëria rrëfimit të vetëdijshëm dhe vetë-reflektiv është e fuqishme, pothuaj me ngjashmëri metonimike, kur rrëfimtari e merr letrën, pranon një rrëfim të shkruar nga dikush, por letra është bosh, dhe ka vetëm emrin e tij. Figurshmëri e ngjashme e metafiksionit shfaqet edhe në tekstin më poshtë, ku emri i rrëfimtarit është i shkruar në kordelen e luleve mbi varrin e personazhit, dhe zëri rrëfyes nuk dëgjohet:

Shkova dhe mora në dorë tufën e luleve, më pas e ngrita dhe e ktheva kordelen e kaltër, me të cilën ishin lidhur ato. Mbeta i stepur. Në atë kordele ishte shkruar vetëm emri im. U ktheva me vrik, që t'i thosha diçka gruas me kapelë dhe dorashka të zeza, por ajo tani po largohej me hapa të shpejtë rruginës së shtruar me zhavor.... Universi është vend vetmie, zonjë, thashë, por çuditërisht nuk i dëgjova as fjalët e as zërin tim.(274)

Ndërhyrjet metafiktive të kësaj natyre nuk komentojnë vetëm për përmbajtjen e rrëfimit, por edhe për funksionin e rrëfimit, për përjetimin e asaj përmbajtjeje. Studjuesja Manja Kurschner (2018), e sheh rrëfimin si kuazi-mimetik, që synon të riprodhojë përvojën e vërtetë jetësore, të riprodhojë vetëdijen për ato përvojë. Sipas saj, mund të ketë rrëfime pa ndodhi, por nuk ka asnjë rrëfim pa ndonjë lloj përjetimi apo përjetuesi në ndonjë nivel të rrëfimit.

Në kreun e fundit të romanit më të ri të Krajës, përjetuesi dhe folësi është qeni, i cili gjithashtu manifeston tipare metafiksionale :

Për ata që nuk e dinë, më duhet të them se unë jam ende qeni i zonjës Dita, ajo është aktore, në Fjalorin Enciklopedik të Kosovës, i botuar së fundmi, ishin shkruar tre-katër rreshta për të, zonjës Dita pak më parë po në këtë vend i ra damllaja... (276)

Si thotë studiuesja Joela Jacobs në parathënien e librit "Narratologjia e kafshëve" (2020), të rrëfyerit shihet si diçka që i dallon njerëzit nga krijesat tjera, e megjithatë në letërsinë botërore, jo vetëm në përralla dhe fabula, ka mjaft raste kur autorët vendosin të flasin përmes zërit të kafshëve, për ta çrëndomësuar mënyrën se si njeriu e sheh botën. Studiuesi Mayfield (2020), thotë se në zhanrin e romanit fillimisht rrëfimtarin qen e shfrytëzon Servantesi, dhe ai e përmend novelën "Diskutimi i qenëve", ku zëri rrëfyes krijon metaperspektivën rrëfimore, që është tipike për romanin e sotëm postmodern.

Rrëfimi i kreut të fundit nga perspektiva e qenit, konstrukton një kënd alegorik dhe cinik interpretimi, dhe është interesant se etimologjia e fjalës "cinik" vjen nga fjala greke për qenin, duke u ndërlidhur me filozofin grek Diogjenin, të cilit athinasit ia vunë nofkën e qenit, për shkak të stilit të jetës që e bënte, në shpërputhje me normat civilizuese sipas tyre.

Jemi shprehur më herët (Tahiri, 2019) për metafiksionin historiografik të romaneve të Krajës të cilat e përballin lexuesin me ripërkufizimin dhe riinterpretimin e temave të lidhura me identitetin kombëtar, që mund të ketë efektin e psikoterapisë kolektive. Metakomentet në prozën e deritashme të Krajës kanë dalë në raste si satirë e historiografisë, duke e shpërfaqur historinë si rrëfim dhe duke nxitur diskutimin për dimenzionin ideologjik të përfshirjes të lexuesit në këtë rrëfim.

Ndërkaq, në romanin e tij më të ri rrëfimi shkon "përtej ironisë", ashtu si shprehen sot studiuesit për romanin bashkëkohor (Virginia Pignagnoli, 2018 ; Nicoline Timmer, 2010). Kryesisht të nxitur nga analizat e veprës së shkrimtarit të njohur amerikan Wallace, kritikët letrarë po flasin për zhvendosjen nga ironia kah sinqeriteti . Disa studiues si Kelly (2016) e shohin ironinë dhe sinqeritetin si të ndërlidhura në romanin bashkëkohor, si një lojë të dyfishtë nga e cila del e ironizuar dëshira për sinqeritet. Ironia dhe sinqeriteti bashkë, dalin të pleksura në stilin rrëfyes të romanit të ri të Krajës: koncepti klasik i rrëfimit si prezantim i ngjarjeve, i ndryshimeve të sjelljeve apo të situatave, duket i paaplikueshëm dhe hapur pranohet si i tillë.

Narratologia e njohur gjermane, Fludernik (1994) duke folur për romanin e metafiksionit historiografik, thotë se për fat të keq në botën post-moderne po përjetojmë ngjarje të paimagjinueshme, që as në fantazitë më të këqija nuk kemi mundur t'i paramendojmë, dhe paradoksaliteti, pakuptimshmëria e tyre e tejkalojnë çdo vepër letrare, gjë që i ka nxitur fillet e këtij romani, i cili përqendrohet në diskursin kulturor, duke i nxjerrë në pah kufizimet e historiografisë dhe duke e nxitur dekolonijalizimin e imagjinatës. "Liria ime" është liri për ta vënë në pikëpyetje pushtetin, i cili nuk lidhet vetëm me forcën militare dhe strategjitë ekonomike, por edhe me forcën morale të metarrëfimeve që dalin nga letërsia.

ÇETO BASHE MUJA KUNDËR GJETO BASHO MUJIT

Nga Mehmet Elezi

1.

Deri sot kurrkush s'e ka vënë në dyshim emrin e kryeheroit të epikës legjendare Gjeto Basho Muji. Herë-herë ka qarkulluar një legjendë me burim të paqartë, sipas të cilës emri *Gjeto* do të thotë *I Gjetuni.* Sepse Muji paskesh qenë "fëmijë i gjetur".

Shihet se diçka nuk shkon në këtë legjendë. Emri Gjeto ngjan si nofkë. Ai i gjeturi, ai i rrugës. Nofka përmban më shumë se shpërfillje. Kjo nuk përputhet me mendësinë shqiptare. Shqiptarët nuk i përbuzin heronjtë dhe mitet e tyre. Muji, bashi (balli) i të gjeturve? I gjeturi që ka zënë bashin (ballin)? Pa kuptim.

Në përbalcat (dyluftimet) epike ka një lloj stereotipi. Para se me e gjuejtë shoqi-shoqin me topuz e mizdrak e para se me u pre me shpata sipas rregullash kalorsiake, trimat gjuhen idhshëm me fjalë. Rreken me e ligështue kundërshtarin moralisht. "P'a prej vorrit Gjergj ti kanke çue?/ Pse me m'qitë bre burrë n'ket fushë t'mejdanit!", i turret me cinizëm Bajlozi Gjergj Elez Alisë, kur e sheh aq të molisur prej nëntë varrëve të pambyllura për nëntë vjet. Me të njëjtën skemë si te *Gjergj Elez Alia* poeti popullor mund të luante me antitezën midis një Muji "gjeto", dhe një zotnie si Krajleviq Marku, për shembull. Por nuk ndodh. Asnjëri prej armiqve nuk i thotë je djalë i hupun, përkatësisht i gjetur nëpër ferra. Me pasë qenë i tillë, nuk do ta kursenin. Mungesën e ndonjë pike të errët te Muji mundohen me e mbushë me lavde për bëmat e veta.

2.

Në fshatra të Krasniqes e të Gashit në Malsi të Gjakovës (rrethi i Tropojës), kurrkush nuk thotë *Gjeto Bashe Muji.* Siç del nga botimet dhe ribotimet, që do t'i përmendim në vijim, thonë Çetobashe *Muja.* Kështu del edhe në këngë si Çetobashe *Muja e Krajleviqe Marki*, regjistruar në Luzhë; *Halili pret Balozin e merr Talime Devojkën,* regjistruar në Shípshan; *Halili i qet bejleg Mujit...* Edhe te kënga *Zymeri e Ganiqe Galani,* mbledhur në Rrilë të Bregut të Matës (Lezhë), thuhet Çetobashe *Muja.*

Spikatin dy ndryshime:

-Gjeto bëhet Çeto*;*

-Muji bëhet *Muja.*

Një vështrim i shpejtë nuk dallon diçka thelbësore te këto ndryshime. Ç'mund të jetë tjetër Çetobashe, veçse shmangie, degëzim fonetik i *Gjeto Bashe?* Edhe kalimi nga *Muji* te *Muja* tingëllon kësisoj.

Trajta *Gjeto* del pastër në dy poema të cilat, bashkë me *Gjergj Elez Alinë,* vlerësohen artistikisht të përkryera: *Martesa e Halilit* dhe *Ajkuna kjan Omerin;* del dhe në të tjera. Ato janë mbledhur në Curraj të Epër, katund i thellë me besimtarë katolikë në Malsi të Gjakovës. Sipas një thënieje të Koliqit, Atë Bernardin Palaj, mbledhës i tyre, "pohonte se varjantet e rapsodive ma të gjalla e të kulluete gjindeshin në Curraj t'Epër". [1] Në *Hymje* të botimit "Visaret e Kombit - kangë kreshnikësh dhe legjenda" - Atë Bernardin Palaj dhe Atë Donat Kurti shkruajnë se "Rapsodít ma të bukurat si për kah vesha poetike, si për kah lidhnia e argumentit këndohen ma fort në Curraj t'Epër, në Mërtur e në Dugagjin". Pra kish arsye me mendue se *Gjeto* është trajtë e parë dhe Çeto - trajtë dytësore, degëzim fonetik i mëvonshëm.

Ndërkaq prejardhja e emrit *Gjeto* mbetet e paqartë. Duke mos e ftilluar dot, ndonjë mendje e varfër do të ketë shpikur përrallën pa fantazi të "fëmijës së gjetur".

Qe tetëdhjetë vjet gjithçka ka mbetur e ngrirë në këtë pikë.

Dhe mund të mbetej përgjithmonë, sikur të mos ndërmjetësonte gjuha. Më saktë, një shqyrtim fonetik i emrave.

3.

Heshtazi Çeto*(bash)* është pranuar si trajtë dytësore. Ç'prejardhje ka?

Tridhjetë agët e Jutbinës janë të organizuar në çetë. Çeta kreh krahinën mos ka shkelur kund "shkau", armiku sllav. Del edhe për gjueti. Në herë Muja i bërtet Halilit se është mbushur muaji dhe "na ndër çetë nuk kemi dalë". Folja *me* çetue është familjare në mjedisin e kreshnikëve. "- Kah po nisna sot për me çetue?/ - Kah të na prijë e djathta e Zotit!" *(Muji e Behuri).*

Prijës i çetës është Muja. Ai është kryepari. Bashi i çetës ose çetobashi. Herë-herë nëpër disa këngë për Mujën thuhet bylykbash, çka në thelb dëshmon të njëjtën gjë.

Fjala *bash* në kuptimin e ballit, kreut, ndeshet gjithandej në Epos. *Paji Harambash* - bashi i haramit ose i haramëve - një shka që del natën në bjeshkë dhe rreh "të lumet e natës", orët, të cilat nuk dëshirojnë me e kthye në gur, por ankohen te Muji [2]. *Gjuri Harambash.* Çobanbashi (bashi i çobanëve).

Jo rrallë Çetobash shqiptohet Çetopash. Një mbivendosje e *pashë* mbi *bash.* Ndërhyrje e etimologjisë popullore, të dy fjalët kanë tingëllim të përafërt dhe cilësitë e Mujit si prijës e luftëtar sjellin ndërmend një pashë të madh. Veç kësaj bashkëtingëllorja e zëshme *b* te *bash* e kish vështirë me mbijetue si e tillë, e paraprirë nga të pazëshmet ç dhe *t* te fjala çetë. Ndodhi përngjashmimi (asimilimi).

Pra Çetobash zbërthehet. Sipas këtij përimtimi, në kundërshtim me çka është pranuar deri sot, trajta e parë duhet të jetë Çetobash dhe jo *Gjeto Basho.*

4.

Te *Gjeto Basho* fjala *Basho* është *bash,* si te Çetobash. Po *Gjeto?*

Ndër veçoritë e të folmes së Nikaj-Mërturit, ku bëjnë pjesë edhe Currajt e Epër, si dhe të Dukagjinit (malsia e Shkodrës), është shqiptimi i bashkëtingëlloreve ç, xh si tinguj shtegorë, diçka e përafërt me *q, gj.* Fjalë si çetë dhe *gjetë* (folja *me gjetë)* për një vesh të pamësuar shqiptohen njësoj ose pothuaj njësoj. Me ngjyresa (nuanca) të ndryshme, kjo dukuri është mjaft e përhapur edhe brenda në Shkodër dhe në Kosovë. Në një prej letrave që Ndre Mjeda shkëmbente me Gustav Majerin (Meyer) për çështje të gjuhës shqipe, i kujtonte këtij të fundit me ba kujdes se shkodranishtja i ngatërron bashkëtingëlloret ç dhe *q.*

Afër mendsh, lahutari i parë anas ka shqiptuar *Gjetobash,* duke pasur ndër mend Çetobash, titull e funksion i Mujës. Të tjerë më pas e kanë shqiptuar siç e kanë dëgjuar, *Gjetobash.* Kështu është përkapur dhe është përcjellë nga një këngëtar te tjetri. Dhe prej aty, te hulumtuesit. Duke qenë shkodran, më saktë, prej Shllaku, megjithëse njohës "me themel" i shqipes dhe "me talent të madh", siç e vlerëson Fishta, as vetë Palaj nuk i shpëton dot keqshqiptimit të bashkëtingëlloreve të përmendura më sipër. Në *Hymjen* që zumë në gojë është kjo fjali: "Muji... që del me kërkuem çetave lopët, mbas nji rapsodije tjetër del për kaproj...". Vihet re menjëherë se në vend se me thanë *qetave* - qeta ka kuptimin shkrep ose vend me bar mes shkrepave, ku rrinë zanat e kullosin dhitë, fjalë e burimit indoeuropian të shqipes - ai shkruan pasaktësisht çetave. Gjithnjë duke e pasur fjalën për qetat. Sepse edhe vetë i ngatërron bashkëtingëlloret ç/q dhe *xh/gj.*

Edhe një dëshmi tjetër. Te këngë si *Agajt ndahen nga Muji e Halili,* në krejt tekstin nuk thuhet *Gjeto,* por *Qeto (Bashe Muja).* Dhe për fjalën çetë përdoret *qetë.* Pra edhe *gjetë* edhe *qetë* shqiptohen me *q.* Një tregues se *Gjeto,* si dhe *Qeto,* janë keqshqiptime të Çeto në të folme ku mungon bashkëtingëllorja e pastër ç [3].

Nuk ndodh kështu në fshatrat e Krasniqes e të Gashit në veri të Qafës së Kolçit; atje bashkëtingëlloret ç, q, xh, gj shqiptohen saktë, pa i hyrë në hise shoqja-shoqes. Po të kish qenë trajta e parë *Gjetobash*, edhe në këto katunde, për shkak të saktësisë në shqiptim të folësve, do të ishte ruajtur *Gjetobash.* Ç'arsye pati me u ba Çetobash, në pastë qenë ndryshe?

Koliqi përmend një botim më të hershëm të rapsodisë "Chéto Bashè Muji" nga Gasper Jakova Merturi, i cili e ka përshirë në veprën e tij *Gramatica della lingua Albanese* (Frascati 1904). Siç bie në sy, autori e shkruan *Chéto.* Vepra është botuar para Kongresit të Manastirit, kur shqipja ende s'kishte një abece (alfabet) të përbashkët, çka e le hapur shtegun që ky emër të lexohet në më shumë se një trajta. Nuk dimë si do ta ketë shqiptuar autori, por leximi më i arsyeshëm i *Chéto* në shqip mund të ishte Çeto ose, më pak mundësi, *Qeto.*

Pa zhbiruar më në hollësi, shihet qartazi: autorët që kanë botuar Eposin, qoftë edhe këngë të veçanta të tij, s'kanë qëndrim të njësuar në shkrimin e emrit dhe mbiemrit të Mujës.

5.

Në botimet pas Luftës së Dytë, emri *Muj,* i shquar, del në tri trajta: *Muji, Muja, Mujo.*

Te *Fuqia e Mujit* (1966) [4], në kundërshtim me trajtën *Muji* në titull, në vargjet 3, 6, 17, 18 thuhet *Muja* dhe papritmas në vargun 22 bëhet *Mujo* ("Mujon e kanë pvetë"). Në vargjet 61, 62 del përkatësisht *Mujo* dhe *Muji* ("Mujos me ia dhanë", "Tamlin Muji e ka pi"). Edhe më tej vijon me luhatje.

Të njëjtat luhatje gjinden edhe në botimin e parë të *Visareve të Kombit.* Madje në hyrjen e shkurtë vetëm pesë rreshta *Argument* (në botimet pas vitit 1944 *Argument* nuk është përfshirë), në rreshtin e parë është trajta *Muji,* ndërsa në të katërtin del *Muja* ("Muja miqsohet me Zâna"). Edhe te *Ajkuna kjan Omerin,* pas vargut 5 me *i* ("Ça ka ba, zot, Gjeto Basho Muji"), vjen vargu 9 me *a* ("Djalin n'dhé Muja e ka shti..."). Në botimin e vitit 1966 është ruajtur ky drejtshkrim.

Në trevat e Eposit emri *Mūj, Muj(ë),* me *u* të gjatë, në brezat e moshuar ndeshet edhe sot; del edhe si mbiemër. Në trajtë të shquar merr *a, Muja,* dhe jo *i, Muji.* Si mbiemër po ashtu është me *a, Muja,* familja *Muja,* asnjëherë me i, asnjëherë familja *Muji.* Kështu ndodh me tërë emrat njërrokësh me zanore të gjatë, e cila grafikisht shprehet duke shtuar ë në fund [5]. Emri *Muç(ë)* shquhet *Muça* dhe jo *Muçi* (krahaso shprehjen "si Muça mbas daisë"), njëlloj si *Mus(ë)* që shquhet *Musa* dhe jo *Musi.* Dem(ë), Met(ë), Nik(ë), Ram(ë), Ded(ë), Vat(ë) trajtën e shquar e kanë përkatësisht *Dema, Meta, Nika, Rama, Deda, Vata* (dhe jo *Demi, Meti, Niku, Rami, Dedi, Vati).*

Njësoj ndodh në këto treva edhe me disa emra me prejardhje të huaj, të cilët mbarojnë me *i* dhe theksin e kanë në rrokjen e fundit, si *Ali, Veli, Bedri. Ali* shquhet *Alia* dhe jo *Aliu.* Për pasojë *Gjergj Elez Alia* dhe jo *Gjergj Elez Aliu.*

Të ndërlidhura, këto të dhëna prijnë kah *Muja* si trajtë e parë.

6.

A mund të jenë përdorur tri trajta, *Muja, Muji, Mujo,* për një emër të përveçëm, në të njëjtën këngë, në të njëjtën kohë e në të njëjtin vend, prej të njëjtëve rapsodë?

Nuk duket e besueshme. Sidomos në

1 Ernest Koliqi, *Vepra 5,* Shtëpia Botuese FAIK KONICA, Prishtinë, 2003. Edhe citimet e tjera të Koliqit janë marrë prej të njëjtit burim.

2 Pavarësisht nga bindja e autorit të këtij shkrimi për trajtën më të saktë, këtu ai shkruan herë *Muji* e herë *Muja,* në përputhje me lëndën, tekstin e botuar, të cilit i referohet.

3 Ndryshe nga *Çetobashe,* trajtat *Gjeto Bashe* dhe *Qeto Bashe* janë shkruar ndaras. Nuk duket se ky rast fsheh ndonjë domethënie të veçantë. Me gjasë ashtu janë dëgjuar ose kuptuar në fillim dhe ashtu janë zbardhur nëpër letra, duke u përcjellë pa ndryshime.

4 - 1966, është fjala për botimin e Institutit të Folklorit, *Epika Legjendare,* vëllimi i parë, Tiranë, 1966;
- 1955, është fjala për botimin e Institutit të Shkencave, *Këngë Popullore Legjendare,* Tiranë, 1955.

5 Nuk ndodh kështu me emrat njërrokësh që shqiptohen me zanore të shkurtë si *Mic, Gjon, Pal, Bec.* Trajtën e shquar ata e bëjnë gjithnjë me *i, Mici, Gjoni, Pali, Beci.*

mjedis të maleve, në fshatra që sillen e mbështillen rreth vetes të pandikuara, pa rrjedhje e pa dyndje të popullsisë, me marrëdhënie të kursyera me pjesët e tjera të vendit.

Mbledhësit e redaktuesit e këtyre këngëve, Atë Bernardin Palaj dhe Atë Donat Kurti, mbeten dijetarë dhe hulumtues të klasit të parë. Cilësia dhe profesionalizmi i punës së tyre është cak i lakmueshëm për cilindo. Atëherë ku mund të lypet përgjegjësia?

Mund të jenë shtrembërime që lidhen me mënyrën vetiake të shqiptimit të këngëtarit. Dhe me mënyrën si e ka përkapur këtë shqiptim veshi i mbledhësit, në mungesë të mjeteve të përshtatshme teknike për regjistrim.

Mund të jenë gabime shtypi, të pashmangshme në një vend me pak shtypshkronja dhe përvojë relativisht të pakët botimesh, si Shqipëria e asaj kohe.

Nuk përjashtohet edhe mundësia e ndonjë ndërhyrjeje të mëvonshme prej duarsh të tjera.

Me gjasë kanë ndodhur të tria.

Në botimin e *Visareve të Kombit,* në një shenim në hyrje të poemës *Martesa e Halilit,* marrim vesh se ajo është përmbledhje sipas "shqyptimit të tre rapsodëve në Curraj". Pra tri motërzime janë shkrirë në një. Kjo do të thotë se mbledhësit kanë vënë dorë. Edhe Koliqit flet për ndërhyrje të Atë Bernardin Palajt në disa tekste të këngëve të kreshnikëve. Sipas tij, *Martesa e Gjeto Bashe Mujit, Orët e Mujit, Mujit tu Mreti, Martesa e Halilit* "u përpunuen prej Palajt".

Ku kishte prekur Palaj, që njihej si "Frati i Kangëve", si dijetari që "ua zbuloi Shqiptarvet bukuritë e mrekullueshme të ciklit të rapsodive të Gjeto Basho Mujit"?

Koliqi thotë se Atë Bernardini zgjidhte motërzimin më të bukur të një kënge dhe e plotësonte me vargje të zgjedhura prej degëzimeve të tjera, gjithnjë "tue ndejë në frymë e në ligjërim të lahutarve". Kësisoj, "tue shti në punë varjantet e motërzimet e shumta, pesë a gjashtë prej atyne rapsodive i preku me dorë të lëmuet mjeshtri edhe, pa cenue njomsinë virgjin origjinale, ua dhetëfishoi shkelqimin poetik". Palaj vetëm "qëndiste indin populluer me fije të ngjyrta marrë prej popullit".

Në *Hymjen* që u përmend më lart autorët (mbase vetëm Palaj?) saktësojnë: "Në kje se shifet ndoi ndrrim a ndër emna a ndër të shprehuna në krahasim me rapsodi të botueme deri tash, këta rrjedh prejse i *kemi plotsuem* me shka ma të bukur kemi gjetë *ndër motërzime me argument të njinjishëm.* Kështu... kemi mrrijtë si bleta me mbledhë andej e kndej nektarin poetik të kangtarit të malevet".

Diçka më konkrete nga ky laborator zbulohet në një shenim në hyrje të poemës së Gjergj Elez Alisë, në të njëjtin botim. Rapsodët "kur marrin lahuten në dorë, e kanë nji publik t'interesantshëm, n'at kohë fantazija e gjallë e tyne i endë rapsodít fort ma bukur se kur diktojnë. Un s'pash tjetër rrugë për me shpëtue legendën me gjith poezi, veç me shkrue nji herë kangën e mandej me i dhanë lahutën e unë me ba qortimet".

Deri ku ka shkuar ndërrimi "ndër emna a ndër të shprehuna", a ka pasur ndërhyrje në shkrimin e emrave të përveçëm? Në qoftë se po, për ç'arsye?

Nuk është vetëm emri i Mujës që del në disa degëzime.

Te *Ajkuna kjan Omerin* (1955), vargu 78 është *"Mor Omeri i nanës-o!".* Njëmbëdhjetë vjet më vonë (1966), në të njëjtin varg Ajkuna papritmas i ndryshon emrin të birit: *"mor Homeri i nanës-ooo!".* Jo pa u befasuar vërejmë se edhe te *Visaret e Kombit* ky varg është si në botimin e 1966-s: *"mor Homeri i nânës-ooo!".* Aty djali i Mujës quhet një herë Omer (në titull), herën tjetër Homer



Vizatim nga Gazmend Leka

(në brendësi). Homer del edhe te *Martesa e Halilit,* në shenimin e hyrjes: "...bashkë me martesën e Mujit e me dekën e djalit të tij Homerit...".

Çfarë ka ndodhur?

Dihet se Palaj, Kurti e të tjerë te *Kangët e Kreshnikëve* shihnin një palcë të moçme ilire. Kjo palcë e moçme mishërohet edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit, në rite, doke, këngë e valle të hershme. Te "Eskili, ky humbës i madh" Kadareja thotë se disa nene të Kanunit, rite si gjama e të tjera çojnë te kohë të vjetra para Krishtit, takohen me Eskilin e me Homerin.

A mundet që një dijetar dhe krijues si Palaj, i vetëdijshëm për këtë, të mos e ketë përballuar ngasjen me u dhanë disa emrave të përveçëm trajtë fonetike të lashtë? Për shembull Omerin me e shndërrue në Homer, për shkak të afërsisdhe rapsodi, pa een me Eskilin dhanethka ma të fonetike dhe rrënjëve të moçme? Në qoftë kështu, pse ka ndodhur vetëm në pak raste? A thua vepra u dha për botim pa mbërri me i dhanë dorën e fundit, pa një redaktim përfundimtar?

Ndonjë tjetërsim emrash mund të jetë përftesë e dukurive fonetike. Në botimin e parë të *Visareve të Kombit,* në këngën e *Gjergj Elez Alisë* emri i heroit është *Gjergj Alez Alija.* Me një vështrim të shpejtë mund të thuhet se emri *Elez* është ndikuar prej emrit *Ali* që vjen pas dhe rapsodi, pa e kuptuar, e ka shndërruar në *Alez.* Mbledhësit thjesht i kanë qëndruar besnikë origjinalit, siç e kanë dëgjuar.

7.

Luhatjet që nuk përligjen në drejtshkrimin e emrit të Mujës dhe disa trajta të tjera gjuhësore lënë hapur edhe mundësinë e ndërhyrjes së një dore të jashtme joprofesionale. Pse kudo në titujt e këngëve është vetëm trajta me *i, Muji,* ndërsa në tekste kjo trajtë është e kufizuar? Te Çetobashe *Muji e Krajleviqe Marki* (1955), për shembull, trajta *Muji* e titullit sfidohet 22 herë prej trajtës *Muja* në vargje. A thue redaktuesi ka vënë dorë vetëm ose kryesisht nëpër tituj, duke e pasur të pamundshme ndërhyrjen në brendësi, për shkak të vëllimit të madh të lëndës?

Edhe trajta *Mujo* nuk rri aq natyrshëm në Këngët Kreshnikëve. Në krah të djathtë të Drinit, ku shtrihen hapësirat e Eposit, emrat e përveçëm përgjithësisht nuk mbarojnë me *o* [6]. Në këngët e botuara *o-ja* në fund del jo vetëm te emri *Muj.* Del edhe te *Bashe.* Në vargjet 4, 81, 142, 149, 301 të këngës *Muji dhe Zanat* (1955) shkruhet *Gjeto Bashe Muji.* Pas njëmbëdhjetë vjetësh (1966), në të njëjtat vargje, *e* - ja bëhet *o, Gjeto Basho Muji* [7].

Ndryshimi duke shtuar *o* në fund shpesh ka qenë prirje "zyrtare" pas luftës. Njerëz të viseve veriore, të cilët në familje e në rrethin e tyre njihen si *Jah(ë), Muj(ë),* Çel*(ë), Rexh(ë)* - në të shquarën *Jaha, Muja,* Çela*, Rexha* - nëpër kumtime publike, jo rrallë edhe në dokumentet e njëjtësimit, janë shndërruar në *Jaho, Mujo,* Çelo*, Rexho,* siç shqiptohen në jug të vendit. A thua kemi të bëjmë me rrekje pa mend të dikujt "me e afrue" gjuhën e Eposit të moçëm edhe në drejtshkrimin e emrave të përveçëm, me atë që do të pagëzohej "gjuhë letrare", "gjuhë e njësuar"?

Dyshimi për një "virus" të tillë përforcohet duke parë lëkundje të tjera te emrat e përveçëm. Sërish te *Ajkuna kjan Omerin* (1955) në vargjet 7, 20, 21, 29, 40 emërvendi *Lugjet e Verdha* [8] shkruhet me shkronjë të madhe, ashtu siç është shkruar në botimin e parë të *Visareve.* Pas njëmbëdhjetë vjetësh (1966) në të njëjtat vargje mbiemri *(e) verdha* del me shkronjë të vogël. Por *Lugjet e Verdha* është emër i përveçëm, njësoj si *Mali i Gjerë* në Gjirokastër, *Syri i Kaltër* në Sarandë ose *Rrethi i Bardhë* në Tropojë. Quhen *Lugjet e Verdha* edhe në kulm të dimrit, kur nuk janë më të verdha (të gjelbra), por bëhen krejt të bardha prej borës. Siç quhet *Syri i Kaltër* edhe në ndodhtë me u turbullue keq. "Virusi" këtë s'e ka kuptuar dhe ka ndryshuar drejtshkrimin e origjinalit, duke e shkruar mbiemrin me *v* të vogël.

Shenjat janë se ky "virus" ka prekur edhe emra të përgjithshëm. Gjykuar nga titujt, mund të mendohet se këngët *Agajt ndahen nga Muji e Halili* dhe *Agajt ndahen nga Muji* (1966), janë mbledhur diku në jug të Shqipërisë. Sepse gegnisht nuk thuhet *agajt,* thuhet *agët.* Dhe në tekstin e këtyre këngëve në asnjë rast, përveçse nëpër tituj, shumësi i emrit *agë* nuk del *agajt.* Gjithkund del *agët.*

Edhe trajta *Muji* e titullit në dy këngët e mësipërme përgënjeshtrohet në tekste prej trajtës *Muja* përkatësisht 16 dhe 15 herë.

8.

Shihet se shpalimi gjuhësor ia rinjeh të drejtat Çetobashe Mujës.

Dhe e thërret prapë në dyluftim.

Kësaj here jo me shpatë, por me mjete gjuhësore. Jo kundër shkaut, por kundër Gjeto Basho Mujit. Hiqmu sysh, ti nuk je i njëmendti, i thotë Çetobashe Muja. Gjeto Basho Mujit. Ti je dytësi, kipci, sozia ime. I njëmendti jam unë.

Gjuha është "gjë e gjallë" dhe "shumë e hollë", thotë Konica. "Po i shtrembërove pakëz një nyje a një dell, trupi i tërë i tronditet...". Tronditet trupi i gjuhës. Edhe i lëndës që kumton ajo. Tronditet e tjetërsohet.

Ndodh që një gabim i rastësishëm teknik ligjëron e përgjithëson një trajtë të gabuar. Çabej mendon, për shembull, se pjesëza *ndofta,* e cila ndeshet bukur shpesh në vend të *ndoshta,* është përgjithësuar nga leximi i gabuar i një grafie te Frang Bardhi *(*ſ është lexuar si *f).* U deshën treqind vjet me e kuptue. Dhe për kaq gjë u desh një burrë i madh si Çabej.

---

6 Në vargje si "Aman Mujo, djalin ç'ma ke ba?" *(Ajkuna kjan Omerin)* ose "Zana jemi Mujo, tuj shetitë/... / Ti çfarë ndere, Mujo, po na lyp?" *(Fuqia e Mujit), o*-ja në fund nuk është nyje shquese. Është pasthirrmë. Vënia e pasthirrmës në fund të emrit pavarësisht nga gjinia e tij, kur i drejtohesh një të afërmi ose të njohuri, është dukuri e zakonshme në të folmet anase. Trajta *Mujó* është rasë thirrore, e barabartë me *o Muj.* Njësoj si *mikó* për *o mik, burró* për *o burrë, motró* për *oj motër, djaló* për *o djalë, nanó për oj nanë. O* - ja në fund është zanore e theksuar, e gjatë.

7 Tjetërsoj është rasti te *Gjeto / Çeto.* Zanorja *o* te Çetobashe / *Gjeto Bashe* shtohet për lehtësi shqiptimi, kur në të folmen verilindore dhe përgjithësisht në dialektin gegë mungon zanorja ë, e cila gjithsesi është e dobët (prandaj ka qenë quajtur *e pa zâ).* Edhe zanorja *e* në fund të *Bashe* bën lidhjen me mbiemrin (ndonjëherë e bën *a*-ja). Halili, vëllai i Mujit, nuk është *Sokol Halili,* por *Sokole Halili.* Budalin Tali është *Budaline Tali.* Edhe Krajleviq Marku është *Krajleviqe Marki (Marku).* Të tre me *e* të shtuar gjegjësisht pas *Sokol, Budalin, Krajleviq.* Bashkëluftëtari i Skenderbeut Kont Urani nuk është *Uran Konti,* por *Urana (Vrana) Konti.* Ndërmjet emrit e titullit është shtuar një *a.* Kjo dukuri është veçanërisht e përhapur te emrat e shkurtë të malsorëve. *Mark Gjoni* bëhet *Marka Gjoni, Mal Zogi* bëhet *Mala Zogi, Can Begi* bëhet *Cana Begi.*

8 Në të djathtë të Drinit, dhe jo vetëm aty, mbiemri *i (e) verdhë* ka kuptimin *i (e) gjelbër, i (e) blertë,* njësoj si në gjuhët latine (vjen prej latinishtes *viridis).* Prej aty foljet *me (u) verdhue,* mbiemri *i verdhuem* në kuptimin *me gjelbërue, me u gjelbërue, i gjelbëruar.* Për të përcjellë kuptimin që bart fjala *i (e) verdhë* në standardin e sotëm të gjuhës shqipe, përdoret mbiemri *i (e) luls* (me *u* të gjatë, që në grafi pasqyrohet duke vënë ë në fund) dhe foljet përkatëse *me (u) lulsue,* në kuptimin *me (u) zverdhë* (shih *M. Elezi, Fjalor i Gjuhës Shqipe,* Shtëpia Botuese *Gjergj Fishta,* Tiranë, 2006).

VRA E KTHJELLË

jam si qielli që vrahet prej britmave
e kthjellohet prej lutjes si ajri në pranverë

jam si shiu që bie mbi dredhëza,
po mushtin ua pi kulshedra me shtatë krerë

jam si përroi që dlirët nga lyzhdra
hedhur pa mëshirë nga laradacët me frak

jam si cigani i breglumit me brekushe
që i bie lodërtinës së ditës: paç fat

ORA E KTHIMIT

Ora jote e kthimit po troket
e unë ende nuk kam shkrue asnji varg,
n'Shëngjergj lisi i vogël te kryet asht ba rrap,
tash dyzet e pesë mote
s'i vyshket asnji gjeth
s'i thahet asnji degë.

Ora jote e kthimit po vjen
E ti shkon tërmales pa thinja, pa hapa...
Motin tjetër do jesh ba i'qind vjeç,
Por nuk do të jesh plak.
Me gjuhën e barit, a s'po më thue:
"U plakësh biri im edhe për mue!"

SHENJA E DIELLIT

Shenjën e diellit ua bëj tatuazh reve
Por nuk jam diell, as një thërrmizë e tij,
Nuk shpërndaj rreze e nuk mbaj amanete
Nuk ngroh në dimra e nuk djeg në verë,
Nuk shkrij borën maleve, akujt mbi përrenj,
Fëmijët nuk më shkruajnë në hartime shkolle,
As rapsodët në këngë si Shna Diell.
Ime shoqe nuk bën be në mua
Si të parët tanë: "Për këtë diell!"
Dielli i saj ka moshën e drandafilltë
Të ardhjes së ardhësve.

E PAKRYER

Eja se dita jote nuk ka kryer
As nata që të mban një mur a një det larg
Eja se ajri mes nesh as ngrinë, as shkrinë
Lulet çelin e s'çelin, krojet menin e s'menin.
Ne duhej ta kishim (për)kryer botën,
Por nuk mundëm ta bënim.

Paçka se e ndalem padashur ciklin e saj
Sot e gjithë ditën jemi në faj!
Zor se mund ta ndreqim dhe tash e mbrapa,
Jo se s'kemi kohë, jo se s'dimë me dasht
Por jemi po ata të djeshëm-sotshmit
Të përkryer në atë që nuk asht...

LASGUSHI

Para tij bëjmë fotografi
ai hesht, nuk ka fjalë...
sot i derdhur në bronz
si dje, kur ishte i gjallë.

QAFË - RRASA

Qafa më e vogël në botë
E ngjis përditë me hapa rinor
E prapë s'e kam ngjit...

Asgjë aty asnjëherë s'ka ndodhur.
Së paku të ngrihej një antenë!
Vetëm lisa pellazgjikë...

Qafa më e vogël në botë
E vogël sa fëmijëria ime.

SHENJA E DIELLIT

Nga Ndue Dedaj

LONDRA

Nuk kam qenë asnjëherë në Londër,
Befas atje zbrita me një avion malli,
Pashë si rridhnin Drini e Vjosa,
Mbi re e nën re, si një erë e re...

Londra tashmë,
Një lagje e shtëpisë sonë.

AVIONI

Avioni u ngrit nga aeroporti i Kabulit
i stermadh, i rëndë, zhurmues,
fëmijët që s'mundën të hipnin në bord
u varën në krahët e tij si lot...
atë çast qielli zgjati krahët
u mbush me zogj!...

16 Gusht 2021

DETI A QIELLI

Asnjëherë nuk e kam kuptuar
ku fillon qielli e ku mbaron deti,
si mundet njeriu të masë
sa kaltërsi ka njëri sy e sa tjetri?...

KROI I VASHAVE

Vashat shkuan të gjitha
dolën nuse me tupanë,
kroin e morën në gji
po vashëria e tyre pikon aty...

MUZGU

Si të ngjitemi tek ai mal?
Si të zbresim tek ky zall?
Telajo e mëngjesit pikturohet pa ngjyra...
Muzgu shuhet pa fjalë...

RAGUZA

Gj. Kastriotit

Ti ecën nëpër Raguzë
Unë nëpër Dubrovnik.

Hapen para teje portat e kështjellës,
Kanatat e Republikës.

Ambasador Gazulli del nga koha...
Shkruan kartolinën 2022.

Ti ecën nëpër Raguzë,
Unë nëpër Dubrovnik.

Jam aq krenar në këtë qytet
Sepse jam Ti.

GJARPËRINJTË E LAHUTËS

Kishte gdhendur në lahutë lulet e shegës,
shqiponjat e qiellit, brirët e dhisë -
zu të skaliste gërshetat e vashës.

Nuk kishte ndodhur kurrë ma parë
të rrinin mbi lahutë dy gjarpërinj aq të bukur -
ndërthurur si gishtat e tij në gishtat e saj.

Retë idhnake u përplasën fort në qiell
e bubulluan me breshërimë në tokë,
si mund të durohej ndër burra kjo herezi!?

Vetëm shtojzovallet kishin kërcyer deri atëbotë
mbi lahutat dhe shtretërit e tyre,
joshëse, tunduese, mëkatare...

S'deshi t'ia dinte për gjëmimin e qielltokës
vazhdoi të gdhendte në tel të lahutës
gjarpërinjtë që i kalleshin në gji.

VETËM NË ANDËRR

Vetëm në andërr rrinë bashkë të vdekur e të gjallë,
të lindur e të palindur

Vetëm në andërr rruzulli bahet sa një top futbolli,
luajnë çunat e lagjes

Vetëm në andërr qielli lundrohet nga anijet,
bora flokon në verë

Vetëm në andërr kanë të njëjtën ngjyrë,
e bardha dhe e zeza

Vetëm në andërr kërcejnë valle dyshe
jeta e vdekja

S'U BANA DOT KOSTANDIN

Kundroj vargun e kreshtave alpine
i pamatë, i trazuem, i pagjuhë
shkronjat e shqipes patën ra në luftë!
Deri këtu në Sanxhak shungullonte zani im:
a ndiet, ju o gjind, përtej nantë maleve
atje qe martue Doruntina, ime motër...
Po unë s'u bana dot Kostandin!

Sanxhak, maj 2015

E RREJSHME

Rendin kuajt e trumpetave me galop
shtegtojnë namin tuaj prej herojsh t'gjallë

gati të bien për ju çdo çast dëshmorë
jo vetëm në gojëdhana, jo vetëm në kala...

Imi asht veç kali që s'e shalova kurrë -
më shpie tërthoreve ku s'buçet lavdia juaj...

SIZIFIANE

Fjala e rëndë thyen kockën e gjuhës në asht
rrokulliset si ortek drejt fundit të dheut,
s'ka njeri as Zot ta ngjisë sërish lart
ku luhet simfonia e nëntë e Bet'hovenit.

NË KOPSHTIN E POETËVE

Kalova përpara poetëve
Të bërë statuja
Ose gurë të shkruar

Përbri datës së lindjes
Dhe asaj të vdekjes
Ndodhej çanta e shpinës e disa vargjeve
Ku ata mbanin shujtën e domosdoshme
Për udhëtimin e tyre drejt përjetësisë

Duke i parë aq të heshtur
Sa bari dhe drurët
Që i rrethonin me gjelbërim
Ishte e pamundur të dalloje
Frymëzuesit e turmave nga intimistët

Të çliruar nga simpatitë dhe nga urrejtjet e tyre
Ata preheshin pranë njëri-tjetrit
Si vëllezër të gurtë
Apo si zogjtë e ndryshëm
Të ulur në shkurret e lulëzuara

Duke u fryrë me gojët e gurëzuara
Trumbetave të lulekëmborëve
Ata falënderonin me gjithë zemër
Qytetin e Parisit
Që u kishte kushtuar atë copë tokë
Ku gjelbëronte kujtimi i tyre…

ZEMRA IME BEDUINE

E lodhur nga dielli nga monotonia e dunave
E rrethuar nga devetë e mplakura të ëndrrave të saj
Zemra ime beduine çlodhet nën tendën e brinjëve

Ç'rëndësi ka që jeta mund të jetë një shkretëtirë
Që oazat me palma të gjelbëruara
Bëhen gjithnjë e më të rralla

Ç'rëndësi ka që herë pas here
Një devé e kapitur jep shpirt buzë rrugës
Që eshtrat e saj do të zbardhen nga korbat

Ç'rëndësi ka që ulërimat e çakejve
Ngrihen drejt hënës së përgjakur
Që rruga mbulohet me rërë nga shtrëngata

E strukur nën tendën e vjetruar të brinjëve
Zemra ime beduine pret të zbardhë drita
Për të nisur për udhë karvanin e deveve…

PAS AUSHVICIT

Pyetjes së filozofit Teodor Adorno
« A mund të shkruhet më poezi pas Aushvicit ? »
Unë i jap përgjigjen e mëposhtme :

Njerëzit duhet të shkruajnë poema pas Aushvicit
Për të dëshmuar se poezia është një Euridikë
Që ka dalë e gjallë nga ferri i Aushvicit

Poezia që shkruhet pas Aushvicit
Tregon se njerëzimi e ka mposhtur
Cerberin që mëtonte të zëvendësonte poezinë
Me lehjet e tij të kobshme

Edhe po qe se ai që e ka sajuar Aushvicin
Një ditë do të orvatej të dilte nga varri
Ajo që do të jepte alarmin e para është poezia
E cila do t'ia mbyllte gojën
Me një lopatë me baltë

Poemat që shkruhen pas Aushvicit
Janë si filizat që mbijnë e gjelbërojnë
Në një pyll që zjarri e ka bërë shkrumb e hi…

NJË PETALE TRËNDAFILI

Nga një tufë trëndafilash
Ishte shkëputur një petale
Që dergjej në trotuarin e lagur

Duke parë natën e dimrit
Që po binte mbi Paris
Pata drojë se ajo petale gjak e kuqe
Në trajtë zemre
Do të zinte të thërriste

ZEMRA IME BEDUINE

Nga Anton Papleka

Ashtu si turma që nxitonte rreth meje
Unë e lashë në fatin e saj
Por imazhi i asaj petaleje gjak të kuqe
Në trajtë zemre
Më ndoqi pas me ngulm

Atë natë mezi më zuri gjumi
Mendova se ajo petale gjak e kuqe
Që dergjej në trotuarin e lagur
Ishte zemra e një njeriu
E shndëruar në petale trëndafili

U pikëllova duke përfytyruar
Hapat që e shkelnin pa e ditur
Të ftohtit që e kallkanoste
Shiun që e katandiste në një leckë
Të cilën një fshesë do ta mblidhte të nesërmen…

DUKE LUAJTUR ME FJALËT

Fati im është verbal. / Unë jam ajo që shkruaj.
Alain Bosquet

Unë e kam zhgënjyer shenjtin
Të cilit ia huazova emrin

E kam tradhtuar kryengritësin e viseve të mia
Që kishte mbajtur të njëjtin emër

Unë nuk munda të isha
As shenjti as kryengritësi
Të cilëve duhej t'u përngjisja

Nuk predikova ndonjë doktrinë
Nuk ndeza ndonjë kryengritje

Në vend të këtyre bëmave
Tërë jetën
Unë luajta me fjalët

Dhe fjalët nga ana e tyre
Më se një herë më punuan ndonjë rreng

Me gjithë atë që më ndodhi
Unë mbeta një fëmijë i pandreqshëm
Që vazhdon të luajë
Me të vetmet lodra
Që i ka për zemër :

Me fjalët…

PËRQAFIMI

Prit të të përqafoj
Tha ajo

Ky përqafim është më i rëndësishëm
Tha ajo
Sesa Lufta e Trojës
Sesa marrja e Persepolit
Sesa zbarkimi në Normandi
Sesa zbritja e njeriut në hënë

Ky përqafim mund të sfidojë
Tha ajo
Epideminë e murtajës së zezë
Epideminë e gripit të quajtur spanjoll
Pandeminë e Kovidit-19

Pas përqafimit tim
Tha ajo
A nuk të duket sikur kemi njëqind krahë
Për t'u shtrënguar aq fort
Sa as erërat e mbyllura në calikun
Që Eoli i dha Uliksit
Nuk do të na ndanin dot

Prit të të përqafoj
Tha ajo
Që dimri të arratiset nga kalendari
Dhe t'i ta ndiesh veten si një mollë e lulëzuar
Mbështjellë nga puhia pranverore…

DISQET FLUTURUESE TË ËNDRRAVE

Disqet fluturuese të ëndrrave tona
Pa dyshim janë të ndryshme përnatë
Siç janë të ndryshëm
Udhëtarët dhe bagazhet
Që ato zbarkojnë kur ulen
Në aeroportet e hirta e të shkreta
Të trurit tonë të përgjumur

Disqet fluturuese të ëndrrave tona
Janë të domosdoshme për ne
Sepse ato na sjellin diçka që na mungon
Dikë që na vjen për vizitë herë pas here
Që nga viset e panjohura
Të nënvetëdijës sonë

Thonë se disku fluturues i një ëndrre
Ia solli Dante Alighieri-t
Vizioin e Komedisë Hyjnore
Miguel de Cervantès-it personazhin e Don Kishotit
William Shakespeare-it disa skena të tragjedive të tij

Së paku është një fakt i padiskutueshëm
Se tablonë e titulluar « Klasifikimi periodik i elementeve »
Ia solli Mendelejevit natën
Disku fluturues i një ëndrre
I ardhur nga ku ?
I dërguar nga kush ?
Dhe përse ?

Kur zgjohemi dhe hapim sytë
Disqet fluturuese të ëndrrave tona
Tashmë janë ngritur nga aeroportet e trurit
Duke lënë aty vetëm mbetëza vegimesh
Si rrënoja qytetesh të moçme
Të shembura ng lëkundje të vazhdueshme sizmike
Imazhe të varura në retinat tona
Si shtëllunga mjegulle të fërtelosura nga puhia…

DRITARJA

Muratorëve që do t'i ndërtonin shtëpinë
Një malësor u kërkoi të linin një dritare
Përballë grykës së malit
Ku kalonte rruga e vetme
Që lidhte dy lugina

Muratorët kishin kundërshtuar prerazi
Duke i thënë se në muajt e ashpër të dimrit
Nëpër dritare do të futej era e akullt
Që frynte nga gryka e malit

Malësori ishte përgjigjur
Se dritarja e ndriçuar
Do t'i ndihmonte të orientoheshin
Udhëtarët që i kishte zënë nata në rrugë
Dhe do të kërkonin një strehë ku të futnin kokën

Përmes asaj dritareje përballë grykës së malit
Ai mund të dëgjonte
Thirrjet e udhëtarëve të kërcënuar
Nga bora nga acari vdekjeprurës
Dhe nga lukunitë e ujqve

Ai malësor i pashkollë
Që kishte ngulmuar të linte dritaren
Përballë grykës së malit ku shfrynin erërat
Nuk e dinte fjalën « humanizëm »
Por shpirti i tij ishte një dritare
Përballë njerëzve të tjerë…

ZONJA E MIRË DHE GRA TË TJERA

Tregim nga Shqiponja Axhami

Kishim edhe dy orë rrugë për në shtëpinë e Sheh Dullës. Rruga për në shtëpinë e tij ishte një përdredhje e pluhurt që merrte nga Shtegu i Lajthive dhe soste tek Shkalla e Keqe.

"Si ka mundësi që një Sheh ndërton shtëpinë afër një gremine dhe shkalle të keqe?", - e pyes papritur xhaxhain.

Si duket e tremba, se ma kthey me një timbër të frikësuar:

"Nuk di ç'të të them, por mbaje fort zinxhirin, pashë të madhin Zot!"

E miratova me kokë dhe hodha edhe një herë vështrimin mbi kafshën e gjorë.

Unë tërhiqja për zinxhirësh një dhi sterrë të zezë, pa asnjë qime të bardhë, që na ishte dashur ta kërkonim në shtatë katunde. Ndërsa xhaxhai mbante në prehër gati të alivanosur, tim atë.

Prej ditësh im atë pati humbur në pyll. Kjo na pati trembur të gjithëve. E patëm kërkuam rrënjë e gëmushë, por nuk e gjetëm. Derisa një ditë ai u kthye, por i tjetërsuar.

Gjyshja, nëna dhe gratë e shtëpisë vunë kujën kur e panë. Sipas tyre, ai na paskësh shkelur xhindët.

"Ka të shkelur, ptu ptu", mbaj mend fjalët e gjyshes, ndërsa ima atë e vështronte me një shikim të mjegullt, si të mos e njihte.

Pas disa ditësh në shtroje, pa ngrënë asgjë dhe pa folur asnjë fjalë, im atë u tret dhe mbeti sa një dele. Kështu unë dhe xhaxhai morën udhën për tek Sheh Dulla. Sipas gjyshes, ai shëronte të shkelur e magji nga më të ligat.

Se përse ai na tha që duhej të gjenim nje dhi sterrë të zezë, kurrë nuk do ta merrja vesh. Veçse na u desh të rropateshim ditë e netë katundeve, derisa më në fund e gjetëm.

Ndërsa xhaxhai kujdesej që im atë të mos lëndohej, unë tërhiqja dhinë.

Ajo që na brente më shumë ishte fakti, se im atë nuk kishte folur prej javësh. Na digjte dëshira të fliste qoftë dhe një fjalë, që të mund të merrnim vesh çfarë i kishte ndodhur. Por ai vetëm tretej dhe zhytej në një gjendje të trishtë, që të këpuste shpirtin.

Kur sosëm tek Shkalla e Keqe pothuajse ishte errur. Si për të thyer makthin e atyre ditëve, xhaxhai iu drejtua tim eti:

"Mbërritëm. Për besë do të bëhesh mirë. Ke për ta parë."

Im atë nuk foli përsëri, vetëm lëshoi një psherëtimë, që mua m'u ngul si thikë në zemër. Sytë mu mbushën me lot. Prej hutimit desh lëshova zinxhirin, lidhur në qaforen e dhisë.

Dhoma ku qëndronte Sheh Dulla ndriçohej nga llamba me vajguri, që i kishte vënë rresht në të dyja anët e murit. Në anën përkundruall zjarri digjej në një oxhak të vogël dhe bri tij, zhytur në një postiqe qimegjatë, frymonte trupi i vogël i Sheh Dullës. Unë shtanga, kur ai pa lëvizur fare nga vendi dhe pa na kthyer përshëndetjen tha:

"E para të futet dhia."

Xhaxhai që për një copë herë mbante tim atë në krah, ma bëri me shenjë që të tërhiqja zinxhirin dhe të fusja në dhomë dhinë.

Kafsha e gjorë nxori mbyturazi një si klithmë. Dhe si duket nga lodhja, u shtri duke marrë frymë rrëmbyeshëm, e hutuar dhe e trembur.

"Shtrijeni të sëmurin bri dhisë !", - urdhëroi përsëri Sheh Dulla.

Mes një përshtjellimi frike e lëshuam lehtas tim atë, bri dhisë. Xhaxhai më hodhi një vështrim dashamirës, si të më thoshte: " Mos u frikëso, do të bëhet mirë"

Në të vërtetë isha i frikësuar deri në palcë, megjithëse nuk i besoja fare andrallat e gjyshes dhe as fuqinë e Sheh Dullës. Por në ato momente dëshiroja të besoja çdo gjë, t'i lutesha çdo hoxhe dhe prifti, vetëm që im atë të bëhej mirë.

Dritat e llambave drithëronin mbi mure hije të çuditshme, ndërsa Sheh Dulla pëshpëriste mbi një libër, që sipas xhaxhait ishte libër i shenjtë.

Pas një copë here, zëri i dhisë çau terrin me një virrmë therëse, si të jepte shpirt nga ndonjë e prerë thike. Zura të dridhesha dhe iu afrova edhe më xhaxhait. Ai më vuri dorën mbi shpatulla, si për të më qetësuar.

Dhia lëshoi dhe njëherë një virrmë therëse dhe u rrotullua dy here, derisa shpina i zu ngjitur me tim atë. Në ato çaste Sheh Dulla u ngrit dhe uli fitilat e të gjithë llambave. Errësira që u krijua përreth të fuste tmerrin edhe më tepër, ndërsa unë lutesha nën zë dhe mes lotëve për tim atë. Në atë gjysmerrësirë më dhimbsej dhe më shumë. Madje disa herë u mata të ngrihesha dhe ta rrokja në qafë, duke e mos e lënë bri asaj kafshe, pse kështu na dashka një Sheh i çmendur. Unë nuk besoja asgjë, nga ato që thoshte gjyshja. Atë udhëtim e kisha bërë vetëm se isha i detyruar dhe për më tepër nuk kishim rrugë tjetër. Mjekët nuk i dhanë dum asaj që kishte ndodhur me tim atë. Vinin dhe iknin heshturazi, duke tundur kokën. Biles, mjekun e fundit desh e zhdëpa në dru, kur pasi e preku pak me stetoskop dhe i vuri një lupë para syve, iu kthye gjyshes dhe i tha: "Djali yt është çmendur".

Tek bluaja këto në mendje me zemrën që po më pushonte nga frika dhe dhimbja, në dhomë u futën një rresht grashë, që ecnin të kërrusura. Ato i ranë rrotull dhomës dhe në fund zunë vend rreth trupit të shtrirë të babait.

"Sheh, Zonja e Mirë e Lugut të Errësirës e dëgjoi thirrjen tënde. Vërtet ajo nuk mund ta harrojë gjëmën që i bëri ky udhëtar, kujë vuri me ditë, por vendosi që ta falë"

Unë kisha shtangur. Kush ishin këto gra dhe ç'lidhje kishte kjo Zonjë e Mirë me tim atë.

Në ato çaste zëri i tim eti çau terrin, si një oshtimë që dilte prej një varri.

"Ikni andej të matufosura. Mos flisni kështu në sy të tim biri"

Ndërsa im atë ofshante kundër grave, xhaxhai më puthi mbi flokë dhe më tha nën zë: "Foli. Do të bëhet mirë, të thashë."

Unë kisha shtangur.

"Pusho se ta lidhëm përsëri gjuhën, mëkatar!" - iu hakërrua më e vjetra e tyre.

Ajo qe ulur e para në rradhë, bri Sheh Dullës. Që ishte më e vjetra dukej nga drita e zbehtë që i lëshonin herë- pas herë llambat.

Unë po turfulloja. Një mendje më thoshte të ngrihesha dhe ta kapja për gryke, por isha mpirë dhe nuk mund të bëja asnjë lëvizje.

"Pak të duket zotrote që kalove pyllit lakuriq, ditëzi. E trullose nga mendja Zonjën e Mirë dhe e le cullak në mes të barishteve."

"Hiqmuni sysh", iu hakërrua dhe im atë, duke zënë pak në njërin krah.

"Këto janë gjepura. Unë nuk kam zhveshur askënd. Përkundrazi, ju lënesha të pështira më mbajtët mbyllur me netë, në shpellën tuaj të nëmur, sa harrova dhe të flas"

"Mallkimi ynë, mallkimi ynë do të të zëri", iu kthyen njëzëri gratë e tjera.

Im atë, që nga zëri dukej që ishte shumë më mirë, u ngrit në gjunjë dhe u kthye nga Sheh Dulla.

"Sheh, e di dhe kam dëgjuar për emrin tënd, që kur im atë ra në shtroje dy muaj rresht nga sëmundja e tokës. Mbaj mend dhe se si erdhe dhe i fryve tri të marta rresht, sa ai u çua në këmbë. Por, besomë në ke Zot, që jam i pafajshëm.

Unë mora Pyllit të Nëmur që pa gdhirë. I pata premtuar tim biri, se do e dërgoj tek Shpella e Ariut të murrmë. Rrallë zbret në fshat kjo kafshë dhe im bir e ka për zemër. Por më beso Sheh, në kthesën e parë më dolën këto, një lukuni plakash. I mbaj mend që nga vegjëlia Sheh, janë të gjitha lënesha, prek burrë me dorë nuk i ka. Babëzitur dhe trembur nga fundi i jetës së tyre prej lëneshe, m'u turrën si të çmendura. Bëso më vajisën më lloj – lloj vajrash, që mbanin erë të tmerrshme. Më pas, nuk mbaj mend shumë, veçse e pashë veten lakuriq, mes fierit. Dhe trupin copë- copë nga kafshimet"

"Mallkuar, mallkuar qofsh," - klithën njëzëri gratë e moshura, ndërsa unë turfulloja nga inati. Disa herë doja të ngrihesha dhe t'u turresha me grushte, por xhaxhai më kishte mbërthyer fort për duarsh.

"Këto, mallkimet kanë për zemër Sheh, të lutem mos u beso. Më shtriga ndër to është ajo, Zonja e Mirë. Ajo vdes që ta preki një burrë. Më mbajti të lidhur me një litar prej flokësh. Më bëri temjane dhe magjira, duke më ngulur thonjtë në lëkurën e kraharorit. As vetë nuke di Sheh, se si jam gjendur sipër saj. Ndërkohë që i gëzohej trupit tim, unë nxirrja poresh duhma avulli jeshil, derisa më iku gjuha dhe nuk brita dot më. Më pas u turrën ja këto, këto fytyrëdjegurat, të matufosurat. Nga nuk më preknin. Është e tmerrshme, më beso Sheh, është e tmerrshme të të hipin sipër dhjetra plaka."

Ndërkohë që im atë fliste, Sheh Dulla shfletonte një libër, që herë pas herë e vinte në postiqe dhe ngrite kokën lart, si t'i lutej qiellit.

"Vetëm të preknin apo?", - pyeti pas një copë herë Sheh Dulla.

Në ato çaste dhia, që si t'i kishin futur një trastë në fyt nuk qe ndier, lëshoi një virrmë të gjatë dhe të ethshme, që të shtinte tmerrin.

" Ç'të them i shkreti, unë nuk doja të bëja asgjë, por nuk di si ta shpjegoj Sheh. Këto më lagnin me një ujë të kuq, që vinte aromë gjaku. Më pas unë bëhesha si një dem i tërbuar, që edhe pse i shihja që ishin plaka të shëmtuara, doja të derdhesha mbi to. Po më beso Sheh, kjo vinte prej magjisë së tyre. Unë nuk e doja këtë gjë. Dhe Zonja e Mirë, që mallkuar i qoftë emri më shitoi e ç'nuk më bëri."

Ndërkohë që im atë fliste, plakat britnin me fjalë mallkuese. Ndërsa më e vjetra, iu kthye disa herë më një zë të çjerrë sheh Dullës.

"Mos e beso Sheh, ky gënjen. Ky ka demonë në bark. Ky u fut në Pyllin e Nëmur se na dëshironte, se na donte. Erdhi lakuriq tek ne, duke ulëritur si një kafshë e ligë, i babëzitur për seks."

"Gënjejnë Sheh, gënjejnë. Këto janë të babëzitura , më besoni Sheh. Këto kanë zabtuar Pyllin e Nëmur dhe i bien në qafë çdo fatkeqi, si puna ime, që kalon rastësisht andej.

"Duhet dënuar Sheh, dënoje përsëri që të mos flasë. Shituar qoftë!", - briti me të madhe më e moshuara e tyre. Ndërkohë të tjerat mbështollën shamitë, që i kishin hapur për të nëmur dhe bënë të dilin.

"Do ia them të gjitha Zonjës së Mirë dhe ky do të jetë sërish i mallkuar."

"E dëgjon Sheh, këto janë shtriga, vërtetë që janë shtriga Sheh. Jeta e tyre kallur për burrë, i ka bërë të tilla", - fliste im atë, me një zë të fortë dhe të sigurtë, a thua nuk kishte qenë në shtroje prej javësh.

Sheh Dulla frynte herë pas here dhe nuk ua ktheu fare përshëndetjen grave, që dolën një nga një nga dhoma, duke mallkuar dhe pështyrë.

Kur doli dhe guaja e fundit, e cila nuk harroi të kthehej dhe të pështynte fort nga im atë, dhia lëshoi një virrmë të gjatë dhe vetëm pas pak u shtri pa lëvizur. Kishte ngordhur.

Në ato çaste Sheh Dulla mbylli librin dhe u çua në këmbë. Iu afrua llambave dhe ngriti deri në fund fitilin e tyre.

Unë po dridhesha. Nuk dija ç'të mendoja më parë. Hërë shikoja tim atë, herë Sheh Dullën dhe herë dhinë.

"Duhej ta merrni dhe ta groposni tre burime larg", - urdhëroi Sheh Dulla.

Xhaxhai turfullonte nga gëzimi, ndërsa mua një vorbull e pashpjegeshme më ziente përbrenda. A thua im atë vërtet kishte shkuar lakuriq tek një lukuni grashë të rrjedhura? Kush ishte ajo dreq Zonjë e Mirë? A thua ishte më e bukur se ime më?

Xhaxhai falenderoi Sheh Dulllën dhe përqafoi bukur gjatë tim atë, përlotshëm.

Më pas e përqafova dhe unë, megjithëse më dukej qartazi pezmi në fytyrë.

Sheh Dulla bërë me shenjë që do të shtrihej. Sipas xhaxhait, sa herë ai frynte dhe lutej për një të sëmurë, lodhej, madje edhe sëmurej.

I lamë një bakshish në një torbë të zezë, që shërbente enkas për këtë gjë dhe dolëm. Ishte e çuditshme, im atë nuk dukej i drobitur, sikur kishte ditë pa ngrënë. Përkundrazi ecte vetë, pa e mbajtur as për krahu.

Në shalën e pelës ku pak më parë shtrihej im atë, vumë dhinë e ngrodhur. Të them të drejtën ato çaste hutimi, frike dhe mijra pikëpytjesh, nuk doja të dija për asgjë, por për një çast ndjeva dhimbje për dhinë. Fundja ç'faj kishte kafsha e gjorë?

Rrugën e kthimit e bëmë në heshtje, si të ktheheshim prej një varrimi. Kur sosëm tek burimi i tretë , hapëm një gropë dhe futëm të gjorën kafshë.

Gjyshja, nëna dhe gratë iu turrën me lot e gaz tim eti, ndërsa çuçurisnin me njëra-tjetrën, se Sheh Dulla na qenkësha një Sheh i fortë, që zhduk xhindë e magji, sado të liga qofshin.

As gjyshja, as ime më nuk e morën vesh kurrë për gratë e çmendura dhe akuzat ndaj tim eti.

Por unë pas saj ditë nisa ta shoh tim atë me dyshim. Kur merrnim rrugën për në ngastra dhe zhdukej me minuta duke shurruar, nga nuk më shkonte mendja. Ose kur ndonjë grua e lagjes na përshëndeste, e vëreja me vëmendje çdo lëvizje të tij. Asnjeherë në jetën time nuk kisha menduar që im atë mund t'i hidhej një femre tjetër, përpos nënës time. Ato kishin lindur shtatë fëmijë bashkë dhe ishin të lumtur bashkë. Veç kësaj nuk arrija të shpejgoja dot, se përse ishte kaq e fortë xhelozia për të?!

Një ditë morën Pyllit të Nëmur. Donim të bënin disa lëndë ahu, për një plemë të re. Kur sosëm tek Shtegu i Errësirës, zumë të dy përkundruall.

Si ta kishte kuptuar brengën time, zu të më fliste rreth grave, por duke lidhur fraza të çuditshme. Unë vetëm e dëgjoja.

"Ato janë të liga , besomë bir, të liga. Kur të vënë përfund, bëhen dhe më të liga. Por çorba me kos do hudhra, do hudhra bir, ose nuk

hahet. Pastaj një bretkocë nuk mund të jetë kurrë një elefant. Ose një gamile nuk mund të jetë kurrë një ujk”

Unë nuk e kuptoja, përpiqesha të kuptoja , por nuk i bëja pyetje sqaruese. Vetëm e dëgjoja.

Pas pak nga Shtegu i Errësirës kaloi vrulltas një kunadhe. Im atë mori shenjë. E goditi me të parën mu në kokë.

Kunadhja lëshoi një piskamë të gjatë dhe pasi dridhi disa herë këmbët në ajër, dha shpirt.

Unë, i trullosur, si të kisha ndalë nga një pus i errët makthi, nisa të flas me tim atë për të gjitha ato që më vlonin.

“ Dhe gratë të morën e të vunë përfund me magjira, apo desha vetë? ”

“Me magjira de, me magjira. Ku desha vetë. A do burrë në botë të këtë përfund një plakë të pështirosur, harruar të vdesë?”

“Po me të gjitha gratë t’u desh të flije, domethënë të bëje dashuri?”

“Jo de, vetëm me Zonjën e Mirë. Nuk di se kush dreqin ia ka vënë këtë emër, do t’i shkonte Zonja e Ligë. Vetëm me të bëra dashuri si i çmendur, megjithëse më pështiroste pamja e saj. As vetë nuk arrija ta kuptoja se ç’po ndodhte. ”

“Po gratë e tjera?”, - e pyeta pas pak.

“Gratë e tjera bënin orgji të ndryshme mbi trupat tanë. Nuk gënjej dot, me preknin dhe kalonin në histerizëm, vetëm nga ato prekje. Më pas ulërinin si të marra.”

Nuk i besoja shumë, megjithëse një ndjesi e brendshme dëshironte që t’i besoja dhe ta doja si më parë. Unë nuk mund t’ia falja tim eti, nëse e kishte tradhëtuar nënën time.

“Të them të drejtën, unë nuk e besoj fare Sheh Dullën. Dhe as që do mund ta besoj ndonjëherë, por pas asaj që më panë sytë. Çfarë lemerie! Ndoshta duhet besuar. Pa le, ngrodhi dhe dhia.”

Kur thashë këto fjalë, im atë nisi të mblidhte poçe pishe, pa ma vënë veshin.

Në fillim nuk e pyeta se përse po i mblidhte. Doja të marrja se s’bën një pëgjigje rreth Sheh Dullës.

“Sheh Dulla është një qënie e rritur tej Shkallës së Keqe. Nuk kam arritur kurrë ta njoh nga afër. Ama shumëkush që i është drejtuar për ndonjë hall, ka gjetur zgjidhje”, - ma ktheu im atë pas një copë here.

“Edhe ty të shëroi,” - iu ktheva papritur. Im atë asnjëherë nuk na pati shpjeguar, se çfarë kishte ndjerë në atë gjendje, kur qe sëmurë. Se përse nuk fliste, as hante.

Ndërkohë që unë e nxisja të flisje, ai mblidhte e mblidhte boçe pishash. Kishim ecur bukur përpjetë, kur thesi i zuri të peshonte. Qe mbushur gati plot.

“Po i afrohemi Shpellës së Errësirës”, - i them. Dua t’i kujtoj, se aty nga çasti në çast mund të dilte sërish Zonja e Mirë dhe grate e çmendura.

Por im atë vuri buzën në gaz dhe më bëri më shenjë që t’i afrohesha. Vura re që u ul mbi një pirg të gjatë dheu dhe nisi të lëshonte mbi të boçe pishash.

Në fillim një nga një, qetë –qetë, më pas me vrull dhe si me nerv.

“Është bërë vonë . Na duhet të kthehemi.”, i them

Ai vë buzën sërish në gaz, duke lëshuar edhe më shumë boçe pishe.

“Na duhet të kthehemi baba.”- i them sërish

Këtë herë kuptohet zëri im është pak i frikësuar. Nga çasti në çast imagjinoj Zonjën e Mirë, duke u shfaqur Shpellës së Errësirës.

Por asgjë nuk pipëtin. Vetëm zhurma e boçeve të tim eti, që i hedh mbi pirgun e gjatë, ngado.

“Duhet të kthehemi.” i them gati më zë të lartë, ku ndihet frika dhe makthi im.

“Ajo mund të kthehet,”- shtoj pas pak.

Babai vë buzën në gaz dhe hedh sytë nga pirgu i gjatë i dheut, mbuluar me boçe pishe. Pasi më sheh thellë në sy, vë gishtin tregues para hundës dhe me thotë nën zë.

“Një pirg dheu dhe dhjera boçe pishe, nuk i ngre dot kurrë një plakë e harruar.”

Mrrolem dhe hedh sytë nga pirgu i dheut. Mbi të ka shumë gurë, boçe pishash dhe plita.

Jo, im atë nuk mund te jetë një vrasës. Por dhe mund të jetë. Ai kishte varrosur me duart e tij thellë, shumë thellë Zonjën e Mirë, pasi ajo e hipnotizoi me magjira dhe e detyroi te derdhej mbi të , duke duruar dhe qindra kafshime plakash histerike.

Këtë ma tregoi kur bëmë të lidhnim turrën e drunjve të ahut, fill pasi morëm nga një dalje, drejt Shtegut të Shtogut.

Sido që të ishte, e gjitha kjo çmenduri ngjarjesh me acaronte, ndaj iu ktheva me inat.

“Ti je çmendur baba. Si mund të vrasësh një grua?”

Ndërkohë që pres të më ktheje përgjigje, shoh që nuk jam më në Pyllin e Nëmur. As pirg dheu me boçe bishe sipër, nuk ka aty pranë. As turrë më dru ahu, dhe as im atë nuk është pranë meje.

Jam në mes të një udhe. E njoh atë udhë. Është udha për në Shkallën e Keqe. Im atë është tej, duke tërhequr frerët pelës, kur has në ndonjë gropë uji. Ndërsa xhaxhai nga pas, që i thotë: “Edhe pak arrijmë”

Një përshtjellim makthi më mbulon me djersë. Lukunia e plakava duhet të më ketë bërë magji dhe mua. Ç’po ndodh? Ku jam?

Babai tërheq sërish me forcë pelën. Xhaxhai e ndjek nga pas. Ndërsa unë shoh çuditshëm vragën e zinxhirit të dhisë mbi dorë dhe shpetoj hapat. Kur arrij disa hapa pranë xhaxhait, dëgjoj tim atë që thotë:

“Jetoj gjatë, ka qenë shpirtmirë.”

Sheh Dulla kishte vdekur. Ne po shkonim për ta varrosur. Por unë isha krejt i hutuar. Vetëm para pak çastesh isha mes Pyllit të Nëmur, mbi prigun e varrit të Zonjës së Mirë.

“Çfarë dreqin po ndodhë me mua?” - pyes veten.

Përpiqem të imagjinoj çdo detaj nga nata e grave të tmerrshme, kur im atë ishte ende sëmurë. Davaritjet dhe frazat e tyre me oshëtijnë kokës, si fasha fortunuash dhe më japin dhimbje. Atëherë nuk duroj dot dhe i klith tim eti.

“Baba a nuk ishim në Pyllin e Nëmur bashkë? A nuk bëmë dru ahu? A nuk më the që ke vrarë Zonjën e Mirë? A nuk mblodhe boçe pishash dhe ia hodhe me duf sipër? Po luaj mendsh, por më shpjegoni diçka.”

Im atë ndal pelën, kthen kokës pas dhe më thotë me një zë krejt të qetë.

“Bir nuk ka asnjëherë nja Zonjë të Mirë për të vrarë, por mund të ketë një për të rrezikuar.”

Në ato çastë e urrej dhe dua të kthehem, por kemi mbërritur në oborrin e Sheh Dullës.

Është e çuditshme, arkëmorti i tij rrethohet nga gratë e çmendura. Njëra prej tyre, veshur me të zeza, është Zonja e Mirë. Dallohet prej të tjerave se rri serbes.

Një farë ngushëllimi më endet nëpër tru. Fundja do t’i jap një shpjegim gjithçkaje, sikur dhe luftë të jetë.

Por mbetem i shtangur: të gjitha gratë, biles dhe Zonja e Mirë i përkulen time eti, duke i bërë vend në krye të arkëmortit.

“Ç’po ndodh?” - pyes xhaxhain.

“Këto të çmendurat po i përkulen tim eti. A thua nuk ishin këto që çorrën gojën duke mallkuar.”

Xhaxhai vë buzën në gaz dhe me thotë nën zë:

“Mos u çudit! Sheh Dulla i ka lënë të gjitha librat e shenjtë dhe forcën e tij tët eti.”

Isha mpirë. E gjitha më dukej e pakuptimtë. Një mendje më thoshte të ikja me vrap, larg gjithçkaje, po dua të di dhe të kem një përgjigje dhe nga im atë.

“Baba, janë të vërteta këto që më tha xhaxhai?”

Babai vë buzën në gaz dhe përsërit shprehjen:

“Bir, nuk ka kurrë një Zonjë të Mirë për të vrarë, por mund të ketë një për të rrezikuar.”

Dua t’i ulëras. Ai e vë re pezmin tim dhe shton:

“Kjo që të thashë, vlen dhe për një Sheh.”

Ndërkohë që flet, plandos në duar librat e shenjtë. Ndërsa gartë rreth tij janë ende përkulur.

Përpiqem të mbedh veten, megjithëse për një gjë jam i sigurtë, që unë nuk mund t’i besoj më tim eti.

Duke u përpjekur që të mposht një përbindësh që zë e lëviz brenda meje, vraga e zinxhirit të dhisë zë dhemb. Madje duket se diçka lëviz mbi të. Një hije zezë, tej grave, një si formë dhie më fashitet në sy dhe ndjej që jam thjesht një i shenjuar.

tri tregime nga NEVIANA SHEHI

DIALOGU ME TROFTËN

Mbi pllakat e lëmuara të gurëve të lumit malor, kishte mbetur vetëm përpëlitja e lehtë e troftës së vogël dhe çudia e syve të mi të pamësuar ndonjëherë me pamje të tilla.

Një grup pishash ardhur nga pylli pranë, lëvizën befasisht trungjet e tyre të drejtë dhe nisën të nxitonin drejt lumit. Ishte një skenë që mund të kishte ndodhur vetëm në ndonjë fletë përrallash të vëllezërve Grim ose në vargjet lirike të ndonjë rapsodi vendas. Por, ja që çuditë nuk quhen më kot çudi. Dhe ndodhi vetëm para meje dhe syve të troftës së vogël të lumit, ndërkohë që ne ishim duke folur me njëri tjetrin. Ishte mesdita kur toka avullonte dhe shfrynte nga zhegu para syve të mi mirazhet që zëvendësonin njëri tjetrin.

Kjo ishte arsyeja që unë nuk po i besoja syve kur i pashë brenda ujit të kaltër. Të gjata dhe të drejta, siç dinë të jenë, vetëm ato e veshin lumin me një nur të paparë dhe tundin degët e hijshme plot gjethe dhe gëzohen si fëmije të vegjël (njësoj si unë kur isha e vogël).

Ndoshta vapa e madhe, ndoshta ndonjë mrekulli i kishte bërë ato të mblidhnin rrënjët nën vete dhe të përqafoheshin me ujërat. Oh, ishte një përqafim i bukur, më shumë se i bukur, siç shprehej një mikja ime që s’bënte dot pa superlative kur shihte ndonjë pikturë.

-Mos u habit, - më tha trofta e vogël bashkëbiseduese, - këta vijnë përditë këtu dhe ne mrekullohemi me këtë shfaqje drurësh.

Atë çast m’u kujtuan sërish vëllezërit Grim dhe m’u krijua bindja se ata nuk mund të ishin aq përrallëtarë sa i mbanin, por njëherësh m’u krijua dyshimi se këto pisha dikur mund të kenë qenë vajza të bukura dhe ndonjë magji mund t’u këtë dhënë pamjen e drurëve të tanishëm.

Skena e krijuar përpara meje besoj se m’i jepte të drejtë fantazisë, prandaj dhe s’më vjen zor që ta shpall këtë gjë para jush.

Unë dhe trofta e vogël dje ishim spektatorë në brigjet e një lumi të vogël ku drurët rikthehen në vajza që notojnë...

UDHËTIMI PËRTEJ DETIT

Në rrugën drejt viseve të mia të përtej detit, njerëzit që takova mbanin në duar nga një erashkë verore dhe nga një algë të tharë nga vapa. Shumica kishin dalë nga hijet e tyre dhe shenjat e dritës vetëm sa ju shkaktonin alergji në lëkurë.

-Mirë se erdhe në vendin e hijeve, - më pati thënë kapiteni i anijes, me të cilin po udhëtonim.

Në atë vend distanca mes tokës dhe diellit ishte më e largët se kudo tjetër, e megjithatë bënte nxehtë, shumë nxehtë.

- Kjo gjë na ndihmon t’i avullojmë mendimet, - pati folur sërish kapiteni.

Herë - herë frynte një erë e butë. Pulëbardhat në çast ngriheshin nga vetmia e tyre për t’i zgjuar varkëtarët që kishin mbetur, sepse, siç thoshte kapiteni, varkëtarët këtu i hanë dallgët ose i ha bregu matanë.

Atje dukej se të gjithë diejt qëndronin me një këmbë mbi tokë, e me këmbën tjetër andej përtej dallgëve, përtej sirenave dhe këngëve të tyre joshëse.

Çdo mbrëmje binin ca shira të çuditshme dhe fill pas tyre njerëzit merrnin trajta liliputë. Pikërisht këta mbanin erashka verore dhe alga të thara.

Udhëtimi akoma nuk ka përfunduar...

KORNIZAT E QIELLIT

Ka kohë që qiejt e mi kanë nisur të luajnë me errësirën dhe drita e tyre më ngjan e zbehtë. Çdo natë ti ankohesh për mungesën e kontrasteve dhe kornizat e qiellit i sheh gjithnjë e më të ngushta.

Nga frika dalëngadalë kam nisur të prek trupin tim për t’u siguruar në është i imi vërtetë apo ka fluturuar në qiell. Mërzitem, sepse kam nisur të humb çdo ditë nga një drithërimë. Ndonjëherë retë e qiellit më ngjajnë si balenat e bardha orka dhe vështrimet e tyre enigmatike më shqetësojnë.

Edhe sot dikush m’i hëngri zogjtë postierë që ishin nisur drejt meje, dhe unë mbeta pa asnjë letër dashurie! Nostradamusi ka shkruar për ta (që hanë zogj) në faqen 2568 të librit të tij për kaosin. Dikush më thotë se terri ka pikuar nga ky libër, por unë nuk e besoj. Gjithmonë kam besuar se demonët dhe terri krijojnë njëri-tjetrin.

Për çdo ditë mundohem të flas me zogjtë e vdekur të fisit tim, por s'mund t’u nxjerr asnjë fjalë. Tashmë edhe të vdekurit kanë nisur të ankohen nga verbëria dhe pesha e pamjaftueshme e dheut mbi ta dhe kjo është tragjike. Akoma e shoh errësirën dhe plot drita që pipëtijnë me një dhimbje, kurse unë mendoj se ato drita në fakt janë shpirtrat e atyre që m’i kishin hëngër zogjtë postierë dhe që më lanë pa letra dashurie.

I dashur, ti ke të drejtë të ankohesh për mungesën e kontrasteve dhe ngushtësimin e kornizave të qiellit, atje ku ka fluturuar edhe trupi im...

DHIMBJA

DY TREGIME NGA FATMIR LLESHI

Asnjëri prej nesh nuk ishte tip sportiv. Nuk vraponim, nuk loznim basketboll ose futboll. Në fakt, jam i prirë të besoj se ky mosaktiviteti fizik i yni, më shumë varej nga babëzia jonë për ta shfrytëzuar kohën për qëllime tjera, sesa nga ngathtësia e trupave tonë, apo nga mungesa e talentit. Me apo pa vetëdije, përligjnim shfrytëzimin e pamëshirshëm të kohës. Fjali të tipit, "derisa terja flokët i hova sytë një soneti të Shekspirit" ose "u vonova për të kapur autobusin, pasi bluaja një mendim të Sontag-ut" ishin goxha normale.

Sidoqoftë, gjatë atyre javëve, lozëm *një herë* pingpong në një palestër të re që kishte formën e një veze në ngjyrë të zezë me pika të verdha. Interesimi ynë u ngjall pra në rend të parë, nga shija jonë artistike për ta parë nga brenda këtë godinë të re të arkitekturës. U ramë korridoreve e kthinave poshtë e përpjetë, por mbetëm paksa të dëshpëruar. Pamja e saj e jashtme intriguese, zbehej sapo shkelje portën dhe me të treteshin dhe pritjet plot kureshtje e fantazi të vizitorëve. Pas nja gjysmë ore me pingpong, mblodhëm raketat dhe topat dhe ikëm nga palestra.

Kur dolëm jashtë, zbritëm poshtë shkallëve që të çonin në një park të vogël me tryeza të rrumbullakëta dhe karrige plastmasi në ngjyrë vjollce. Befas, nga asgjëkund, përpara na mbiu Sofia. Dukej edhe më thatuke, edhe më e elektrizuar.

- Nuk vij në orën tjetër. I thoni Hansit se... - i mbeti një komb në grykë.

- Ç'u bë? - nxitoi Maja.

Currilat e lotëve shpërthyen pa asnjë paralajmërim, ato rrokulliseshin me ngut poshtë asaj hunde të përkryer.

- Një djalë i tezes sime është vrarë në Etiopi. Ishte vullnetar në "Mjekët pa kufij".

- Tmerr!

Sofia fshinte me të dy duart çurgun e rrëmbyeshëm të lotëve që s'kishin të ndalur. Ne të tre hallakatëm çantat tona të shpinës, Roberti ia zgjati i pari pakon e facoletave të letrës.

- Ai ishte ca vjet më i madh se unë, por si fëmijë kemi kaluar shumë kohë bashkë, posaçërisht gjatë pushimeve verore që i kalonim te gjyshi dhe gjyshja.

- Si ndodhi kjo?

Ajo mori frymë thellë, dënesjet u rralluan.

- Shumë variante na zuri veshi. Në fillim dëgjuam se Henriku, kështu quhet kushëriri, ishte vrarë duke shpëtuar një të plagosur gjatë një zënke ndërmjet dy klaneve. Pastaj na thanë, jo u vra nga një i afërm i një pacienti të operuar nga kushëriri im, por që paska vdekur më vonë, mbasi demek paskësh dështuar operacioni. Më në fund na thanë se, dhe kjo siç duket duhet të jetë e vërteta, ca njerëz paskan hyrë natën në tendën ku flinin mjekët dhe personeli tjetër mjekësor, me qëllim për t'i plaçkitur. Henriku i shkretë e paska pasë fatin e keq që u zgjua i pari duke i zërë me presh në dorë. E therrën me thikë. Mund ta merrni me mend, e vranë mu atë që shkoi në fund të botës për t'u ndihmuar.

- Çfarë njeriu humanitar! - thashë unë, jo me pak admirim.

- Shko thuaji tezes sime këto fjalë! - m'u kthye ajo e ndëkryer.

Pikëllimit të saj i ishte shtuar një tërbim i furishëm. Nuk bëra zë.

- Qëndroi atje për gjashtë muaj, u rropat i shkreti për t'i mjekuar njerëzit që kurrë nuk i kishte parë në jetë dhe së fundi, ishin ata ose të afërmit ose fqinj të atyre që u doli zot, që e therën. Tezes sime nuk i telefonoi as dy herë gjatë tërë kësaj kohe. Tani, ia shoi zemrën të mjerës për jetë të jetëve. Mund ta quajmë tërë këtë histori si humanizëm?

Asnjë përgjigje. Ajo formuloi edhe një pyetje, me zë më të ashpër:

- E dini ç'është më tragjikja?

Ajo shtroi flokët dhe ndreqi jakën. Na gozhdoi të treve, një nga një, saqë m'u duk se në atë çast kënaqej shpirtërisht, duke na kundruar ashtu të shugatur para monologut të saj eruptiv. Ne heshtëm prapë.

- Siç i tha tezes njëri prej personelit, me të cilin tezja ra në kontakt më në fund, Henriku nuk kishte asnjë kacidhe në kuletë atë natë.

Gjë që nuk ishte më tragjikja e asaj tragjedie, edhe pse Sofisë iu përftua ashtu.

Kur u ndamë nga Sofia, Roberti tha mendueshëm:

- Kur dëgjova këtë histori, mendja më shkoi te citostatikët që luftojnë qelizat kancerogjene. Në atë luftë u shkon kryet edhe qelizave të shëndosha, siç i ndodhi edhe kushëririt të Sofisë. Ca e ca bamirës duhet ta paguajnë shtrenjtë, disa edhe me jetë, në mënyrë që misioni humanitar të mbetet gjallë, dhe të vazhdojë rrugën e vet.

- Jo rrallëherë, trimëritë dhe virtytet bien në hije të më banales, - shtova unë po aq i mendueshëm sa ai.

Henriku i Sofisë preokupoi vëmendjet tona për disa ditë. Ç'e shtyu atë për një hap të tillë? Të braktiste sigurinë sociale e materiale dhe të rrezikonte jetën për njerëz të largët e të panjohur? Dhembshuria? Karakteri i tij? Edukata familjare?

Roberti ndërpreu këtë kanonadë virtytesh që këputeshin nga gojët tona dhe që i ngjante fort zërit monoton të pikave të ujit, kur harrojmë ta mbyllim rubinetin ku të jetë.

- Por çka, nëse kjo është më e thjeshtë sa e pandehim ne? Nuk dyshoj se Henriku ishte njeri bujar, të cilit i rrihte zemra për jetët e njerëzve të goditur nga fatkeqësitë, edhe nga ato më të ndryshmet e më të fortat qofshin. Por ta zëmë, të luajmë pak me këtë hamendje, se ai në të njëjtën kohë ka qenë një i ri i papunë dhe se shkuarja e tij atje do t'i shtonte atij një plus të madh në CV-në e tij goxha të varfër me referenca punësimi. S'ka nevojë ta stërzmadhojmë virtytin e tij. Gjërat përreth tij mund të kenë qenë vendimtare njëlloj. Një varg ngjarjesh, për ne të panjohura, që e kanë vërë me shpatulla pas murit dhe e kanë shtrënguar të lajmërohet si vullnetar.

- Mund ta ketë pasur egon e pangopur, vullnetin e pamasë për t'u treguar i aftë, gjë që e degdisi në spitalet e improvizuara të vendeve të varfra, - ndërhyra unë.

- Këtë kronologji përfytyron ti? Ego, kërkim i sëmurë i vëmendjes së të tjerëve, bamirësi? - m'i nguli sytë e kaltër e të butë Maja, e cila vijoi: - Unë nuk i hedh poshtë rrethanat anësore, por besoj me tërë forcën në dhembshurinë e njeriut dhe në forcën marramendëse të çastit. Në sekondat çudibërëse. Unë nuk përjashtoj fare mundësinë që Henriku, para misionit të tij vullnetar, ta ketë pasur para vetes një foto të një fëmije të leqendisur etiopian, me bark të fryrë, mollaqe të vyshkura, në prehrin e së ëmës, po aq të përvuajtur e të uritur sa vetë ai. Nën sfondin mizor të diellit përvëlues dhe të shkretëtirës shterpe, ku nuk mund të paramendoje as pezhishkën më të hollë të shpresës. Unë jam e bindur se kjo mund ta ketë shtyrë Henrikun t'i mbledhë plaçkat, dhe t'ia mësyjë Etiopisë.

- Argument i fuqishëm ky. Dhe poetik. Ndoshta për së tepërmi poetik... - tha Roberti duke kruar zërin e tij serioz - Por, më duhet të them se të gjithë njerëzit s'kanë dhembshuri.

- Nuk është ashtu. Të gjithë njerëzit kanë dhembshuri, Robert. Dallimi është se ç'bëjmë me të. Ca nga ne i mbyllim sytë dhe i ikim asaj, duke shpresuar se gjërat do të ndreqen disi edhe pa ndërhyrjen tonë, anipse kjo nëse shikohet thellë, është vetëm një iluzion, dhe këtë iluzion e kemi si nevojë për t'i ikur ndjenjës së fajit. Të tjerët kacafyten dhe luftojnë shkaqet që sjellin dhembshurinë, por kjo kërkon sakrificë, kërkon kohë e lekë si dhe përjashtimin e një jete tjetër, sigurisht, më të rehatshme. Dua të them edhe një gjë të cilën ju e prekët përciptazi: fakti që ndihma e bën të padukshëm tjetrin, nevojtarin. Nga perspektiva jonë, në qendër të vëmendjes del mjeku që vjen nga larg dhe martirizohet për t'i bërë mirë të tjerëve. Kjo është e vërtetë, prania e bamirësit ua bjerr individualitetin nevojtarëve, i bën të duken si miza.

Roberti shihte si një tuhaf. M'u duk se lëshoi një hungërimë, nëpërdhëmbi diç të pa artikuluar si një njeri parahistorik. Unë përpëlitesha, ndërkohë, pija *Coca-Colën* time me gllënjka të vogla dhe pas çdo thithjeje të thellë të cigares, e shikoja me hutim atë gypth të bardhë me filtër, a thua se ai do të më jepte krahë.

- E ke thënë edhe përpara. Pse i jep aq shumë vlerë e rëndësi çasteve, sekondave? - e pyeta qetë, duke dëshiruar ta drejtoja në një kah tjetër bisedën.

- Jeta nuk përbëhet vetëm nga muajt dhe vitet. Ajo përbëhet nga sekonda, nga çaste të shkurtra e intensive që na ndryshojnë, dhe të cilët na skaliten në mendje përgjithmonë. Gjatë asaj shkëndije kohore, nxitemi të bëjmë diçka madhështore, persiasim ide magjepsëse ose bëjmë marrëzi të pafalshme.

- Vijnë ato vetë, apo i nxisim ne?

- Nuk e di, Altin. Nuk e di. Por a ka rëndësi kjo? Njeriu është i shtrënguar të notojë, rryma e jetës e fshin përpara dhe e drejton siç do vetë ajo. Por, në atë rrjedhë kozmike, ka vend për përpëlitje.

Mbaj mend se, duke dëgjuar Majën tek fliste për sekonda, rrjedha dhe notues, druaja nëse ajo në të njëjtën kohë, përfytyronte dhe përcaktonte *notuesin tim* atëbotë. Kisha drojë se ajo shihte një syresh që iu ishte dorëzuar valëve të jetës. Një trup të paformuar, që përplasej majtas e djathtas, nga shkëmbi në shkëmb, nga bregu në breg. Pa revoltë.

FOTOGRAFIA

Kursi vijoi me ndërthurjet teori - praktikë. Mësuam për historikun e artit fotografik, për pionierët e tij, rrymat më dominante, teknikat e zhvillimit të fotografisë. Futeshim në dhomat e errëta dhe çuditeshim me metamorfozën, kur negativat e përçudnuar shndërroheshin në riprodhime të lëmuara në letër. Për fund, çdonjëri prej nesh duhej të prezantonte nga pesë foto, punimet tona vetanake. Hansi kufizoi harlisjen tonë artistike, duke na caktuar një temë: *nostalgjia*.

Më habitën punimet e Helenës që kishte fotografuar një numër të madh shkrepësesh, frutash e qirinjsh të renditur në formë trapezesh, rombesh e shumëkëndëshash të madhësive të ndryshme. Jo aq nga fantazia e projektit, se sa nga motivacioni i ftohtë i saj:

- Unë e marr nostalgjinë si një konsolidim gjërash. Nisur nga kjo, s'ke gjë më të harmonishme se trupat gjeometrikë.

Unë mendoja të kundërtën. Nostalgjia nënkupton humbje, dhe diçka që humbet, nuk vihet në terezi dot. S'bëra zë, nuk isha i disponuar për polemika.

Sofia ishte ende skllave e zisë për kushëririn e saj, gjë që edhe u shpreh në punimet e saj të tejshquara: lotët që pikonin nga dy fytyra të paidentifikuara, ca varreza në mjegull. Në fakt, më interesonte më shumë se ku i kish gjetur ata individë të përlotur, nga ç'vend kishin mbirë?

Paskëtaj Hansi ma dha fjalën mua. Që nga shpërthimi im i fundit, dukej sikur ai tepronte kujdesin ndaj meje, sikur ndiente nga larg erë servilizmi. Mbaja një qëndrim të ftohtë ndaj tij, por në të njëjtë kohë më brente ndërgjegja mos kështu e injoroja pa nevojë. Këtu luante rol edhe Marina, me siguri që këtë disponimin tim e bisedonte me të, s'kish si të ndodhte ndryshe. Projektova foton e parë: një lirishtë, një qilim, një shportë.

- Të bëj një sqarim që në krye të prezantimit. S'di sa do të ndryshonte kjo në kualitetin dhe porosinë që dua të përçoj, por kur fotografova këto skena mendjen e kisha te stina e pranverës. Seç m'u kujtua një maj i dalldisur me diell e shi, siç është rëndom ky muaj në vendin tim. Unë me një moshatar timin, ishim dymbëdhjetë a trembëdhjetë vjeç, patëm kaluar kilometra rrugë në këmbë, prej livadhi në livadh, prej suke në përrua e prej zallishte në bërryla kodrash në kërkim të insekteve për herbariumet tona. Akoma e ndjej thellë atë klaustrofobi mikluese, atë rrezatim nga më të ëmbëltit, që ta ngrohte e guduliste shpirtin e zemrën, kur rrugëtimi na pruri në një lirishtë të rrahur nga dielli i verdhë si hareja, pas shiut të shkurtër çapkën. Qëndruam shtrirë në barin e njomë, thithëm aromat e stinës së tretur dhe asaj që trokiste në derë, dhe përlamë me oreksin e llaskucëve të paparë, pitet e yndyrshme me djathë, të pjekura nga e ëma e shokut. Më pastaj, kur i mbushëm brinjët mirë me ushqim dhe kur shuam etjen me lëngjet e gazuara, krenarisht peshkuam nga qeskat e pëlhurta flutura ngjyrë ylberesh, grerëza kokulura si nga turpi, dhe ca kacadre, që ndonëse të ngordhur, të çonin mallin e ushtarëve antikë të gatshëm për sulm të hovshëm.

Përnjëherë u përmenda nga kjo dalldi. Të tjerët ishin duke më përpirë me sy, vështrimet e tyre çmeritëse tregonin se ata sapo kishin marrë pjesë në një eksperiment, ku unë, një mi me elektroda të mbërthyera mbi kokë, isha shkëputur totalisht nga realiteti, si me një prerje precize bisturie.

- Shumë shprehëse, - tha Hansi.

Doja të besoja se ishte i çiltër.

Fotografitë e tjera ishin kopje të së parës, i paraqita me të shpejtë pa ndonjë entuziazëm.

Roberti mungonte atë ditë. Maja bëri prezantimin, në vend të tij. Në foton e parë shihej mjegullt një kasollë nga larg, në të dytën, e njëjta ngrehinë kishte tashti dyert e hapura dhe qe shkrehur nga afërsia. Në fotografinë e tretë dhe të katërt i njëjti vend, me dallimin e vetëm që, në vend të kasolles shihje një vilë goxha të madhe. Në foton e fundit dallohej shpina e një burri që ecte me nxitim në një shteg.

- E thjeshtë dhe sugjestive. Teknika lë shumë për të dëshiruar, - rrudhi buzët Hansi.

E fundit ishte Maja. Ishte hera e parë që shihja fotografitë e saj (që të dy ishin fjalëpakë rreth punimeve tona, kurrë nuk e patën zënë në gojë sesi i shkonin punët dhe as që u interesuan si më venin të miat). Maja paraqiti një koleksion fotosh të aranzhuara. Në të parën ishte vetë ajo, symbyllazi me një fashë të zezë, dhe me një buzëqeshje asgjëthënëse. Duart, me dorashka lëkure, i kishte vënë sipër një muri në miniaturë, ndërtuar me *puzzel*

fëmijësh, me një shirit në mes, flakë të kuq, ku qe shkruar me të bardha "Berlin". Kishte diçka të thellë e ngulfatëse në këtë thjeshtësi. Sfondi ishte i shndritshëm e metalik.

- Muri i Berlinit, lufta e ftohtë. Dikujt edhe mund t'i ngjallë nostalgji kjo? Po ty? - pyeti Hansi ftohtë dhe kryqëzoi duart, siç bëjnë njerëzit kur dëshirojnë të distancohen prej diçkaje.

- Oh jo, nuk e kisha mendjen tek ideologjia. Një ide tjetër më intrigoi. A nuk është e zakonshme, dhe po aq absurde, që njeriu ndjell mall edhe për kohërat më të vështira dhe më të pështira, vetëm e vetëm për ta rijetuar mendërisht një bashkësi iluzore? Njeriu është mjeshtër i relativizimit të së kaluarës.

- Më intereson një gjë, kush qëndron me aparat në dorë? Roberti?

- Jo, im atë.

- A mund të flasim atëherë se kjo vepër është e jotja?

- Pse jo? - qëndroi e palëkundshme Maja, si një shkëmb. - Shtypja me gisht nuk e bën kënd autor.

- Por buzëqeshjen, si ia dole me këtë pozë neutrale mbytëse? E shtrëngove atin të shkrepë njëqind herë të njëjtën pozë? - tentoi me humor Hansi.

- Jo njëqind, shumë më pak.

- Më duhet të pranoj se ti, së bashku me tët atë, e keni ngurtësuar me të vërtetë momentin. Ç'mendon për pohimin e disa fotografëve se duhet pritur rasti, me durimi të pasosur, për atë sekondën vendimtare të bekuar kur shtypim butonin, është vendimtar për kualitetin e fotografisë?

- Unë besoj në çaste, por jo dhe aq në pritjet molisëse që ato të na aterojnë nga gjëkundi, si ato vizionet religjioze të ngarkuar me elemente mrekullie. Shikuar nga ky prizëm, mendoj se fotoja dhe jeta janë plotësisht të ndryshme. Ke aparatin me vete, rastet të qëllojnë pa fund. Edhe kur nuk rastisin, i formon vetë siç bëra unë. Unë nuk shoh kurrfarë problemi me aranzhimin e objekteve. Ndryshe është me jetën, aty vetëm sa humb kohë duke pritur rastin tënd, as të aranzhosh diçka që nuk ke kushedi sa mundësi.

Edhe fotografitë e tjera të saja mbanin të njëjtin stil, të njëjtën shprehje, të njëjtën forcë shtytëse. Njëra prej tyre ishte e ndarë në katër kuadrate, ku duke filluar nga ai në këndin e majtë lart, shiheshin me radhë: ca pulla postare të vitit 1971, teksti i kartolinës dërguar nga një plazh përvëlues, pamja piktoreske nga Tenerife dhe së fundi, një arkë e drunjtë e kyçur me dry, në qoshin e djathtë poshtë. Ose një tjetër, sërish me Majën si objekt, me një rrëqethje molisëse në fytyrë, sikur mundohej të shqiste nga gjoksi dy copëza letre të rrumbullakëta të ngjitura në secilën trinë të duarve të saj, ku ishin vizatuar vezorja dhe respektivisht spermatozoidi. Kthimi tek fillimi më i hershëm i njeriut? Zhbërja e vetes?

- Vërej se ke dëshirë të jesh pjesë e një vepre, jo vetëm ta formosh nga distanca. Ç'është për ty arti? - e pyeti Hansi qartë dhe rreptazi, në atë pauzë që u krijua ai i përngjante avokatëve që i parashtronin pyetjen vendimtare dëshmitarit.

- Mua më pëlqen vepra që më bën të këlthas "aha?", ose të zbythem me një "ruana zot!". Nganjëherë nuk na zë vendi vend kur shijojmë një vepër arti, shqetësohemi pa e ditur psenë. Edhe kjo është dëshmi e pakundërshtueshme se autori ia ka arritur qëllimit.

Prezantimi i Majës më krijoinjë bezdi të pa përshkruar. Ajo balanconte gjithmonë mes kryeneçësisë për t'i ardhur deri në fund gjërave dhe ftesës therëse që i bënte bashkëbiseduesve për ta luftuar argumentin e saj. Desha ta përgëzoja për vetëbesimin e saj, për atë dritë qartësie që përçonte prania e saj. Sa përfundoi ora iu afrova, por ajo ma priti e para:

- Më pëlqeu pa masë ajo që the ti.

- E çfarë ishte ajo? - hapa gojën unë.

- Kujtimet e fëmijërisë. Një depozitim i zhveshur ndjenjash.

Më shikoi dëlirë. Që nga fillimi ato sy shkaktonin tek unë herë çlirim, herë respekt gudulisës e herë distancë të mjaltët hyjnore. Atë ditë vetëm më ngrohën.

Mbi romanin "Tala", të shkrimtarit Xhevair Lleshi

STREHA MAGJIKE E 'TALËS'

Dr. Ditar Kabashi

Fatlum cilësohet njeriu kur e bën një gjë të cilën e admiron, sado e madhe të jetë ajo gjë. Poeti i madh turk Nâzım Hikmet, i cili ishte dëbuar nga atdheu dhe kishte mbyllur sytë larg tij, thotë: "*Dua një lumturi të vogël. Le të jetë aq e vogël, sa askush të mos ma kërkojë*". Të shkruash qoftë edhe pak rreshta për veprimtarinë e dikujt që ka shkrirë jetën për letrat në gjuhën e vet, është një mundësi por edhe lumturi e madhe. Megjithatë, privilegjin për të shkruar një përshtypje të thukët për veprën "Tala" të z. Xhevair Lleshi, prirem ta konsideroj "lumturi të vogël", me lajtmotivin e Hikmetit, "që askush të mos ma kërkojë", pra që të jetë nën zotërimin tim.

Pedanteria e fjalës, e përftuar nga përshkrimi psikanalitik dhe një gjuhë tejet e pasur rrëfyese që dyzohet në unin e shkrimtarit Lleshi, merr trajtën e një romani që lexohet me një frymë. Dhe ky lexim nuk bëhet "me një frymë" nga thjeshtësia e tematikës që trajtohet në roman, porse nga narracioni i qëndisur mjeshtërisht, ku sapo ftillohet një e ngjarë, ajo di t'i hapë udhë personazheve që dalin në arenën e ndodhive të njëpasnjëshme. Kjo sendërgjon ritmikën e nevojshme për të mbajtur gjallë interesimin se çfarë të pret në faqen vijuese.

Duke qenë se në fokusin e romanit radhitet një vargan ngjarjesh që kanë ndodhur në qytetin antik e përrallor të Shqipërisë, të cilat zënë fill si rrjedhojë e luftës së fundit në Kosovë, natyra e veprës merr një kolorit verbues stinësh. Aty ka shtrëngatë: eksod të egër, vdekje, vrasje, përdhunim, tradhti, vjedhje, luftë... me një fjalë, elemente tragjike që ngrijnë gjakun dhe lexuesi nis e vret mendjen nëse secili humanoid që ecën me dy këmbë është në të vërtetë **njeri**. Në anën tjetër, në margjinat e fletëve të këtij libri, hera-herës na shoqëron mot i këndellur gjallërues: solidariteti njerëzor, mikpritja shqiptare, biblioteka si dritare për botën, mensa që bashkon njerëz rreth bereqetit që quhet bukë, hareja e bashkëjetesës (qoftë e përkohshme dhe në

rrethana të pazakonta), bukuria e dialekteve të degëzuara që hijeshon trungun e gjuhës shqipe, dëshira dhe motivi për të çarë rrugën tej pavarësisht sprovave e sfidave të jetës... thënë shkurt: përkundër të gjithave, *gjurmimi për të vazhduar jetën*. Jetën, meqë ajo e mund edhe vdekjen. Jetën që rilind pas secilës vdekje, sikur sythat që çelin rishtas e rishtas edhe pas dimrave më të acartë. Kështu rilindi edhe populli ynë. Kësaj radhe më i bashkuar e më pranë pjesës tjetër që jetonte matanë kufirit.

Barrierat u thyhen; kosovarët gjetën strehimin në kampin e refugjatëve të qytetit antik (natyrisht, jo vetëm aty). Në këtë rast, strehimi nuk parakuptonte banimin e disa të shpërngulurve dhunshëm, që kishin ikur nga vendlindjet e tyre, siç përkufizohet rëndom. Përkundrazi, kjo ishte një prekje e dy copëzave të një zemre, që kishin funksionuar çuditërisht ndaras për një kohë të gjatë, por që të dyja kishin kryer funksionin e tyre për të mbajtur gjallë organizmin: **shqiptarinë**. Shi për këtë, pa kaluar një copë kohe, **Tala** zë e nis të flasë me dialekt kosovar. Ky efekt origjinal ndriçon errësirën artificiale të mosnjohjes me njëri-tjetrin. As malet e larta që ndajnë hapësirat gjeografike nuk mund të ishin pengesë për afrinë. Siç thuhet me të drejtë në këtë libër "*mali s'ngre mure, po shkëmbinj*" (f. 47). Këta shkëmbinj dëshmojnë për qëndrueshmërinë e këtyre trojeve. Fundja, toponimet ishin kthyer qëmoti në emra njerëzish.

Dhimbja, që është njëra ndër elementet më të spikatura në këtë libër, në dukje të parë i sjell angështi personazheve të caktuara. Por, sakaq, ajo shtrihet në dimension përbashkues, ku gjithsecili e ndjen atë gjer në inde. Kësisoj, skenat në të cilat krijohet empatia mes nikoqirëve dhe mysafirëve në kamp kalon rrugëtimin "*e nisjes nga vetja për të mbërritur po te vetja*" (f. 93). Ngase, në të vërtetë, në situata të tilla, vetat e shumtë dinë të bëhen një. Së këndejmi, autori, me gojën e rrëfimtarit Buli, hedh edhe një hipotezë indikative për fatin e përbashkët të Kosovës me Shqipërinë. Rrëmuja politike e publike e vitit 1997 në Shqipëri, (të cilën Buli e quan **revolucion komunist**) ishte një faktor i pashmangshëm për çlirimin e Kosovës. Po të mos ngjante ajo katrahurë civile, gjithsesi do të kishte shpërthyer lufta për armatimet midis Serbisë dhe Shqipërisë (f. 130). Pra, edhe në këtë pikë ka një kauzalitet. Dhe po ta marrim si të mirëqenë këtë pohim, kjo na përkujton që edhe në fatkeqësi mund të ketë fat. Përkundër të gjitha mynxyrave që u erdhën në kokë personazheve nga Kosova, ata zgjodhën rrugën e krenarisë dhe të betejës në secilën formë. Nuk e pranuan nënshtrimin dhe as përuljen.

Drejtësia është një element tjetër që përvidhet mes rreshtash. Keqpërdorimi i financave në kampin e refugjatëve u dogji kokën përgjegjësve. Batakçinjtë morën dënimin e merituar se prekën hakun e të pafajshmëve.

Ky roman është pasqyrim i një pune të palodhshme të autorit në parashtrimin e personazheve që i dhanë jetë librit. Duke e njohur karakterin e fortë e të palodhshëm të autorit, s'do mend se i gjithë ky mund i tij vetëm se i ka dhënë kënaqësi dhe aspak bezdi. Ngaqë, sikurse theksohet në fund të f. 229, "*puna e bëri njeriun njeri*". Andaj, duhet t'i shprehim mirënjohje z. Lleshi, i cili para se të jetë shkrimtar është **njeri**, që na freskoi një kujtesë kolektive me hije të rëndë duke e kthyer në një libër që meriton vëmendje.

Për ta ruajtur magjinë e leximit të kësaj vepre nuk do ishte në interes që këtu të shpalosen shumë hollësi. Hëpërhë mjafton t'i gëzohemi pranisë së Talës, mbase jo si person fizik dhe me ymër të caktuar, e aq më pak me jehonën e saj në hollin e *Grand Hotelit*, por si sinonim bujarie dhe si kronikë që do të zërë vend përgjithmonë në shtratin e shkronjave shqipe.

10.6.2022

ExLibris - sponsor medial i konferencës shkencore ndërkombëtare, "ÇËSHTJE TË GJUHËS, LETËRSISË DHE PËRKTHIMIT LETRAR". Fakulteti i Filologjisë i Universitetit "Fehmi Agani", Gjakovë

Përmirësimi i aftësive të të folurit të një gjuhe të huaj nëpërmjet veprimtarive në grup dhe atyre individuale; Një studim krahasues.

Dr. Rudina Vrioni

Vitet e fundit, gjuha angleze është kthyer në një prioriet për studentët tanë. Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, një numër i madh studentësh nga departamente të ndryshme, zgjedhin të studiojnë gjuhën angleze si gjuhë C, duke besuar se kjo gjuhë ndërkombëtare do t'i ndihmojë për një karrierë të sukseshme pas diplomimit. Me gjithë dëshirën e këtyre studentëve për të mësuar gjuhën angleze, vihet re vështirësia që ata hasin në zhvillimin e aftësive të mira të të folurit në këtë gjuhë.

Duke pasur parasysh se klasa është vendi ku studentëve u krijohet mundësia për të folur një gjuhë të huaj, është detyra e mësimdhënësit që të zgjedhë atë metodë mësimdhënieje e cila rrit mundësinë e përdorimit të gjuhës nëpërmjet komunikimit.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë dhe krahasojë dy metoda të ndryshme mësimdhenieje, duke vlerësuar më tej ndikimin që ato kanë në përmirësimin e e aftësive të të fourit të një gjuhe të huaj. Kemi ngritur hipotezën se veprimtaritë në grup ndihmojnë studentët të përmirësojnë aftësitë e tyre të të folurit më shumë se veprimtaritë individuale, duke besuar se aplikimimi i punës në grup në fushën e mësimdhënies së një gjuhe të huaj eshtë thelbësor, pasi ai krijon një situatë ku studentët priren të përvetësojnë aftësi sociale e akademike duke u përpjekur të ndihmojnë njëri-tjetrin, të diskutojnë dhe argumentojnë, të vlerësojnë njohuritë e bashkëmoshatarëve dhe të ndërtojnë njohuri duke komunikuar së bashku.

***Fjalë kyçe**: gjuhë e huaj, student, të folurit, mësimdhënie, grupe*

Një nga përgjegjësitë kryesore të mësimdhënësve të një gjuhe të huaj, është të bëjnë të mundur përdorimin e saj nga ana e studentëve nëpërmjet komunikimit. Për studentët është e rëndësishme të mësojnë të flasin gjuhën e huaj dhe për mësimdhënësit të dijnë se si t'i ndihmojnë studentët ta praktikojnë atë.

Aftësia për të komunikuar në një gjuhë të huaj në mënyrë të qartë, kontribuon në suksesin e studentëve, jo vetëm gjatë periudhës së studimeve, por në çdo fazë të jetës. Të folurit është një aspekt mjaft i rëndësishëm i të nxënit të një gjuhe të huaj. Në shumë kontekste arsimore, mësimdhënësit zgjedhin të fokusohen në shpjegimin e gramatikës dhe të fjalorit, sepse janë pikërisht këto dy elementë të gjuhës që testohen në provime. Studentët mund të kalojnë provimet me njohuritë që kanë në përdorimin e gramatikës dhe fjalorit, por e kanë të vështirë të përdorin fjalët e reja dhe të komunikojnë në gjuhën e huaj. Për këtë arsye, mësimdhënësit duhet të ndryshojnë fokusin e tyre dhe të zhvillojnë aftësitë e studentëve për të folur gjuhën e synuar, nëpërmjet komunikimit.

Sipas Edge (1993) komunikimi është mjeti kryesor i mësimdhënies moderne të një gjuhe të huaj, dhe një pjesë e rëndësishme e të nxënit.

Kompetenca komunikative përfshin strategji të ndryshme të të mësuarit të një gjuhe, si shprehitë gjuhësore, sociale dhe ndërpersonale. Të folurit ndryshon nga aftësitë e tjera të gjuhës. Për t'i ndihmuar studentët që të kapërcejnë pengesat që ata hasin për të arritur nje nivel të mirë të të folurit, duhet të përzgjidhet ajo metodë mësimdhenieje që rrit mundësitë e përdorimit të gjuhës së huaj dhe organizimi i klasës në grupe është një nga metodat që nxisin komunikimin.

Veprimtaritë në grup në orën e gjuhës së huaj, i japin mundësinë studentëve për tu përfshirë në një komunikim ndërpersonal krijues dhe kuptimplotë. Sipas Krashen dhe Terrell (1983), komunikimi midis studentëve konsiderohet shumë më efektiv në rritjen e aftësive komunikative, sesa thjesht fokusimi në rregullat gramatikore. Duke u përfshirë në bashkëbisedime, studentët mund të përfitojnë strategji për të komunikuar dhe për të lidhur formën me funksionin, brenda një konteksti të caktuar. Grupet i ndihmojnë studentët për të rritur kompetencën gjuhësore. Long dhe Porter (1985) shprehen se puna në grup krijon më shumë mundësi për të folur sesa mësimdhënia e drejtuar nga mësuesi.

Çfarë është të folurit?

Sipas Kramsch (1983), të folurit është përdorimi i gjuhës për të transmetuar një mesazh në situata dhe në kontekste të ndryshme.

Të folurit ndodh në prani të një dëgjuesi, sepse dëgjuesi i përgjigjet komunikimit të folësit. Sipas Byrne (1986), komunikimi është një proces dy drejtimësh midis folësit dhe dëgjuesit dhe përfshin afësinë produktive të të folurit dhe aftësinë receptive të të kuptuarit.

Për shumë studentë, perfeksionimi i artit të të folurit është faktori më i rëndësishëm i të nxënit të një gjuhe të huaj dhe suksesi matet me aftësinë për të bashkëbiseduar në këtë gjuhë.

Nëse studentët perfeksionojnë të folurin, ata mund të aplikojnë gjithë aftësitë e tjera duke shprehur mendimet, idetë, emocionet dhe problemet e tyre.

Sipas Thornbury(2008), aftësia për të folur një gjuhë të huaj kalon në tre faza;

1. Ndërgjegjësimi - të kuptuarit e karakteristikave të gjuhës së synuar;

2. Përshtatja - kombinimi i karakteristikave të gjuhës me njohuritë egzistuese;

3. Autonomia - Aftësia për të përdorur gjuhën në mënyrë individuale.

Thornbury (2008), përmend disa veprimtari që nxisin pjesëmarrjen e studentëve dhe rrisin interesin e tyre, të cilat mund të përdoren nga mësimdhënësit për të nxitur te studentët aftësinë për të folur. Të tilla janë: diskutimet, puna në role, stimulimet, hedhja e ideve, ritregimi i ngjarjeve me role, intervistat, raportimet, përshkrimet në grup etj

Puna në grup e aplikuar në klasë, jo vetëm që promovon arritje më të mira në komunikim, por rrit edhe bashkëveprimin social mes studentëve dhe rezulton në krijimin e një mjedisi pozitiv të të mësuarit në klasë. Duke patur parasysh faktin se shumë prej studentëve e kanë të pamundur përfshirjen në situate të përdorimit të gjuhës jashtë klasës, pasi gjuha nuk flitet në komunitet, veprimtaritë dyshe ose në grup mund të përdoren për të maksimizuar bashkëveprimin mes studentëve.

Johnson (1991) shprehet se nuk ekziston asnjë praktikë tjetër e cila në mënyrë të njëkohëshme arrin kaq shumë rezultate. Interesi për të mësuarin në grup është rritur në këto 3-4 dekada, duke patur parasysh që gjithmonë e më shumë studime e punë kërkimore janë kryer e botuar, të cilat në mënyrë të qartë kanë demonstruar përfitimet që kanë studentët të cilët bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, krahasuar me studentët që mësojnë në klasat tradicionale.

Skema e studimit

Bazuar në gjetjet dhe pretendimet e studiuesve të shumtë, veprimtaritë në grup duket se u krijojnë studentëve mundësinë për të zhvilluar shprehitë e të folurit. Këto shprehi janë të nevojshme për sukses në të nxënin e një gjuhe të huaj dhe në lëndë të tjera. A janë aspektet pozitive të veprimtarive në grup njëlloj të aplikueshme edhe për studentët shqiptarë?

Si e perceptojnë studentët përdorimin e punës në grup në orët e mësimit të gjuhës angleze? A i mbështesin përvojat e tyre të mësimdhënies në grup studimet e mëparshme?

Për t'i kthyer përgjigje këtyre pyetjeve, përpiluam një skemë eksperimentale, e cila do të na ndihmonte të perceptonim nëse diskutimi në grup jep rezultate më të mira në të folurin e studentëve se veprimtaritë individuale.

Subjektet e studimit tonë ishin 74 studentë në nivel universiteti të cilët zhvillonin lëndën *Gjuhë C*.

Lënda *Gjuhë C*, zhvillohet semestrin e parë dhe të dytë. Në të përfshihen dymbëdhjetë tema të cilat zhvillohen gjatë tre orëve mësimore në çdo javë. Teksti i përdorur është *Opportunities, Education for life,* me autorë *M. Harris, D.Mower dhe A. Sikorzynska. Opportunities* është një metodë që i ndihmon studentët të përforcojnë katër shprehitë që ndihmojnë në të nxënin e një gjuhe: të lexuarin, të folurin, të dëgjuarin dhe të shkruarin.

Lënda realizohet nga 4 pedagogë të gjuhës angleze, me 74 studentë, në katër klasa paralele. Studentët ndiqnin vitin e dytë, të degës gjuhë Gjermane, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe kishin zgjedhur në preferencat e tyre të fillim semestrit gjuhën Angleze si gjuhë të huaj ose si gjuhë C. Studentët kishin një moshë mesatare prej 21,2 vjeç. Kursi dominohej nga vajza sepse tradicionalisht, pjesa më e madhe e studentëve të regjistruar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja janë vajza.

Brenda javës përpiluam një skemë e cila do të na ndihmonte të perceptonim nëse veprimtaritë në grup japin rezultate më të mira sesa puna individuale dhe i ndihmojnë studentët të praktikojnë të folurin. Do të vëzhgonim sesi këto dy metoda, ndikonin aftësinë e studentëve për të folur gjuhën e huaj e do të vlerësonim perceptimet e studentëve për shkallën e pëlqyeshmërisë së dy metodave.

Nisëm të modifikonim mënyrën se si do të zhvillonim orët që mbulonin seksionin *Speaking*, pra të folurin, për ta përshtatur atë me specifikën e studimit tonë.

Temat për diskutim u ndanë në dy grupe: gjashtë prej tyre do të zhvilloheshin duke i lejuar studentët të punonin individualisht dhe gjashtë të tjera duke i nxitur ata të diskutonin në grupe të vogla, të përcaktuara paraprakisht nga mësimdhënësi. Në rastin e grupeve shumë të mëdha është mirë të bëhet një nënndarje në grupe më të vogla të cilat duhet të ndahen që në fillim të lëndës.

Procedurat u zbatuan gjatë dy semestrave, duke mbuluar të gjitha temat e planifikuara në këtë modul.

Rezultatet e studimit

Bazuar në gjetjet tona, pas përpunimit të të dhënave të pyetësorëve, ky studim ka për qëllim të përshkruajë perspektivat e studentëve në lidhje me aplikimin e punës në grup për rritjen e aftësisë për të folur një gjuhë të huaj si edhe të krahasojë efikasitetin e veprimtarive në grup dhe atyre individuale në përmirësimin e aftësive të të folurit te studentët.

Në përfundim të semestrit, të gjithë studentëve iu kërkua të plotësonin një pyetësor për vlerësimin e lëndës, i cili u përdor për të vlerësuar preferencën e studentëve për një nga metodat e zhvillimit të mësimit, në seksionin *Speaking* dhe *Discussion*. Është mjaft e rëndësishme për pedagogët të kuptojnë preferencat e studentëve sepse në këtë mënyrë ata krijojnë ide më të qarta në lëndët e tyre.

Pyetësori ishte përpiluar me pyetjet e mëposhtme në fokus:

Si e perceptojnë studentët shqiptarë aplikimin e punës në grup ose dyshe në klasë? A kanë ata qëndrime pozitive apo negative ndaj punës në grup dhe në dyshe gjatë diskutimeve?

Cilat veprimtari në grup parapëlqejnë ata, që procesi i të folurit të jetë i sukseshëm dhe domethënës?

Cila nga metodat kërkon më shumë përgatitje nga ana e studentëve?

A do t'u pëlqente ta përsërisnin këtë përvojë edhe në lëndë të tjera?

Cili është roli i mësimdhënësit në aftësimin e tyre për të folur një gjuhë të huaj?

Në pyetësorët e vlerësimit të studentëve për dy metodat e përdorura në zhvillimin e lëndës u përftuan këto rezultate:

71,3% e studentëve kanë qëndrime pozitive ndaj veprimtarive në grup dhe në dyshe. Ata mendojnë se gjatë diskutimeve ndërtohen marrëdhënie më të mira midis tyre. Përpjekjet e përbashkëta, rezultojnë në nivele më të larta të kompetencës në gjuhën e folur sesa në përvojat individualiste.

62,7% e studentëve u shprehën se veprimtaritënë grup kërkojnë më shumë punë, durim dhe njohje të përgjegjësive nga ana e tyre.

81% e studentëve deklaruan se do t'u pëlqente ta përsërisnin këtë përvojë edhe në lëndë të tjera.

Disa nga pyetjet e pyetësorit ishin të hapura për opinione. Studentët sugjeronin një njohje më të mirë të hapave që duhet të ndiqnin. Një pjesë e mirë e tyre parapëlqenin punën dyshe, pasi në grupe me shumë studentë, ulej ndjenja e përgjegjësisë.

Studentët që kishin një nivel më të përparuar, preferonin të punonin individualisht, pasi mendonin se duke u zgjedhur përfaqësues të grupit, duhet të merrnin përsipër më shumë ngarkesë.

Veprimtaritë në grup mund të përdoren edhe në lëndë të tjera të cilat i zhvillojnë në gjuhën B. Përgjigjet e studentëve tregojnë se ata do t'i preferonin ato, nëse do të kishin mundësinë të zgjidhnin.

Përfundime

Ky studim krahason dy metoda të rëndësishme të përdorura gjatë mësimdhënies për përmirësimin e shprehive të të folurit. Ne ngritëm hipotezën se veprimtaritë në grup i ndihmojnë studentët për të rritur kompetencën e tyre gjuhësore dhe për ta përdorur gjuhën angleze më rrjedhshëm sesa nëpërmjet veprimtarive individuale. Aplikimi i punës në grup në fushën e mësimdhënies së një gjuhe të huaj është thelbësor për rritjen e aftësive të komunikimit sepse krijon një situatë ku studentët priren të mësojnë shprehi sociale e akademike si: të ndihmojnë njëri-tjetrin, të diskutojnë dhe argumentojnë, të vlerësojnë njohuritë dhe të plotësojnë hapësirat në të kuptuarin e njëri-tjetrit.

Në fund të studimit, rezultatet e përftuara konfirmuan hipotezën se puna në grup i ndihmon studentët më shumë se ajo individuale për të përmirësuar aftësitë e tyre të të folurit. Gjetjet pozitive të përmbledhura në këtë studim, tregojnë se puna e organizuar në grup është një teknikë efikase për përmirësimin e kompetencës së të folurit të studentëve që mësojnë gjuhën angleze.

Studimi tregoi se është përgjegjësia e mësimdhënësit të krijojë një klimë miqësore që studentët të mund të përdorin gjuhën e synuar pa hezitim dhe t'u tregoje studentëve hapat që duhet të ndjekin për realizimin e veprimtarive.

Nëpërmjet këtij studimi sugjerojmë se kalimi nga mësimdhënia me në qendër pedagogun në mësimdhënien me në qendër studentin, nxit studentët të komunikojnë dhe rrit aftësinë e tyre për të folur një gjuhë të huaj.

Ky studim është i dobishëm si për studentët pasi ndihmon ata të përmirësojnë shprehitë e të folurit, por edhe për mësimdhënësit duke kontribuar për të maksimizuar të kuptuarin e tyre të dinamikës së grupeve dhe përdorimit të tyre në kontekstin arsimor për të arritur efektshmëri maksimale gjatë procesit të mësimdhënies. Studime të mëtejshme duhet të realizohen për të testuar aplikimin e gjetjeve në klasa të mëdha.

Referencat

Edge, J (1992). Cooperative development: Professional self-development through cooperation with colleagues. Hong Kong: Longman.

Brown, H. D. (2000). Teaching by Principles: An Interactive Approach to Language Pedagogy. Francisco: Pearson Education.

Byrne, D. (1986). Teaching oral English. Long man

Bygate. M. (1987). Speaking: Oxford university press.

Carter, R. & Nunan, D. (Eds.). (2001). The Cambridge guide to teaching English to speakers of other languages. Cambridge: Cambridge University Press.

Chong, Q. K., Kan, G. Y., & Chan, C. (2012). Independent learning resource facility for English Language Learners. The International Academic Forum, 6(7), 1267-1277.

Harmer, J. (2001). The Practice of English Language Teaching. (3rd Ed). London: Longman.

Hedge, T. (2000). Teaching and learning in the language classroom.US: Oxford University Press.

Johnson, D.W., Johnson, R.T., and Smith, K.A. 1991b. Active learning: Cooperation in the college classroom.

Kramsch, C. (1983). Language and Culture. Widdwoson, H.G (ed). Oxford: Oxford University Press.

Littlewood D.A (Communicative Language Teaching, Psycholinguistics and Language Teaching Methodology)

O'' Malley, J & Valdez, P.L.(1996).Authentic Assessment for English Language Learners: M D Addison-Wesly.

Thornbury, S. (2005). How to Teach Speaking. Harmer, J. (Ed). London: Longman.

Mbresa dhe përjetime

GJETHE V JESHTE PËR TË GJITHA DASHURITË

Raimonda Belli Gjençaj

Më intrigoi menjëherë titulli i vëllimit: **"Shkruaj në gjethe vjeshte"**. Ishte 2 shtatori i vitit 2021, kur Vllasova Musta më dhuroi librin e saj me poezi, bashkë me dedikimin ku fiksoi fjalët "me dashuri". Ishte shtator, pra, muaji që zhvesh pemët dhe mbulon rrugët me gjethet e rëna. Të verdha, të kuqërremta, ose të kafenjta, madhoshe, gjatoshe, nazike, kur erës i teket të luajë me to, mbeten nën këmbët tona, nëse dikush nuk u ka rënë sipër për t'i fshirë nga faqja e dheut. Kështu çdo vit, në të njëjtën stinë, që prej fëmijërisë...Nuk ka vjeshtë nëse gjethet nuk bien...Këtë e di. Ajo që nuk dija kishte të bënte me fuqinë e muzës poetike, që gjethen e shndërron në letër, të cilën magjia e fjalës e bën më shumë se libër. Është si shtëpia e shpirtit. Është si streha e ndjesive, ku gëzimi kapërthehet me trishtimin, ku e bukura s'e afron shëmtimin, ku muzgu është njësoj i bukur me agimin, ku loti s'e ka humbur shkëlqimin e kristalit...105 poezi të vëllimit, dëshmi e lirizmit të rrallë të poetes Vllasova Musta. Që si të gjitha lirikat e botës, frymojnë për hir të dashurisë. Më e reja dashuri vjen nën titullin **"Ninullë tim nipi": Im nip më shikonte/Në sy i habitur/ I hapte dhe mbyllte qepallat e rënda/Dhe gjumi e zinte mes shtojzovallesh,/Që nga vendlindja, ia sillte nëna...**Këto vargje, mes të tjerash, i burojnë asaj për mjaltin e mjaltit...Miliona bebe vijnë në jetë, çdo sekondë, por disa syresh kanë privilegjin të vijnë si frymëzime poetike. Si i biri i Anit, vogëlushi me emrin Tim, që dikur, dikur, harroi në xhepin e gjyshes një lodër sa një gisht. Prekja e lodrës, ndërsa avioni i largohej tokës, u bë regëtimë. Regëtima u mbars me dashurinë dhe dashuria foli. Si dialog poetik, ku nëna i rrëfen lodrës së harruar, mallin që ka ngritur kokë, pa u shuar ende vlaga e përqafimit. Mall që ajo do ta përkundë në djepin e zemrës deri në takimin tjetër....

Shok ka veten, lirizmi i Vllasova Mustës. Sapo ke trokitur në portën e tij, pasi ke kapërcyer pragun e ngrehinës poetike, mahnitesh jo vetëm nga dimensioni i botës së saj, por edhe nga raporti që ajo ka me gjithçka e rrethon. Është një marrëdhënie sa njerëzore aq dhe fluoreshente. Autorja të qas në misterin e krijimit, njësoj si të të ftonte në një bisedë miqsh. E thjeshtë, si vështrimi i saj i qashtër, ajo zë e rrëfen:

Kur nisa të mësoja a,b,c,-në
Nuk e dija,
Se këto shkronja të vogla
Me rrathë e me vija,
Do më merrnin hapësirave
Ku lëviz gjithësia.
Nuk e dija
(E si mund ta dija!?)
Isha fëmijë dhe si nëpër ëndrra
Lodroja mes gërmave
Pa e ditur kurrë,
Se në vorbullën e tyre
Do të mbetesha,
Brenda.

Sot,
Kjo yllësi ka tjetër gjuhë
E kam si frymë,
E kam të shtrenjtë
E kam oazin më të paqtë
E kam altarin tim të shenjtë.

Kjo poezi me tiullin **"Altari im"** hap vëllimin dhe të bën të mendosh se Vllasova Musta ka firmosur prej kohësh kredon e jetës së saj. Qysh në poezinë e parë, botuar te revista "Pioneri". Që do të kulmonte me gëzimin e asaj të diele kur gjimnazistja 16 vjeçare pa të botuara në gazeten "Drita" krijimet e reja të saj. Ky ishte një start i mrekullueshëm. Bota e letrave e kishte pranuar. Por gara sapo kishte filluar. Gongu kishte rënë dhe ajo ishte nisur bashkë me të tjerët. Disa i kishte gjetur në pistë. Të tjerë erdhën pas saj. Ajo nuk e ndali asnjëherë vrapin. Edhe në çaste të dëshpërimit që fati nuk ia kurseu. E mbajti ritmin dhe u shtoi vargjeve, një lloj tjetër krijimtarie, prozën e saj të bukur të filmave të animuar dhe dokumentarëve. Proza e tyre fitoi një frymëmarrje të re nga poezia që mbarte mes të tjerash aq shumë dashuri. Fituese kupash të festivaleve të filmit, ajo i renditi trofetë tok me lavdinë e krijimtarisë poetike. Që koha ia ka bërë më domethënës prarimin. Siç dëshmon dhe ky vëllim. Është befasi tingëlluese të zbulosh sesi poezia rri në qerpikun e Vllasova Mustës në një marrëveshje diellore me dashurinë. Jo si metaforë. Por si kumt poetik për të thënë se gjithçka që sheh, Vllasova Musta e kthen në poezi. Pa u sforcuar, natyrshëm, si të ishte duke pirë një çaj me lule kamomili, që në vend ta ndihë të flejë, i zgjon dëshirën të kridhet në imagjinatën e radhës. Për t'iu thënë gjetheve të vjeshtës se janë si grafi të gjalla, për të na bindur se nëse nuk do të shkruante poezi, do të mbillte lule, do ta zbriste ylberin mbi pëlhura, do të thurte fole për zogjtë, do të fliste me erërat dhe me shpezët...Nuk ka dyshim, ajo mund t'i bëjë të gjitha këto. Por për fatin e mirë të letrave shqipe, Vllasova vendosi të shkruante poezi se ndryshe nuk do ta mësonim kurrë se ekzistonte dhe **"Dielli i fjalës":**

Dielli
Është i zjarrtë
Por,
Nuk i ngroh të gjithë
Fjala
Ndez dhe shuan
Tërë dashuritë!

Përmes këtij rrëfimi ndien se fjala është një tjetër ikonë për poeten. Ajo kujdeset për fjalën, me përdëllimin që ka një nënë për foshnjën e porsalindur. Ajo e di se fjala e bukur i bën njerëzit më të mirë. Dhe ajo të tillë do ta shohë botën! Ajo mëton një botë pa dhimbje, ndaj dhe kur e shpalos vuajtjen e saj, e bën të ngjajë me brishtësinë e gjetheve të vjeshtës. Ndërkohë që na kumton se:

Në to ka diell
Ka hënë brenda
Ka mall dashurie
Ka fjalë të pathëna.
Ka në këto gjethe
Rreze agimi,
Siç ka të ngrira
Flakë perëndimi.
I marr, i mbledh
Në udhë, në pragje
Kërkoj t'i rizgjoj
Dhe shkruaj vargje.

Unë e di se Vllasova Musta do t'ia dilte të shkruante vargje dhe sikur një shkulm ere t'ia kishte marrë nga duart gjethet e vjeshtës. Ajo do të shtinte dorën në ujët e liqenit, si një çast homazhi për lirikun e madh Lazgush Poradeci. Do të ndillte më tej, në harenë e lojës dallgët e detit, do të bënte të gjelbëronin pllakat e gurta të qytetit të saj të lindjes. Vegimet e saj do ta shndërronin në margaritar pikën e vesës mbi fijen e barit. Po aq natyrshëm do të na vinte pranë si pikë loti e gjithë jetës, për dashurinë e humbur...Motivet që e mbajnë brenda poezisë, janë një larmi e pafundme ëndrrash dhe dëshirash, të ngjashme me ngasjen jetësore të secilit prej nesh. Duke qenë e tillë, poezia e Vllasovës është e përshkuar nga mirësia. Vargu i saj nuk gjëmon nën mllefe dhe mëri. Vargu i saj si muzikë harpe, ta sjell jetën si tërësi emocionesh, brengash, humbjesh, hidhërimesh, por edhe gëzimesh, që pas dilemash fluturake, të lenë në shpirt gjurmën fundore se ia vlen të jetosh. Vllasova Musta është rritur mes vlerash të vërteta njerëzore. Ndaj nuk është e rastit që këtë vëllim ua kushton prindërve të saj të shtrenjtë. Bija nuk harron se u detyrohet atyre për këtë që është sot. Poetja që vazhdon të garojë ende në pistën e vrapimit, me prurje të tjera, dhe që merakut tonë për goditjen e fundit të gongut i përgjigjet siç ajo di:

Vjeshtë e artë
Apo,
Dimri në prag?!
Derdh shkronja mbi letër,
Acarin
Shtyj larg.

Fragment nga "The Philosophy of Andy Warhol: From A to B and Back Again"

ANDY WARHOL MBI KOHËN

A: Mendoj gjithmonë për njerëzit që ngrenë ndërtesat dhe pastaj nuk janë më atypari. Ose një film me një skenë me turmë njerëzish dhe të gjithë janë të vdekur. Është e frikshme.

Përpiqem të mendoj se çfarë është koha dhe e vetmja gjë që mund të mendoj është...

"Koha është koha ishte."

Njerëzit thonë "kohë në duar". Epo, i pash duart e mia dhe pash shumë vija. Dhe pastaj dikush më tha se disa njerëz nuk kanë vija. Nuk e besova. Ishim ulur në restorant dhe ajo tha, "Si mund ta thuash këtë? Shihe kamerierin atje." E thërriti, "Zemër! Zemër? A mund të më sjellësh një gotë ujë?" dhe kur e solli i kapi dorën dhe ma tregoi dhe nuk kishte vija. Vetëm tre kryesoret. Dhe tha, "E sheh? Të thash. Disa njerëz si ai kamerier nuk kanë vija." Dhe mendova, "Zot, sikur të isha kamerier."

Nëse vija në dorën tënde janë rrudha, duhet të thotë se duart e tua shqetësohen ca.

Ndonjëherë të ftojnë në një ballo të madhe dhe për muaj të tërë mendon se sa magjepsëse dhe emocionuese do të jetë. Më pas fluturon për në Europë dhe shkon në ballo dhe kur e mendon disa muaj më pas ajo që mban mend është ndoshta rruga me makinë për në ballo, nuk e mban mend fare ballon. Ndonjëherë kohët e vogla që mendon se nuk janë asgjë ndërkohë që ndodhin rezultojnë të jenë ato që shënjojnë një periudhë të tërë të jetës tënde. Duhet të kisha ëndërruar për muaj të tërë për udhëtimin me makinë për të balloja, dhe blerjen e biletës për në Europë që të bëja udhëtimin me makinë. Pastaj, kushedi, ndoshta mund të mbaja mend ballon.

Disa njerëz vendosin të jenë të moshuar dhe pastaj bëjnë ato që supozohet të bëjnë njerëzit e moshuar. Por kur ishin njëzet vjeç bënin ato që supozohet të bënin njëzetvjeçarët. Dhe pastaj ka nga ata njerëzit e tjerë që duken si njëzet vjeç gjithë jetën e tyre. Është emocionuese të shohësh yjet e kinemasë – meqenëse janë më të përfshirë në këtë se shumica e njerëzve – të cilët kanë punuar për bukurinë e tyre, të cilët kanë ende të gjithë energjinë e tyre sepse po punojnë ende me veten e tyre të re.

Meqenëse njerëzit do të jetojnë më gjatë dhe do të plaken, do u duhet të mësojnë se si të jenë foshnje për një kohë më të gjatë. Mendoj se kjo është ajo që po ndodh tani. Disa fëmijë që i njoh personalisht po mbesin foshnje më gjatë.

Njëherë po qëndroja në një rrugë në Paris dhe një grua e moshuar po më shihte, dhe mendova, "Oh me siguri po më ngul sytë se është angleze," sepse anglezët në njohin gjithmonë nga ndonjë skandal televiziv londinez ku disi merrja pjesë. Kështu që pashë ca më tutje kur ajo më tha, "A nuk je Andy?" i thash po dhe ajo tha, "Erdhe te shtëpia ime në Provincetown njëzet e tetë vite e gjysmë përpara. Kishe vënë kapele dielli. Ti as nuk më mban mend, por unë nuk do të të harroj kurrë ty me kapelën e diellit. E sheh, nuk mund ta duroje diellin." U ndieva kaq çuditshëm sepse nuk e mbaja mend fare ndërsa ajo e kujtonte edhe muajin. Sepse të mbash mend "njëzet e tetë vite e gjysmë përpara" pa ndaluar që ta llogarisësh do të thotë që ajo e ka ndjekur vërtet dhe do të thoshte, "Epo kanë kaluar nëntëmbëdhjetë vjet që kur ai ishte këtu me kapelën e diellit." Ishte shumë e pazakontë – burri i saj ishte aty dhe po grindeshin se sa kohë kishte kaluar. Ai tha, "Jo, jo, jo. Nuk ishim martuar ende, e kujton? Kështu që duhet të ketë qenë njëzet e gjashtë vite e treçerek përpara."

Disa njerëz thonë se Parisi është më estetik se New York-u. Epo, në New York nuk ke kohë të kesh estetikë sepse të duhet gjysmë dite që të shkosh në qendër të qytetit dhe gjysmë ditë për të shkuar në pjesën e sipërme.

Pastaj ka kohë në rrugë, kur takon ndonjë që nuk e ke parë çprej, le të themi, pesë vitesh. Kur e shihni njëri-tjetrin dhe nuk doni të humbisni kohë atëherë është mrekulli. Nuk thua "Çfarë ke bërë?" – nuk përpiqesh t'i vësh punët përpara. Ndoshta përmend që je nisur për te 8th Street për të marrë një krem karamel të ngrirë dhe ndoshta ata përmendin se cilin film po shkojnë të shohin, por vetëm kaq. Thjesht një këqyrje e rastësishme. Shumë e lehtë, e qetë, e çastit, shumë amerikane. Askush nuk është i shqetësuar, askush nuk humbet kohë, askush nuk bëhet histerik, askush nuk ngadalëson. Atëherë është mirë. Dhe pastaj kur dikush të pyet se çfarë ndodhi me filanin ti i thua, "Po, e pashë duke pirë një birrë te 55th Street." Luaje të gjithën në një nivel, sikur çdo gjë ishte dje.

Mendoj se më mungojnë ca kimikate dhe prandaj kam prirje që të jem më shumë – çun mami. Një qullac. Jo, një çun mami. Një "qumështor". Mendoj se më mungojnë ca kimikate përgjegjësie dhe ca kimikate riprodhimi. Nëse do t'i kisha ndoshta do të mendoja më shumë për plakjen në mënyrën e duhur dhe katër martesa e të kisha familje – gra dhe fëmijë dhe qen. Jam i papjekur, por ndoshta diçka mund t'i ndodhte kimikateve të mia dhe do të mund të piqesha. Mund të filloja të kisha rrudha dhe të ndaloja së veshuri paruket e mia.

Thonë gjithmonë se koha i ndryshon gjërat, por në fakt duhet t'i ndryshosh ti vetë.

Ndonjëherë njerëzit lënë të njëjtin problem t'i bëjë të mjerë për vite me radhë kur mund thjesht të thonë, "E pastaj" Kjo është një nga gjërat e mia të parapëlqyera për të thënë. "E pastaj."

"Mamaja ime nuk më donte". E pastaj.

"Bashkëshorti im nuk fle me mua." E pastaj

"Jam i suksesshëm por jam ende vetëm." E pastaj.

Nuk e di si ia kam dalë gjithë këto vite para se ta mësoja këtë dredhi. M'u desh shumë kohë ta mësoja, por pasi e mëson, nuk e harron kurrë.

Çfarë e bën një njeri të shpenzojë kohë duke qenë i mërzitur kur mund të jetë i lumtur. Isha në Lindjen e Largët dhe po ecja në një shteg ku kishte një festë të madhe të lumtur, dhe në fakt po digjnin për vdekje një njeri. Ishin duke festuar dhe ishin të lumtur, duke kënduar e duke kërcyer.

Pastaj ditën tjetër isha në Bowery kur një njeri në një strehë u hodh nga dritarja dhe vdiq, dhe një turmë u mblodh rreth trupit, dhe më pas një endacak po vinte duke u lëkundur dhe tha, "A e pe komedinë nga ana tjetër e rrugës?"

Nuk po them që duhet të jesh i lumtur kur dikush vdes, por thjesht që të ngjall kureshtje të shohësh raste që provojnë se nuk duhet të jesh i trishtuar për këtë, në varësi se çfarë mendon se do të thotë, dhe ajo çfarë ti mendon për çfarë mendon se do të thotë.

Një person mund të qajë ose të qeshë. Dhe kur qan mund të jesh duke qeshur, e ke mundësinë e zgjedhjes. Njerëzit e çmendur dinë ta bëjnë më mirë sepse e kanë mendjen e çlirët. Kështu që mund të marrësh fleksibilitetin që ka mendja jote dhe ta bësh të funksionojë për ty. Ti vendos se çfarë do që të bësh dhe se si e shpenzon kohën tënde. Mbaje mend, gjithsesi, mendoj se më mungojnë ca kimikate, kështu që është më e lehtë për mua se sa për një person që ka shumë kimikate përgjegjësie, por i njëjti parim mund të përdoret në shumë raste.

Kur të mbarojë koha ime, kur të vdes, nuk dua të lë gjëra të mbetura përgjysmë. Dhe nuk dua të jem një mbetje. Isha duke parë televizor këtë javë dhe pashë një zonjushë që u fut në një makineri rrezeje dhe u zhduk. Ishte e mrekullueshme, sepse lënda është energji dhe ajo thjesht u shpërbë. Kjo mund të ishte vërtet një shpikje amerikane, shpikja më e mirë amerikane – të kesh mundësi të zhdukesh. Dua të them, në atë mënyrë nuk mund të thonë se vdiqe, nuk mund të thonë se të vranë, nuk mund të thonë se vrave veten për dikë.

Gjëja më e keqe që mund të të ndodhë kur të mbarojë koha jote është të balsamosesh e të të shtrijnë në një piramidë. Më neveritet kur mendoj për egjiptianët që merrnin çdo organ dhe e balsamosnin më vete në enët përkatëse. Unë dua makinerinë time për t'u zhdukur.

Sërish, më pëlqen ideja e kthimit të njerëzve në rërë ose diçka të tillë, kështu makineria vazhdon të punojë pasi vdes. Them se zhdukja do të ishte puna e lënë pa bërë që do i duhej makinerisë ta përfundonte. Duke qenë se besoj në punë, them se nuk duhet të mendoj për zhdukjen kur të vdes. Dhe sidoqoftë, do të ishte shumë magjepsëse të rimishëroheshe si një unazë e madhe mbi gishtin e Pauline de Rothschild-it.

Unë jetoj vërtet për të ardhmen, sepse kur ha një kuti me ëmbëlsira, mezi pres që të shijoj copën e fundit. Nuk e shijoj asnjë prej copave të tjera, dua vetëm ta mbaroj dhe të hedh tutje kutinë dhe të mos e kem më në mendje.

Do të më pëlqente më shumë ta kisha tani ose ta dija se s'mund ta kisha kurrë që të mos mendoja për të.

Prandaj disa ditë dëshiroj të jem shumë shumë plak që të mos më duhet të mendoj për plakjen.

Dukem vërtet i shëmtuar, dhe nuk e marr mundimin të rregullohem ose të përpiqem të dukem i pashëm sepse nuk dua që askush të përfshihet me mua. Dhe kjo është e vërteta. Vë në pah veçoritë e mia të këqija dhe minimizoj ato të mirat. Kështu dukem i shëmtuar dhe vesh pantallonat e gabuara dhe këpucët e gabuara dhe vi në kohën e gabuar me miq të gabuar, dhe them gjërat e gabuara dhe i flas njeriut të gabuar, dhe *prapë* ndonjëherë dikush interesohet për mua dhe më ikën truri dhe pyes veten, "Çfarë bëra gabim?" Kështu shkoj në shtëpi dhe përpiqem ta zbuloj. "Epo duhet të kem veshur diçka që dikujt i është dukur joshëse. Bëj mirë ta ndryshoj. Para se gjërat të shkojnë shumë larg. Kështu shkoj te pasqyra ime treanëshe dhe studioj veten time dhe shoh që tani kam pesëmbëdhjetë puçrra të reja në fytyrë dhe zakonisht kjo duhet t'i kishte ndaluar. Kështu që mendoj, "Sa e çuditshme. E di që dukem keq. E bëra veten time të dukem veçanërisht keq – veçanërisht të gabuar – sepse e dija

që shumë nga njerëzit e duhur do të ishin aty, dhe prapë dikush disi u interesua...” Pastaj më kap paniku sepse mendoj se nuk e di se çfarë është joshëse dhe se duhet ta zhduk para se të vazhdojë të më shkaktojë probleme të tjera. E sheh, të njohësh një person të ri është thjesht shumë e vështirë, sepse çdo njeri i ri merr më shumë kohë e hapësirë. Mënyra për të mbajtur më shumë kohë për vete është që ta mbash veten aq jotërheqës sa askush të mos interesohet.

Shoh njerëz profesionalë si komedianë në klube nate, dhe më bën gjithmonë përshtypje koha perfekte e tyre, por nuk mund ta kuptoj kurrë se si ata mund të durojnë të thonë të njëjtën gjë gjithë kohën. Pastaj kuptova se cili është ndryshimi, sepse gjithmonë përsërit të njëjtat gjëra gjithë kohën gjithsesi, qoftë nëse ta kërkon dikush apo jo, ose është puna jote. Zakonisht bën të njëjtat gabime. I aplikon gabimet e tua të zakonshme në çdo kategori apo fushë të re ku shkon.

Kurdo që jam i interesuar për diçka, e di që koha është e gabuar, sepse jam gjithmonë i interesuar në gjënë e duhur në kohën e gabuar. Duhet të interesohem pasi të mos jem më i interesuar, sepse pastaj kam turp të jem ende duke menduar për një ide të caktuar, kur ajo ide është gati duke bërë milioner dikë tjetër. Të njëjtat gabime të bukura.

Mësova diçka për kohën kur shkoja rrotull New York-ut dhe takoja njerëz në zyrat e tyre sipas orareve të caktuara. Dikush më caktonte një takim në orën dhjetë, kështu që mundoja trurin tim që të arrija pikërisht në dhjetë, dhe nuk më takonin deri në një pa pesë. Kështu që kur e kalon këtë qindra e herë dhe dëgjon, “Në orën dhjetë?”, thuaj “Eeeeepo, kjo më duket qesharake, mendoj të vi në një pa pesë.” Kështu që shkoja gjithmonë në një pa pesë dhe funksiononte gjithmonë. Atëherë e takoja personin. Kështu mësova. Si të ishe mi laboratori dhe të vënë gjithë ato teste dhe shpërblehesh kur e bën saktë, dhe kur e bën gabim të kthejnë pas, dhe kështu mëson. Kështu mësova se kur do ishin vërdallë njerëzit.

E vetmja kohë kur nuk më funksionoi sistemi ishte me Liz Taylor-in. Isha në Romë për të xhiruar një film me të dhe për një javë çdo ditë ajo vinte orë më vonë, sa më në fund mendova, “Epo dëgjo, le të marrim kohën tonë nesër dhe të mos zgjohemi në gjashtë e gjysmë.” Kështu atë ditë ajo iku aty para të gjithëve. Ishte aty para gruas së garderobës dhe kameramanëve. Ajo praktikisht kishte shijuar kafen. Ajo të mban në majë të gishtave. Bëri të njëjtën gjë që bëra unë, mbrapsht, dhe u habita sepse nuk e njihja mjaftueshëm që ta parashikoja. Liz Taylor, duke qenë vonë pesëdhjetë herë dhe pastaj një herë herët, duket të jetë duke aplikuar të njëjtin parim si unë që kam flokë gri që kur të bëj diçka që kërkon një sasi normale energjie të duket “e re”. Kur Liz Taylor është në kohë duket “herët”. Sikur je lindur me një talent të ri papritur ndërkohë ke qenë kaq i keq në diçka për kaq shumë herë, dhe pastaj papritur një ditë nuk je aq keq.

Më pëlqen ideja që njerëzit në New York tani duhet të mbajnë radhë për filmat. Shkon pranë kaq shumë kinemave dhe ka radhë shumë të gjata. Por askush nuk duket i palumtur për këtë. Të kushton kaq shumë para thjesht për të jetuar tani, dhe nëse je në një takim romantik, dhe kalon gjithë kohën e takimit në radhë, dhe kështu kursen para sepse nuk të duhet të mendosh për gjëra të tjera për të bërë ndërkohë që po pret dhe fillon të njohësh personin, dhe vuani pak bashkë, dhe pastaj argëtoheni për dy orë. Kështu jeni afruar shumë, keni ndarë një eksperiencë të plotë. Dhe ideja e të priturit për diçka gjithsesi e bën më emocionuese. Të mos futesh kurrë është më emocionuese, por pas asaj pritjes të futesh brenda është akoma më emocionuese.

Nëse do të kisha kohë për një leje të zakonshme çdo dhjetë vite, sërish nuk mendoj se do të shkoja gjëkundi. Me shumë mundësi do të shkoja në dhomën time, të shkriftoja jastëkun, të ndizja nja dy televizorë, të hap një kuti me biskota Ritz, të hap një kuti Russel Stover. Të ulem me çdo numër të fundit të çdo reviste përveç *TV Guide* nga çdo cep kioskash, dhe pastaj të ngrej telefonin për të telefonuar çdo njeri që njoh dhe t’i kërkoj të shohin *TV Guide*-et të tyre e të më thonë se çfarë ka në televizor, çfarë ka pasur e çfarë do të dalë. Më pëlqen gjithashtu të rilexoj gazetën. Sidomos në Paris. Nuk mund ta rilexoj mjaftueshëm ndërkombëtaren *Herald Tribune* kur jam në Paris. Në dhomën time, koha lëviz kaq ngadalë për mua, vetëm jashtë lëviz kaq shpejt.

Nuk më pëlqen të udhëtoj sepse më pëlqen shumë koha e ngadaltë dhe për një aeroplan duhet të largohesh tre ose katër orë përpara dhe kështu të ikën dita. Nëse do vërtet që jeta të të kalojë si film para teje, thjesht udhëto, mund ta harrosh jetën tënde.

Më pëlqen rutina. Njerëzit më telefonojnë dhe thonë, “Shpresoj të mos jem duke shqetësuar rutinën tënde, duke të marrë në telefon kështu.” E dinë sa shumë më pëlqen.

Një gabim që bëj kohë pas kohe është të mos ndjek Rregullin e Artë: mbaj ashensorët. Gjithashtu, edhe kur përpiqem të hedh gjëra dhe të thjeshtoj jetën time, ia ngec dikujt tjetër.

Ajo që e bën të shpejtë një film është kur shkon ta shohësh, dhe pastaj kur e sheh herën e dytë kalon shumë shpejtë. Nëse do të vuash, shko shihe diçka dhe pastaj shko shihe prapë. Do të shohësh se vuajtja jote kalon më shpejt herën e dytë.

> **Thonë gjithmonë se koha i ndryshon gjërat, por në fakt duhet t’i ndryshosh vetë.**

Mund të shoh një mister me vrasje një natë, dhe pastaj e shoh për herë të dytë natën tjetër dhe prapë nuk e di kush e ka bërë deri në minutën e fundit. Kështu që e di që ka *vërtet* diçka që nuk shkon me mua. Dua të them, nëse mund të ulem dhe të shoh një tjetër *Thin Man* dhe ta shoh prapë natën tjetër, dhe prapë të mos e di se kush është vrasësi deri në minutën e fundit... Dhe do jem po aq kureshtar e në ankth duke pritur ta zbuloj dhe po aq i habitur sa isha natën e parë. Nëse e kam parë pesëmbëdhjetë herë, atëherë *ndoshta* një nga pesëmbëdhjetë herët do të më kujtohet dhe mund ta shoh se kush është. them se koha është fabula më e mirë – suspanca e të parit nëse do ta mbash mend.

Orët dixhitale dhe orët e dorës më tregojnë vërtet se ka një kohë të re në dorën time. Dhe është paksa frikësuese. Dikush ka menduar për një mënyrë të re për të treguar kohën, pra them se nuk do të themi “orë” dhe për shumë kohë, sepse është “në orën” ose “nga ora” dhe nuk do të ketë më orë: do të jetë “një kohë” në vend të “orës një” dhe “tre e gjysmë kohë” dhe “katër e dyzetepesë kohë”.

—

Kur isha i vogël dhe sëmuresha shpesh, ato kohë të sëmura ishin si pushime të vogla. Pushime të brendshme. Duke luajtur me kukulla.

Nuk i prisja kurrë kukullat që priteshin. Disa njerëz që kanë punuar me mua thoshin se i priste dikush tjetër për mua, por arsyeja e vërtetë që nuk i prisja ishte se nuk doja të prisja faqet e bukura ku ishin. I lija gjithmonë kukullat që priteshin në librat me prerje.

Për kohën
Kohë pas kohe
Bëj kohë
Kohë për veten tënde

Fundjavave.

Në kohë
Në asnjë kohë
Në kohë të mirë
Mes kohëve
Kohë e sërish
Kohë jete
Veshur nga koha

Kaloj kohë
Shënjoj kohë
Blej kohë
Mbaj kohë

Në kohë
Në kohën e duhur
Kohë pushim
Kohë jashtë
Kohë brenda
Kartë kohe
Shtyrje kohe
Zonë kohe

Përparakohë
Ndërkohë
Paskohë
Gjithëkohë

Kur shoh rrotull sot, anakronizmi më i madh është shtatzënia. Nuk mund ta besoj që ka ende njerëz shtatzënë.

Koha më e mirë për mua është kur nuk kam asnjë problem të cilin nuk mund ta rregulloj me para.

Përktheu Enxhi Hudhri

ARTI I BRISHTË I NOT GIVING A F*CK DITAR

NJË DITAR
I UDHËZUAR NGA
MARK MANSON

Minerva